

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 409 • DHJETOR 2024



FENOMENI I DIVORCIT NË KOSOVË,
SHKAQET DHE NDRYSHIMET SOCIALE

SHËNDETI RIPRODHUES NGA PERS-
PEKTIVA KOMBËTARE DHE FETARE

HUMANIZMI DHE TOLERANCA E
MYSLIMANËVE PËRGJATË HISTORISË

NGA MANIFESTIMI PËR FESTËN E FLAMURIT NË SUHAREKË

26 NËNTOR 2024



"Është detyrë jona që atdheut t'i falim siguri, ta rindërtojmë e ta mbrojmë atë. Islami e ka lartësuar rëndësinë e atdheut si një vlerë të rëndësishme në vetvete. Dashuria, përkatësia dhe besnikëria ndaj atdheut janë detyra dhe kushdo që manipulon me këto koncepte konsiderohet tradhtarë."

Myftiu, Naim ef. Tërnavë



"Bashkësia Islame e Kosovës dhe hoxhallarët nuk ka dhënë kontribut vetëm në luftën e fundit, por ata i gjejmë në të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë."

Bali Muharremaj



EDITORIAL

- 4 Divorci si atraksion i brezit modern

FETARE

- 5 Besimi në Ditën e Gjykimit dhe ndikimi i tij në mirësjelljen e besimtarit
Dr. Bahri Hoxha
- 8 Ndarja si shtegdalje për një jetë të plasarit bashkëshortore
Dr. Ejup Haziri
- 12 Ndarja me iniciimin e gruas (el hului)
Dr. Ilmije Kuqi
- 15 Shëndeti riprodhues nga perspektiva kombëtare dhe fetare islame (1)
Fitim Flugaj
- 17 Humanizmi dhe toleranca e myslimanëve përgjatë historisë (1)
Lavdrim Hamja
- 20 Karta e Medinës dhe esenca e saj
Nehat Shehu
- 25 Zemra e besimtarit
Miran Mehmeti

INTERVISTË

- 27 Nga tradita familjare, te sfida e ekonomisë moderne
Intervistë me prof. Muhamet Mustafën

AKTUALITET

- 31 Tendencë mediokre për kthim në fenë e të parëve
Granit Sadiku
- 34 Disa shqiptarë "evropianë" dhe gjysmë identiteti fetar
Emine A. Vezaj – Ciroka



EDUKIM & FAMILJE

- 36 Shkurorëzimi dhe pasojat e tij te fëmijët
Mr.sc. Gyltene Dërguti
- 40 Fenomeni i divorcit në Kosovë, shkaqet dhe ndryshimet sociale
Dr. Ferdi Kamberi
- 45 Kanceri i gjirit
Dr. Vildana Goga – Çmega
- 47 Kuptimi i injorancës
Nada Hoteit

KULTURË

- 49 Lidhmëria ndërmjet shkencës dhe fesë islame
Mr. Njomza Sadriu
- 52 18 Dhjetori – Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Arabe
Shkëlzen Hoxha
- 54 Perceptimet e nxënësve të medreseve të Kosovës për gjuhën turke
Dr. Selim Selimi

HISTORI & CIVILIZIM

- 58 Lidhja dhe bashkëpunimi i ulemave shqiptarë të Kosovës me Trupin Diplomatik Shqiptar (1936-1939) – (2)
Dr. Qerim Lita

AKTIVITETE

- 67 U inaugurua selia qendrore e Shoqatës Humanitare Bamirëse "Bereqeti"
- 68 U mbajt program festiv për nder të 28 Nëntorit në "Medresenë Alauddin"



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 409 • viti 38 • Dhjetor 2024
• Xhumadel-Ula / Xhumadel-Uhra 1446
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"IliriPrint", Prishtinë



*“Gjëja më e urryer
tek Allahu, por që
megjithatë lejohet
është divorci.”*

(Muhamedi, a.s.)

Divorci si atraksion i brezit modern

Në tentativën për të rikonstruktuar çdo gjë të trashëguar si vlerë e virtut në shoqëritë tona, që deri diku mund të cilësoheshin si konservative, fryma modernizuese nuk po e kursen as celulën më të fuqishme të shoqërisë – familjen. Martesa si themel i një familjeje të shëndoshë e fisnike është llogaritur nga Krijuesi ynë si një “...besatim i fuqishëm”, (En Nisa, 21), në mes të burrit e të gruas për një jetë të përbashkët njerëzore. Ajo, mbetet përherë një kontratë e shenjtë e bekuar nga Zoti, por edhe një zotim çiltërsie nga çifti bashkëshortor. Megjithatë ky besatim i dëlirë mbase është edhe institucioni më i kërcënuar duke iu rrezikuar edhe thelbi ekzistencial i saj.

Divorci i lehtësuar pa kufi, e i normalizuar tejmas edhe në situatat kur ai nuk është fare “normal” e bënë lidhjen martesore sa të brishtë, po aq edhe të atakuar, mu në një kohë që shoqërisë së trazuar, do t’ia ruante besnikërisht themelin dhe stabilitetin e saj.

Në rrethana të mirëqena, martesa përbën një fat dhe ogur të mirë që me të ngazëlloheshin e kremtonin familja dhe gjithë rrethi i çiftit bashkëshortor. Natyrshëm, në një martesë, shoqëria sihariqohej me rritjen e shumimin e saj. Ajo, thjesht, premonte gjithnjë mbijetesën. Formoheshin familjet që mbeteshin si kala e pathyer përballë furtunave më të vështira në çdo vend, e sidomos te ne që lirinë e mirëqenien e kishim të munguar.

Mirëpo, me një ritëm krejt shpërfillës, ajo “familja e madhe” si një strehë e fortë që dikur ishte normë, e tilla tashmë ka mbetur pjesë e së shkuarës. Ajo celulë, që dikur në gjirin e saj bashkonte dy a tre breza, tashmë është transformuar e reduktuar në “familje një bërthamore”, duke lënë brenda një shtëpie vetëm qiftin e martuar dhe eventualisht ndonjë fëmijë të lindur prej tyre. Madje, kjo frymë transformuese në shoqërinë tonë nuk u ndal në këtë cak. Ajo, në hapin e radhës do shpërbërjen edhe të kësaj “familjeje një bërthamore”, synon divorcin e ndarjen, për të jetuar secili “i lirë”, ani pse në vetmi.

Të etur për të hequr petkun tradicional dhe duke synuar adoptimin dhe absorbimin e të gjitha produkteve të modernitetit, nivelin e përparimit shumë njerëz nuk e matin me numrin e martesave, por me numrin e divorceve të tyre. Divorci më nuk përbën problem e as nuk është shqetësim, përkundrazi është një avancim dhe sukses që për të duhet krenuar.

E, për të qenë të saktë në anën dispozitive islame, divorci si solucion në një martesë toksike e të trazuar në nivel të pariparueshëm, mbetet rruga më e vështirë, por që megjithatë ajo mbetet e hapur dhe si i tillë ai është i lejuar. Atë e përshkroi si më së miri i Dërguari ynë, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, kur tha: “Gjëja më e urryer tek Allahu, por që megjithatë lejohet është divorci.” Në kontekst të determinimit juridik të normës për divorcin, ishte tejet konciz juristi i shquar hanefit Ibën Abidini, kur thoshte: “Sa i përket shkurorëzimit, parimisht në Islam ai është i ndaluar, që nënkupton se mbetet i ndaluar përveç kur ekziston arsyeja që e justifikon atë. E nëse nuk shtrohet nevoja për të, ai mbetet naivitet e madje “çmenduri”, sepse si i tillë është mosmirënjohje ndaj dhuntisë (së martesës), por edhe shkaktim i dëmit për bashkëshorten-in e fëmijët. Andaj arsyet që mund ta justifikojnë janë dallimet në karakter e sjellje, shfaqja e urrejtjes që shpie deri te moszbatimi i normave hyjnore në jetën bashkëshortore...”. Thënë ndryshe, divorci nuk duartroket në Islam, por në situatat e nevojshme prapë ai mbetet i lejuar.

Studimet e fundit zbulojnë se divorcet – ndarjet bashkëshortore ishin të lidhura ngushtësisht me nivelet më të larta të ankthit, depresionit e izolimit social, si dhe përmbajnë në vete një rrezik shumë të madh të abuzimit me alkoolin, e jo rrallë herë edhe me lëndët narkotike. Pos pasojave që i bartin mbi supet e veta çiftet e divorcuara, një kompleks tejet i rëndë mbetet edhe fati i fëmijëve pas ndarjes së prindërve të tyre. Madje, po të mendohej më thellë, t’ua thuash fëmijëve se ata duhet të mësohen të jetojnë pa praninë e dy prindërve, kjo ndoshta mbetet pjesa më e dhimbshme dhe më e vështirë e tërë kësaj çështjeje. Nëse jo për vetveten, një çift racional, para divorcit, do të duhej të mendonin shumë gjatë për fëmijët e tyre që pafajësisht do të privoheshin nga ledhatimet e përkujdesja prindërore në një kohë, që ata edhe nën ombrellën e të dyve po e kanë tejet të vështirë ruajtjen, edukimin dhe orientimin e mirëfilltë në jetën e tyre.

Mr. Driton Arifi

Besimi në Ditën e Gjykimit dhe ndikimi i tij në mirësjelljen e besimtarit

Dr. Bahri Hoxha

Dita e Gjykimit sipas besimit islam është dita që ndan jetën në këtë botë nga jeta e Ahiretit. Ndan jetën e përkohshme nga jeta e përhershme. Me të përfundon përgjithësisht jeta e angazhimit dhe veprimit, për të filluar jeta e shpërblimit, eventualisht edhe e dënimit. Në mes të angazhimit dhe shpërblimit qëndron llogaridhënia për respektimin e urdhrave të Zotit, apo eventualisht të kundërshtimit të tyre dhe mu për këtë, kjo ditë quhet edhe Dita e Llogarisë. Kjo ditë paraqet fundin e jetës në këtë botë, për këtë fakt quhet edhe Dita e Fundit. Të gjitha krijesat që kanë qenë të ngarkuara me obligime dhe ndalesa ringjallen para Zotit të tyre dhe kështu emërtohet edhe Dita e Ringjalljes. Kjo ditë në Kuranin fisnik ka më shumë se pesëdhjetëdy emërtime të ndryshme.¹ Secili emërtim i kësaj dite vë në pah një fakt interesant të ndodhivë të kësaj Dite të Madhe.

OBLIGUESHMËRIA E TË BESUARIT NË DITËN E GJYKIMIT

Besimi në këtë ngjarje të madhe është parim fetar te shumica e banorëve të tokës përgjatë historisë. Në Islam, të gjithë myslimanët, me konsensus të plotë besojnë se Dita e Gjykimit do të ndodhë dhe se njerëzit do të ringjallen me trup dhe me shpirt para Zotit të tyre, pastaj do t'i gëzojnë shpërblimet që Zoti i tyre

Në momentin kur besimi zë vend në zemrën e njeriut, prej tij kërkohen vepra të cilat dëshmojnë vërtetësinë e besimit që posedon. Në shumë ajete në Kuran qëndron ky binom i famshëm: besimi dhe veprat e mira.

i ka përgatitur për besimdrejtët në përjetësi. Besimi në këtë moment të madh është njëri nga parimet më të famshme islame, pas besimit në Zotin Një dhe besimit në misionin e pejgamberisë. Kushdo që nuk beson se Dita e Ringjalljes do të ndodh, sipas parimeve islame nuk konsiderohet besimtar mysliman, për shkak se përmes mosbesimit refuzohen një pjesë e madhe e ajeteve të qarta të Kuranit fisnik. Koha kur do të ndodh Kiameti është e panjohur për çdo krijesë. Kjo çështje është në dijen e Allahut xh.sh..²

NDËRLIDHJA E BESIMIT NË DITËN E GJYKIMIT ME VEPRIMIN

Në momentin kur besimi zë vend në zemrën e njeriut, prej tij kërkohen vepra të cilat dëshmojnë vërtetësinë e besimit që posedon. Në shumë ajete në Kuran qëndron ky binom i famshëm: besimi dhe veprat e mira. Në njërin nga këto ajete, Zoti thotë: “E për ata që besuan dhe bënë vepra të mira, për ta do të jenë xhenetet e begatshme.” (Lukman, 7).

Në hadithin që quhet hadithi i Xhibrilit, Muhamedi a.s. numëroi gjashtë gjëra, që janë ajka e parimeve islame në besim: “Imani është të besosh Allahun, melaqet e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe se e mira dhe e keqja ndodh me lejen e Tij.”³ Në mesin e këtyre gjashtë pikave, parimi më i qartë që ndërlihet me veprimin është besimi në Ditën



e Gjykimit, sepse gjykimi gjithherë ndodh për shkak të veprimit. Në shpjegimin islam, besimi qëndron si fundament i çdo veprimi, porse edhe veprimi nënkuptohet se është i kërkuar që të mbështetet në këtë besim. I tërë besimi islam, pra feja islame, nuk është zbritur për tjetër, vetëm se për të vepruar sipas saj. Në hadithin e mësipërm, nuk ceket vetëm aspekti i besimit, që në fakt paraqet aspektin teorik të parimeve bazë të Islamit, por aty kur pyetet për Islamin, i Dërguari a.s. numëron veprime të cilat paraqesin bazat e praktikës islame, ajo që te ne njihet me shprehjen “shartet (kushtet – shtyllat) e Islamit”, në të cilën përfshihet dëshmia gojore e përkatësisë islame, pastaj namazi, zekati etj., veprime këto, pa të cilat imani i besimtarit është i mangët.

Muhamedi a.s. ka thënë: “S’ka besim (të rregullt) ai që nuk ruan amanetin dhe s’ka fe ai që nuk ka besë.”⁴ Besimtari është ai nga i cili burojnë virtytet e mira dhe sjelljet e këndshme. Përndryshe asgjë nuk ka përfituar nga besimi. Muhamedi a.s. ka thënë: “Mysliman është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit të tjerët janë rehat.”⁵

Në një rast shokët e dëgjuan Muhamedin a.s. duke u betuar: “Për Zotin nuk ka besuar” dhe këtë e përsëriti tri herë. Ata i thanë: “Kush është ai o i Dërguari i Zotit që qenka shkatërruar?” Ai tha: “Ai që fqinjin e tij nuk e lë të sigurt me shqetësimet që i bën.”⁶

SJELLJA E KEQE – SHKAK PËR DËSHTIM NË DITËN E GJYKIMIT

Transmetohet se Muhamedi a.s. një ditë i pyeti shokët e tij: “A e dini, kush është i falimentuar?” Ata thanë: “I falimentuar te ne është ai person që nuk i mbetet gjë nga pasuria dhe mallrat.” I Dërguari a.s. u tha: “I falimentuar është ai person që Ditën e Gjykimit vije me namaz, agjërim dhe zekat të kryer (në një transmetim tjetër, ai person që vije me të mira

sa kodrat), porse dikë e kishte fyer, e dikë e kishte rrahur, dikujt ia kishte marrë pasurinë, e dikë e kishte vrarë. Atëbotë, secilit prej të dëmtuarve u jepet nga veprat e mira të këtij personi, e nëse harxhohen veprat e mira para se të shpaguhet dëmi, ngarkohet ky person me të ligat e të dëmtuarve dhe hidhet në zjarr.”⁷

Dijetarët kur përmendën këtë rast, thanë se sahabët i treguan Muhamedit a.s. për të falimentuarin e kësaj bote, kurse i Dërguari a.s. u tregoi për të falimentuarin në botën tjetër. Në një rast tjetër, Muhamedi a.s., ka thënë: “Ruajuni padrejtësisë, sepse ajo në Ditën e Gjykimit do të jetë errësirë.”⁸

Secili mëkat i madh është potencialisht i dënueshëm, por sjellja e keqe me njerëzit dhe shkaktimi i dëmit është niveli më i ulët dhe paraqet rrezikun më të madh për dënim. Nuk është i rastësishëm shpjegimi profetik, se dëshmorit i falen të gjitha mëkatet përveç borxhit, përderisa vlera e dëshmorit vije menjëherë pas vlerës së të dërguarve të Zotit. Kjo ngase, mospagimi i borxhit është marrje pa të drejtë e pasurisë së tjetrit dhe si e tillë është shkaktim i dëmit. Për dallim nga shumica e mëkateve të tjera, të cilat mund të ndëshkohen në botën tjetër, sjellja e keqe mund të ketë dënimin në këtë botë, siç është rasti me sjelljen e keqe ndaj prindërve dhe ushtrimi i prostitucionit.

Përveç kësaj, lutjet që i bëhen Zotit Fuqiplotë kundër atyre që shkelin të drejtat, ushtrojnë dhunë ndaj tjerëve dhe u bëjnë njerëzve padrejtësi pranohen me patjetër te Zoti Fuqiplotë, edhe nëse janë nga jobesimtarët. Muhamedi a.s. ka thënë: “Ruajuni lutjes së atij që i është bërë padrejtësi edhe po që se është jobesimtar, sepse në mes saj dhe Zotit nuk ka pengesë.”⁹ Diku tjetër thoshte: “Njeriu është brenda mureve të fesë, përderisa nuk vret dikë pa të drejtë.”¹⁰

Në Ditën e Gjykimit, njerëzit me sjellje të mirë do t'i kenë pozitë në larta në Xhenet. Muhamedi a.s. ka thënë: "Njerëzit më të afërt me mua në Xhenet do të jenë ata që kanë sjelljet më të mira."

MIRËSJELLJA – NJË NGA VEPRAT MË TË ÇMUESHME

Përderisa sjellja e keqe ishte kërcënim ndaj besimtarit, në anën e kundërt qëndron sjellja e mirë. Ajo gjithëherë ngrit pozitën e vepruesit në shkallë të larta, si në këtë botë, po ashtu edhe në Ahiret. Muhamedi a.s. ka thënë: "Njerëzit më të shumtë do të hyjnë në Xhenet për shkak të devotshmërisë dhe sjelljes së mirë."¹¹

Sjellja e mirë ka shumë segmente në të cilat mund të ushtrohet. Ajo ndonjëherë është të qëndruarit pranë dikujt derisa t'i largohet mërzia, ndonjëherë mund të jetë angazhim për ta ndihmuar vëllain ose motrën për të shlyer një borxh, e herë-herë mund të jetë përpjekje për të ngazëllyer zemrën e dikujt. Muhamedi a.s. ka thënë: "Njerëzit më të dashur tek Allahu janë më të dobishmit për njerëzit, kurse vepra më e dashur tek Allahu është futja e gëzimit në zemrën e dikujt, ose heqja e mërzisë, apo shlyerja e një borxhi, ose largimi i urisë. Të jem në shërbim të një vëllai mysliman në nevojën që ka, për mua është më e vlefshme se të bëj itikaf në xhaminë time një muaj."¹²

Në Ditën e Gjykimit, njerëzit me sjellje të mirë do t'i kenë pozitë në larta në Xhenet. Muhamedi a.s. ka thënë: "Njerëzit më të afërt me mua në Xhenet do të jenë ata që kanë sjelljet më të mira."¹³ Në mesin e veprave të mira, sjellja e mirë do të ketë peshën më të madhe. Muhamedi a.s. ka thënë: "Nuk ka në mesin e veprave të besimtarit diçka peshë më të madhe në Ditën e Gjykimit se sa sjellja e mirë. Zoti nuk e do atë që fyen dhe përdor fjalor të ndytë."¹⁴

Në jetën e përditshme gjejmë shumë njerëz të cilët para se të përqafojnë Islamin, ishin të vrazhdë, jo tolerantë dhe të ashpër në raportet e tyre me njerëz. Shumë prej tyre ishin edhe pjesëmarrës në krime të ndryshme, por pasi që pranuan Islamin, ata u qetësuan, ndryshoi qasja e tyre, u bënë njerëz të butë dhe të mirësjellshëm. Këta shembuj janë të panumërt, si në kohërat e vjetra, po ashtu edhe tani në kohën tonë. Arabët para se të pranonin Islamin, konsideronin se vajzat janë barrë e gjithë fisit, përderisa pas Islamit garonin se kush të fitonte Xhenetin përmes edukimit të vajzave dhe mirësjelljes ndaj tyre.

Shumë njerëz të njohur në muzikë dhe film, para Islamit ishin plotësisht të shfrenuar pas përmbushjes së tekave të tyre, kurse pas pranimit të Islamit ata lanë çdo ves të lig duke u bërë prijatarë edhe në hapjen e fondacioneve të ndryshme bamirësie, në mënyrë që kështu të presin ditën e takimit me Zotin e tyre ballëhapur dhe me bagazh më të madh të veprimeve të mira.

Pra, besimi në Ditën e Gjykimit, besimtarit i jep një vizion më të qartë rreth qëllimit të tij final. Ky besim ndikon në vazhdimësi në përmirësimin e sjelljeve të tij gjatë këtij rrugëtimi. Besimtari kur kërkon mëshirën e Zotit për këtë ditë që do të vije, reflekton në jetën e tij që të jetë edhe vetë burim mëshire. Ai kur kërkon nga Allahu lehtësim të llogarisë në Ditën e Gjykimit, në jetën e përditshme bashkëvepron me lehtësi me njerëzit që ka përreth. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Besimtari është i butë dhe i lehtë (në bashkëpunim)."¹⁵ Pra, sa herë që besimtari kujton ringjalljen para Zotit të Madhëruar, domosdo do të përmirësohet sjellja e tij me njerëzit në tokë, për t'i dhënë besimi në Ditën e Gjykimit vullnetin dhe kujdesin për të vepruar konform ndërtimit të një jete më të mirë në tokë.

- 1 Quhet edhe Dita e Kiametit (Ringritjes), Dita e Madhe, Dita e Shpagimit.
- 2 Shih: Zija Adullahu, *Ndikimi i besimit në sjelljet e besimtarit*, Prishtinë, 2017, f.119.
- 3 Transmetojnë Buhariu (950) dhe Muslimi(8).
- 4 Transmetojnë Ahmedi (12567), Bezari (7196) dhe të tjerë.
- 5 Transmetojnë Buhariu (10) dhe Muslimi (40).
- 6 Transmeton Buhariu (6016).
- 7 Transmeton Muslimi (nr.2581).
- 8 Transmeton Buhariu nr. 2315.
- 9 Transmeton Ahmedi (nr.12549). Imam Munaviu thotë se ky hadith ka isnad të saktë (vërtetë).
- 10 Transmeton Buhariu nr.6862.
- 11 Transmetojnë Tirmidhiu (nr.2004), Ahmedi (9694) dhe Buhariu në "*El Edeb el Mufred*" (nr.289).
- 12 Transmeton Sujutiu (nr.2/298) d.
- 13 Transmeton Tirmidhiu nr 2018.
- 14 Transmetojnë Tirmidhiu (nr. 2002), Ahmedi nr. 27517 dhe Ebu Davudi nr. (4799).
- 15 Transmeton Tirmidhiu (2488).

Ndarja si shtegdalje për një jetë të plasaritur bashkëshortore

Dr. Ejup Haziri

MARTESA ËSHTË DASHURI DHE MËSHIRË

Islami e ligjësoi martesën dhe e bëri atë rrugë të vazhdimësisë dhe përhershshmërisë. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar, i urdhëroi bashkëshortët që të kenë raporte të mira. Ai krijoi mes tyre dashuri dhe mëshirë në mënyrë që martesë e tyre të jetë e fuqishme, e vazhdueshme dhe e qëndrueshme në baza të forta bashkëpunimi, tolerance, qetësie dhe sigurie. Islami e ka bërë të qartë se secili nga bashkëshortët ka të drejta ndaj tjetrit, ashtu siç i mësonte njerëzit i Dërguari i Allahut: “Ju ndaj grave tuaja keni të drejta, por edhe gratë tuaja kanë të drejta ndaj jush...”¹

Kur të drejtat dhe përgjegjësitë kuptohen mirë dhe secili prej bashkëshortëve i di të drejtat, por edhe përgjegjësitë ndaj partnerit tjetër, atëherë çdo gjë do të jetë në rregull dhe mes tyre do të krijohet një klimë e favorshme dhe e përshtatshme.

“ÇONI JETË TË MIRË”

Që të dy i udhëzoi që të kenë marrëdhënie të mira, të jenë të butë ndaj njëri-tjetrit, të mirësjellshëm, të durueshëm dhe t'i falin gabimet e njëri-tjetrit. Allahu i Madhëruar thotë: “... çoni jetë të mirë me to...” (En Nisa, 19).

Për të qenë kjo lidhje sa më e forcuar, Islami u dha hapësirë që ata të njihen mes vete dhe kjo ndikon që ata të lidhen më tepër, të kenë pëlqim ndaj njëri-tjetrit dhe kështu të sigurohet përputhshmëria e tyre. Islami e drejtoi këtë lidhje në mënyrë që të arrijnë qëllimet e martesës përmes përkushtimit të përbashkët ndaj familjes dhe interesave të saj dhe duke u përmbytur skajshmërisht nga divorci. Divorci i përket burrit, sepse ai është më i përmbytur se gruaja dhe mund ta kontrollojë veten më tepër se ajo. Gruaja është më e ngutshme, më emocionale dhe për shkak të ndonjë mosmarrëveshje të

vogël, mund të mos e kontrollojë veten dhe të shkaktojë ndarje.

NË RAST TË PROBLEMEVE NË ÇIFT, TË MBYLLET DERA E NDËRHYRJEVE NGA JASHTË

Përveç kësaj, Islami përcaktoi se si mund të ndodhë divorci, duke përcaktuar edhe numrin e ndarjeve, e caktoi edhe periudhën e pritjes dhe kthimin për të korrigjuar nxitimin dhe vendimin e pakontrolluar. Ai vendosi normën që gruaja gjatë periudhës së pritjes duhet të qëndrojë në shtëpinë bashkëshortore për të qenë sa më afër njëri me tjetrin dhe për të parandaluar ndërhyrjet e jashtme.²

Islami mori parasysh mundësinë e papajtueshmërisë midis këtyre dy zemrave në rast mosmarrëveshjeve dhe nuk e shpërfilli natyrën e shpirttrave që kur shqetësimet e problemet janë të mëdha, ato domosdo çojnë në largim e mosmarrëveshje, por edhe në këtë rast Islami synon që përpjekjet të mos ndalen deri në rivendosjen e harmonisë mes tyre dhe për të mbyllur përçarjen që ka ndodh në familje. Në rast se problemet janë të mëdha dhe ata dy nuk kanë fuqi t'i eliminojnë dhe ta vazhdojnë jetën së bashku, atëherë Islami lejon që kjo derë që ishte e mbyllur për të tjerët, të hapet vetëm për dy familjet e miqësuar, duke përzgjedhur nga një anëtar prej secilës familje, që të marrin përsipër këtë çështje dhe t'i pajtojnë ata: “Nëse i frikësohen përçarjes mes tyre (burrit e gruas), dërgoni një pari të drejtë nga familja e tij dhe një pari të drejtë nga familja e saj. Nëse ata të dy (ndërmjetësuesit) kanë për qëllim pajtimin, Allahu ju mundëson afrimin mes tyre (burrit e gruas). Allahu është i dijshtëm, është njohës i mirë.” (En Nisa, 35).



“Hallalli më
i urryer tek
Allahu i
Lartësuar
është divorci
(ndarja).”

(Muhamedi, a.s.)

NDARJA NUK GUXON TË BËHET PADREJTËSISHT

Islami e ka ndaluar burrin që të bëjë shkurorëzimin në mënyrë të padrejtë ndaj gruas dhe e ka nxitur burrin – edhe në rastin e urrejtjes dhe neverisë së tij ndaj gruas – të jetë i durueshëm, i përmbajtshëm dhe i ndjeshëm ndaj mirësisë që Zoti i Madhëruar ka vendosur në atë grua. Po ashtu e ka nxitur burrin të pajtohet në vend që t’i japë fund jetës bashkëshortore, siç thotë Zoti i Madhëruar: “...*që se bëjnë mes vete mbarim (pajtim). Pajtimi është më i dobishmi...*” (En Nisa, 128). Pajtimi është gjithnjë më i arsyeshëm, më i drejtë, përderisa ka ende një shkëndijë shprese për një ribashkim të mundshëm, ngase ndarja është më e rëndë dhe dëmi është më i madh, sidomos kur çifti kanë edhe fëmijë, që në masë të madhe ata edhe e paguajnë më së tepërmi faturën e divorcit të prindërve të tyre.

NDARJA ËSHTË LEJIMI MË I URRYER

Nëse drejtësia hyjnore refuzon padrejtësinë e një burri ndaj një gruaje, atëherë ajo gjithashtu refuzon padrejtësinë që i bëhet burrit, nëse ai nuk mund të jetë më i durueshëm dhe të vazhdojë jetën bashkëshortore kur kjo jetë bëhet e papërshtatshme për vazhdimësi, për shkak të ndërprerjes së dashurisë nga gruaja e tij, ose një ndryshim radikal që ndodh nga ndonjëri prej bashkëshortëve, etj.. Meqenëse Zoti i Madhëruar nuk e ngarkon një shpirt përtej asaj që mund të përballojë, Ai e ligjësoi shkurorëzimin për burrin në këtë rast duke e cilësuar ndarjen si gjënë më të urryer nga ajo që i lejohet atij.³ Ndonëse parimisht ia ka lejuar, megjithatë ia ka bërë të urryer një veprim të tillë, dhe se një veprim i tillë do të duhej të ndodhte vetëm në rast kur të gjitha dyert e

vazhdimit të martesës janë të mbyllura dhe shanset për të vazhduar një martesë e dinjitetshme janë shumë të vogla. Andaj, i Dërguari i Allahut tha: “Hallalli më i urryer tek Allahu i Lartësuar është divorci (ndarja).”⁴

NDONJËHERË NNDARJA ËSHTË EDHE ILAÇ

Islami është feja e arsyes së shëndoshë dhe feja e lirisë dhe e respektimit të vullnetit njerëzor. Ai nuk i detyron bashkëshortët të jetojnë së bashku, nëse urrejtja mes tyre është e madhe, neveria që ekziston mes tyre veç po rritet dhe ata janë në mosmarrëveshje të vazhdueshme. Për këtë arsye, ishte mëshira e Zotit që të lejonte shkurorëzimin si ilaçin e fundit nëse shërimi është i mundur. Prandaj, Islami e ka përfshirë këtë lejueshmëri me kufizime dhe norma të caktuara që e bëjnë zgjidhjen e shkurorëzimit një fushë tejet të ngushtë, dhe e bën atë, pavarësisht dhimbjes që mund t’u shkaktojë bashkëshortëve dhe problemeve për fëmijët, mëshirë dhe shpëtim nga një mjedis në të cilin të jetosh në një gjendje të tillë është sikur të jetosh në një burg, ku të burgosurit nuk dinë gjë tjetër veçse të durojnë mjerimin, vuajtjet dhe telashet.⁵

Shkurorëzimi nuk lidhet me tekat dhe vullnetin absolut të burrit, përkundrazi, ai kufizohet nga një sërë vendimesh, kufizimesh dhe rregullash, disa prej të cilave kanë të bëjnë me organizimin ligjor të divorcit, disa të tjera kanë të bëjnë me kohën e ndodhjes së shkurorëzimit, e disa prej tyre kanë të bëjnë me numrin e shkurorëzimit, përderisa disa janë të lidhura me pasojat e shkurorëzimit. E gjithë kjo është për të shmangur padrejtësinë ndaj gruas dhe zbatimin e drejtësisë që na ka urdhëruar Allahu dhe aplikimin e rregullit juridik që mbi të cilin bazohet parimi i marrëdhënieve ndërmjet

njerëzve,⁶ i cili rrjedh nga hadithi i të Dërguarit të Zotit, pagja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, i cili ka thënë: “Nuk ka as dëm as ndaj vetes e as ndaj të tjerëve.”⁷

EDHE GJATË NDARJES KA RREGULLA E DISPOZITA

Allahu i Plotfuqishëm e ka bërë legjitime ndarjen kur ajo është e nevojshme apo e domosdoshme. Këtë e bëri në shumë mënyra, për të përfshirë të gjitha arsyet e ndarjes dhe kushdo që e kërkon atë (palët), në mënyrë që të mbrohen të drejtat e të dy bashkëshortëve, si dhe të ruhet vullneti i tyre, të cilin vullnet Allahu gjithmonë ka dashur të jetë i lirë dhe i pakufizuar, por mbi të gjitha Ai vendosi rregulla e dispozita. Rregullat dhe dispozitat janë të ndryshme, varësisht nga lloji i ndarjes, qoftë shkurorezim nga ana e burrit, apo kërkesë e gruas për ndarje apo adresim i çështjes në gjykatë për t'i dhënë fund jetës bashkëshortore, me qëllim që të shmanget dëmi,⁸ të evitohet e keqja dhe të mbrohet dinjiteti i individit, ngase kur ndarjet mes çiftit janë të thella dhe telashet mes tyre kanë prekur kulmin, në raste të tilla, një vazhdim i një marrëdhënie mes tyre është i paarsyeshëm, plotësisht i panevojshëm dhe me rreziqe të mëdha. Në raste të tilla, ndarja, sado e dhimbshme të jetë, është një dritare e re për ta varrosur të kaluarën e shëmtuar dhe për ta mbrojtur jetën dhe dinjitetin nga një e keqe e mundshme që në raste të caktuara mund të jetë edhe fatale.

Megjithëse divorci është i lejuar, por si veprim i urryer dhe mjet i papëlqyeshëm, deklarata fillestare e divorcit apo ndarjes është një refuzim i revokueshëm i cili nuk e ka fuqinë e ndërprerjes së martesës pa kaluar një fazë prej tri cikleve të plota menstruale. Kjo periudhë e pritjes, është një mundësi ideale për t'i dhënë çiftit kohë të mjaftueshme për të menduar për pajtimin e tyre, për të parë veten se a mund të jetojnë pa njëri-tjetrin dhe për të analizuar gjërat brenda një kohe relativisht të gjatë në mënyrë që secili ta korrigjojë veten. Nëse gjatë kësaj periudhe, çifti ka kontakt intim, atëherë automatikisht llogaritet se ata kanë arritur pajtimin dhe e kanë tejkaluar hendekun e ndarjes. Ndarja bëhet e formës së prerë kur skadon koha e pritjes dhe burri e

refuzon gruan për herë të tretë, refuzim, që atij ia pamundëson kthimin e saj, dhe se ata mund të ribashkohen vetëm atëherë pasi që ajo të ketë përfunduar me një martesë të rregullt me një burrë krejtësisht tjetër.

NDARJA, DRITARE E RE PËR NJË JETË TJETËR

Lejimi i divorcit u jep dy bashkëshortëve mundësi për një jetë të re në të cilën ai/ajo mund të jenë të rehatshëm dhe ta arrijnë lumturinë e tyre bazuar në fjalët e Allahut: “*Por nëse ndahen prej njëri-tjetrit, Allahu begaton me mirësinë e Tij secilin prej tyre...*” (En Nisa, 130).

Divorci mund t'i ketë shtyrë bashkëshortët të rifillojnë jetën bashkëshortore, por me një frymë të re dhe trajtim më të mirë. Dihet se vlera e diçkaje nuk duket veçse kur e humbë atë dhe duke u privuar prej saj, dhe veprat e mira të njeriut nuk duken vetëm duke i krahasuar ato me veprat e këqija të të tjerëve. Pra, bekimi i martesës vërehet vetëm pas shkurorezimit, i cili i privon bashkëshortët dhe kjo është ajo që i bën të dy palët të ndjejnë rëndësinë e martesës. Prandaj, nëse kthehen në jetën martesore, ose e provojnë përsëri me një person tjetër, bën që ata të anashkalojnë gabimet dhe të metat e palës tjetër, kështu që jeta bashkëshortore vazhdon në mënyrë

Kur ndarjet mes çiftit janë të thella dhe telashet mes tyre kanë prekur kulmin, në raste të tilla, një vazhdim i një marrëdhënie mes tyre është i paarsyeshëm, plotësisht i panevojshëm dhe me rreziqe të mëdha.





miqësore dhe të mirë, duke i mbyllur sytë dhe duke i toleruar gabimet.⁹

Në këtë rast, do të duhej që martesa e mëparshme, e cila ka rezultuar me divorc t'u jepte atyre mësimet të rëndësishme për një jetë krejtësisht tjetër, duke evituar gabimet që i kanë bërë në të kaluarën, në mënyrë që ato të mos përsëriten në lidhjen e re.

AVENTURIZMI, MANIPULIMI MË I SHKATHËT

Kur jeta bëhet aventurë, atëherë qëllimet e martesës dhe krijimi i familjes më nuk kanë efekt, sepse në skenë dalin manipuluesit e shkathët, që për qejfe e dëshira të tyre janë në gjendje të shkatërrojnë tërë atë që ndoshta e kanë ndërtuar me vite. Aventurizmi është një rrugë e rrezikshme që përmes tërheqjes, mashtrimit dhe fshehjes së vërtetës, e paraqesin veten ndryshe nga ç'janë dhe kështu hyjnë në lojëra të rrezikshme duke e shembur madhësinë e familjes.

TRADHTIA QË NDAN ÇIFTE E SHKATËRRON FAMILJE


Aventurizmi dhe tradhtia sot po shembin familjet, po ndajnë çiftet, po lënë fëmijët "jetimë" dhe po krijojnë probleme të ndryshme. Tradhtia bashkëshortore sot është shndërruar në njërin ndër faktorët kryesorë që po shkatërron martesat. Ajo fatkeqësisht po paraqitet nëpër debate mediatike si një dukuri normale, e cila edhe po arsyetohet fuqishëm duke lënë të kuptohet se ajo asgjë nuk është tragjike. Fatkeqësisht, serialet, emisionet e ndryshme ku bashkohen në një vend gra e burra të (ish)martuar dhe krijojnë lidhje me të tjerë, po paraqesin këtë dukuri si tejet të zakonshme dhe

po lënë gjurmë të këqija në komunitetin tonë, ngase personat e tillë janë figura që admirohen nga të tjerët, andaj edhe ndikimi i tyre është jo edhe aq i vogël.

Andaj, dukuri si këto po shpallmojnë martesat të shumta dhe po shkaktojnë plasaritje në çift. Zakonisht, si aventurizmi ashtu edhe tradhtia, kanë marrë përmasa të frikshme dhe gjithnjë pala tjetër në çift është ajo që e pëson më së shumti. Në rast se personi që tradhton është i papërmirësueshëm, ndarja në këtë rast do të ishte ilaç efikas për palën tjetër në çift.

Kur jeta bëhet e padurueshme nga problemet e shumta, kur besnikëria bashkëshortore shkelet rregullisht dhe kur keqtrajtimi është serioz, në raste të tilla, një jetë e tillë bashkëshortore nuk ka më efekt dhe divorci shihet si shtegdalja më e mirë e mundshme, ngase vazhdimi në atë strehë tanimë është i padobishëm dhe me probleme që gjenerojnë konflikte të pandalshme.

- 1 Ibën Maxhe në Sunen, v.III, f.57, nr.1851; Tirmidhiu në Sunen, v.III, f.459, nr.1163. Hadithi është autentik.
- 2 Tejsir Rexheb et Temimi, *Et Talaku bejne Teasufi-l mutalak ve tefrik-l Kadi*, bot.I, Daru-l Fikr, Kajro, f.31.
- 3 Hadad Suhejr, *Haku-l Mer'eti fi-l Muhaleati liinha akdu-z Zevaxh*, bot. I, Daru-l Beshair el-Islamijeh, Bejrut, f.34-35.
- 4 Ebu Davudi në Sunen, v.III, f.505, nr. 2178. Hadithi është autentik
- 5 Muhamed ed Dusuki, *El Ahval esh Shabsijeh fi-l medhheeb esh Shafijj*, bot. I, Darus-Selam, Kajro, f.149.
- 6 Hadad Suhejr, *Haku-l Mer'eti fi-l Muhaleati liinha akdu-z Zevaxh*, f.32.
- 7 Ibën Maxhe në Sunen, v.II, f.784, nr. 2341. Hadithi është autentik.
- 8 Po aty, f.57.
- 9 Ibrahim, *Ez Zevaxhu ve furukuhu fi-l Fikhi-l islamij*, f. 204-205.



Ndarja me inicimin e gruas (el hul'u)

Dr. Ilmije Kuqi

Martesa është një nga marrëdhëniet më të rëndësishme që një person krijon në jetën e tij, prandaj Ligjvënësi ka theksuar rëndësinë e saj, duke i dhënë asaj një shenjtëri që e bën atë unike në mesin e të gjitha kontratave të tjera për shkak të pasojave serioze që ka në shoqëri. Allahu xh.sh. e ka ligjësuar martesën për të krijuar një jetë bashkëshortore të qëndrueshme, e ndërtuar mbi dashurinë dhe mëshirën ndërmjet bashkëshortëve. Kjo marrëdhënie ka si qëllim mbrojtjen e nderit të njëri-tjetrit dhe sigurimin e lindjes së pasardhësve, duke ruajtur kështu vazhdimësinë e lidhjes martesore.

Megjithatë, ndonjëherë, kjo marrëdhënie përballet me sfida, si mosmarrëveshjet, mungesa e harmonisë dhe mirëkuptimit. Në raste të tilla, nëse mosmarrëveshjet rriten dhe zgjidhjet bëhen të vështira, durimi përfundon dhe jeta bashkëshortore bëhet e pariparueshme, atëherë Islami lejon mjetin e nevojshëm, që është ndarja.

Një nga karakteristikat e legjislacionit islam është se ai nuk kufizon të drejtën për ndarje vetëm te njëra palë; përkundrazi, të dy bashkëshortët mund të bëjnë ndarjen, por çdonjëri ka të drejtën e tij për t'u ndarë sipas rregullave të ndryshme.

E drejta e burrit për divorc është e njohur dhe nuk kushtëzohet pëlqimi i gruas. Arsyeja e kësaj është e lidhur me obligimet financiare që burrat zakonisht kanë ndaj grave të tyre,

Një nga karakteristikat e legjislacionit islam është se ai nuk kufizon të drejtën për ndarje vetëm te njëra palë; përkundrazi, të dy bashkëshortët mund të bëjnë ndarjen, por çdonjëri ka të drejtën e tij për t'u ndarë sipas rregullave të ndryshme.

duke përfshirë sigurimin e nevojave të tyre, fëmijëve dhe mbulimin e shpenzimeve të shtëpisë. Këto përgjegjësi financiare mund të krijojnë një situatë ku burri mund të hezitojë të iniciojë divorcin për shkak të pasojave ekonomike dhe emocionale që mund të sjellin. Kur burri vendos të zgjedhë divorcin, shpesh kjo pasqyron humbjen e shpresës për një marrëdhënie të kënaqshme.¹

Megjithëse burri ka të drejtën e ndarjes, kjo nuk do të thotë se gruaja është e privuar nga kjo mundësi. Legjislacioni islam i ofron gruas të drejtën e kërimit të ndarjes përmes një procesi të njohur si “*el hul*”, duke i mundësuar asaj të ruajë të drejtat e saj.² Ky punim do të diskutojë të drejtën e gruas për ndarje përmes “*el hul*”, duke theksuar rëndësinë e saj në ruajtjen e barazisë në marrëdhëniet martesore.

PËRKUFIZIMI I FJALËS “EL HUL”

Fjala “*el hul*”, në kuptimin etimologjik nënkupton “heqje” ose “largim”.³ Në aspektin etimologjik, ajo nënkupton procesin e ndarjes nga lidhja martesore përmes përdorimit të termit “*el hul*” ose ndonjë termi tjetër me kuptim të ngjashëm, që varet nga pranimi i gruas.⁴

Me fjalë të tjera, *hul'i*, është ndarje me marrëveshje, është një formë e veçantë divorci që i mundëson gruas të kërkojë ndarjen nga burri i saj me kushtin e kthimit të meherit ose një pjese të tij. Duke qenë se shkaku i ndarjes ka qenë ajo, urtësia kërkon që ajo t'i kthejë atij



atë që ai ia ka dhënë, pasi burri mund të martohet me ndonjë tjetër pas saj. Në të kundërt, ai do të dëmtohej dhe do të bëhej objekt talljeje, ndërsa ajo do të ketë lirinë të martohet ose ndahet kur të dojë pa pasur ndonjë dëm, duke e lënë burrin të përballët me athtësinë e ndarjes dhe athtësinë e dëmtimit material.

LIGJSHMËRIA E DIVORCIMIT ME MARRËVESHJE (EL HUL)

Divorcimi me marrëveshje është ligjësuar me Kuran, Sunet, konsensus dhe logjikë. Një nga ajetet që mbështet divorcimin me marrëveshje është: *“E juve (burrave) nuk u lejohet t’u merrni asnjë send nga ajo që u keni dhuruar (si niqah), vetëm nëse që të dy frikësoheni se nuk do të mund t’i ruani dispozitat e Allahut (në bashkëshortësi). E nëse keni frikë se ata të dy nuk do të mund t’i ruajnë dispozitat e Allahut, atëherë për atë, me çka ajo bën kompensim, për ata të dy nuk ka mëkate.”* (El Bekare, 229).

Në këtë ajet, Zoti i Madhëruar i ndalon burrat të marrin atë që u kanë dhënë grave të tyre si mehr. Megjithatë, ky ndalim i përgjithshëm specifikohet me një rregull që është mosbindja e gruas dhe shfaqja e urrejtjes ndaj burrit të saj, deri në atë pikë sa kihet frikë se ajo do të braktisë bindjen ndaj Zotit në atë që ia ka bërë obligim. Nëse ka një frikë të tillë, ata mund të bien dakord të ndahen në këmbim të asaj që burri ia ka dhënë për mehr.

Një argument i qartë i divorcit me marrëveshje, që njëherësh njihet si divorci i parë me marrëveshje që ka ndodhur në Islam, është hadithi i transmetuar nga Ibën Abasi, ku gruaja e Thabit ibën Kajsit shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O i Dërguar i Allahut, nuk po ankoem për moralin e Thabitit ose besimin e tij, por e urrej dhe kam frikë se nëse qëndroj me të, do të bie në mosbesim.” Pejgamberi a.s. i tha: “A ia kthen atij kopshtin e tij?” Ajo tha: “Po.” I

Dërguari i Allahut a.s. i tha (Thabitit): “Prano kopshtin dhe divorcoje atë një divorc.”⁵

Ky hadith tregon lejueshmërinë e hul’it dhe rrjedhimisht legjitimitetin e tij nëse gruaja e urren burrin e saj, dhe ajo çon në mosdhënien e të drejtave palës tjetër dhe shkeljen e të drejtave të Allahut.

Dijetarët janë unanim për lejimin e inicimit të ndarjes me marrëveshje⁶ në raste të tilla, duke theksuar se kjo është një mundësi e ligjshme nëse kanë frikë se bashkëshortët nuk do të jenë në gjendje të zbatojnë dispozitat e Allahut. Kjo gjithashtu përfshin sjelljen e keqe të bashkëshortes ndaj bashkëshortit ose ndjenja të tjera të urrejtjes, si për moralin, fenë ose pamjen e tij.⁷

URTËSIA E LIGJSHMËRISË SË HUL’IT

Legjislacioni islam ka shumë kuptime dhe qëllime të larta që synon t’i arrijë me legjitimitimin e hul’it. Ky legjislacion ka për qëllim dhënien e të drejtës gruas për të mbrojtur veten nga dëmtimi dhe parandalimin e abuzimeve të mundshme nga burri, i cili mund ta mbajë gruan për dëmtim. Kështu, ai i hap rrugën asaj për të kërkuar zgjidhjen e marrëdhënies përmes hul’it. Për më tepër, ai thekson ngritjen e drejtësisë duke i dhënë grave të drejtën për të kërkuar ndarjen dhe burrit të drejtën e divorcit. Kjo tregon se, edhe pse legjislacioni islam përcakton që divorci të jetë në duar të burrit, drejtësia kërkon që gruas t’i jepet e drejta për të kërkuar ndarjen përmes hul’it, duke mundësuar kështu që ajo të ndërpresë marrëdhënien martesore.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se është e ndaluar për një grua të kërkojë shkurorëzimin nga burri i saj pa ndonjë nevojë ose arsye të ligjshme, siç dëshmon i Dërguari i Allahut a.s.: “Çdo grua që i kërkon burrit të saj divorcin pa ndonjë arsye, do t’i ndalohej aroma e Xhenetit.”⁸

NORMA E MARRJES SE KOMPENSIMIT

Norma e marrjes se kompensimit material në këmbim të ndarjes me marrëveshje është si më poshtë:

DIVORCI I INICIUAR NGA GRUAJA

Në rastet kur gruaja kërkon divorcin me kompensim material, është e urryer që bashkëshorti të marrë më shumë se sa i ka dhënë asaj për mehr. Këtë e dëshmon ajeti: *“E juve (burrave) nuk u lejohet t’u merrni asnjë send nga ajo që u keni dhuruar (si niqah), vetëm nëse që të dy frikësoheni se nuk do të mund t’i ruani dispozitat e Allahut (në bashkëshortësi). E nëse keni frikë se ata të dy nuk do të mund t’i ruajnë dispozitat e Allahut, atëherë për atë, me çka ajo bën kompensim, për ata të dy nuk ka mëkate.”* (El Bekare, 229).

Ky ajet tregon se nuk është e lejueshme për burrat të marrin diçka nga ajo që u kanë dhuruar si mehr, përveçse nëse të dy frikësohen se nuk do të mund t’i ruajnë dispozitat e vendosura

nga Allahu në marrëdhënien e tyre martesore. Në këtë rast, gruas i lejohet të ofrojë kompensim për të përfunduar martesën, por për burrin është e qortuar të marrë më shumë se mehri që i ka dhënë asaj.

Hadithi i Profetit Muhamed a.s. në rastin e gruas së Thabit bin Kajs bin Shemasit ilustron këtë më tej. Kur Profeti a.s. e pyeti atë: “A ia kthen kopshtin e tij të cilin ta ka dhënë?” Ajo u përgjigj: “Po, dhe më shumë.” Profeti a.s. i tha: “Sa i përket shtesës, jo, por kopshtin e tij.” Ajo i tha: “Po.” Ai e mori atë dhe atë e la të lirë.⁹ Kjo tregon se kompensimi i referohet shumës së mehrit dhe jo shtesave të tjera.

DIVORCI I INICIUAR NGA BURRI

Nëse divorci me kompensim vjen nga ana e burrit, për shkak të frikës që ai nuk mund të përmbushë obligimet e tij ndaj gruas, ose në rast se ai e urren gruan e tij, pavarësisht se ajo përmbushë detyrat e saj, ose e keqtrajton, përfshirë këtu edhe dhunën ndaj saj, me qëllim që ta detyrojë atë të paguajë kompensimin për të përfunduar këtë marrëdhënie martesore, burri e ka të ndaluar që të marrë ndonjë kompensim material nga ajo.¹⁰ Këtë e mbështet ajeti: “Në qoftë se dëshironi të ndërroini (ta merrni) një grua në vend të një gruaje (të lëshuar), e asaj (të lëshuarës) i keni pas dhënë shumë të madhe, mos merrni prej saj asnjë send. A do të merrni atë pa të drejtë e në mënyrë mizore? Dhe si mund të merrni atë kur njëri-tjetri iu keni bashkuar (në një shtrat) dhe kur ato kanë marrë prej jush një besë të fortë?” (En Nisa, 20-21).

Ajeti shpreh qartë se burri nuk lejohet të marrë asgjë nga bashkëshortja, pavarësisht nëse ajo e pranon, sepse në këtë rast burri është shkaktari, ndërsa bashkëshortja është e detyruar. Në këtë rast, përderisa burri është shkaktari i ndarjes nuk është e drejtë ta shtojë mjerimin duke i marrë edhe pasurinë.¹¹

MARRËVESHJA E NDËRSJELLË PËR DIVORC

Në rastet kur të dy bashkëshortët bien dakord për një divorc për shkak të konflikteve të ndërsjella ose urrejtjes ndaj njëri-tjetrit dhe frikës se nuk do të përmbushin obligimet martesore, nuk është mëkat që grua ja të ofrojë

kompensim material për divorcin, dhe burri ta pranojë atë.¹² Këtë e mbështet ajeti: “E nëse keni frikë se ata të dy nuk do të mund t’i ruajnë dispozitat e Allahut, atëherë për atë, me çka ajo bën kompensim, për ata të dy nuk ka mëkatë.” (El Bekare, 229).

Nga kjo nënkuptojmë se, nëse urrejtja është nga ana e burrit, atëherë ai ka të drejtë në shkukurëzim dhe është një nga të drejtat e tij që mund ta përdorë brenda kufijve të asaj që i është caktuar. Nëse urrejtja është nga ana e gruas dhe ajo frikësohet se nuk do t’i përmbush obligimet e Zotit me të cilat e ka ngarkuar ndaj bashkëshortit të saj, atëherë Islami e lejon atë që të bëjë prishjen e lidhjes martesore me anë të hul’it, dhe kështu largon dëmin që i është shkaktuar, duke i dhënë burrit atë që i kishte marrë në emër të martesës për t’i dhënë fund marrëdhënies me të.

KONKLuzion

Ndarja me marrëveshje (el hul) është një proces që ofron mundësi për të dy bashkëshortët për të përfunduar një marrëdhënie të dështuar pa dhunë ose padrejtësi. Ky proces është i bazuar në pëlqimin e ndërsjellë dhe synon mbrojtjen e të drejtave të secilës palë. Legjislacioni islam e ka bërë të qartë se, duke pasur parasysh respektimin e të drejtave dhe nevojave të secilës palë, ndarja me marrëveshje është një mjet i rëndësishëm për të siguruar drejtësi dhe për të shmangur dhimbjen e vazhdueshme në një marrëdhënie të dështuar.

“E nëse keni frikë se ata të dy nuk do të mund t’i ruajnë dispozitat e Allahut, atëherë për atë, me çka ajo bën kompensim, për ata të dy nuk ka mëkatë.”

(El Bekare, 229).

1 Shih: El Meretu bejne el Fikhi ve el Kanun, fq.90.

2 Shih: Et Tebjin, 2/267, El Inajeh, 4/211, etj.

3 Lisanu el Arab, 8/76, Taxhu el Arus, 20/518, etj.

4 El Bahr, 4/77, dhe Ed Durr el Muhtar, 3/439-441.

5 El Buhari, nr: 5273, 7/47.

6 Et Tebjin, 2/267.

7 Shih: El Inajeh, 4/211, El Lubab, 3/64, etj.

8 Musned Ahmed, nr: 22378, 37/62, Shejh Shuajbi thotë: “Hadithi është sahih”.

9 Darkutni, nr: 3629, 4/377; Sunen el Kubra i Bejhekiut, nr: 14849, 7/514. Ibën Haxheri në Fet’hu el Bari, 9/402, thotë: “Transmetuesit e senedit të tij janë të besueshëm”.

10 Shih: El Mabsut, 6/183, Tuhfetu el Fukaha, 2/200, Fet’hu el Kadir, 4/216, etj.

11 Et Tebjin, 2/269, Durrer el Hukam, 1/390.

12 El Binajeh, 5/506, Lisanu el Hukam, 1/329, etj.

Shëndeti riprodhues nga perspektiva kombëtare dhe fetare islame

Fitim Flugaj

Shëndeti riprodhues i njeriut është një nga tematikat kryesore që na paraqitet kohëve të fundit në hapësirat shkencore-sociale dhe mediatike të ne shqiptarët, për të thënë më mirë, në disa vende të botës dhe në veçanti në shtetet evropiane. Sidomos në ato vende ku familja është bastarduar dhe peshoja pragmatike e ka peshuar dhe dominon ndaj peshores humane-njerëzore dhe idealiste.

Thënë të drejtën, që nga koha e studimeve universitare dhe pasuniversitare, kur i studionim luftërat speciale në shoqërinë njerëzore të cilat kishin filluar më herët, por që marrin hovin e tyre gjatë këtyre dy shekujve të fundit, në shekullin e kaluar XX dhe në këtë shekull XXI, e në veçanti me arritjet e hovshme të revolucionit teknologjik në fushën mediatike, synuesit e këtyre luftërave speciale po i realizojnë qëllimet e tyre shumë më shpejtë.

Motoja e ideologjisë së globalizmit për ta shndërruar botën në një fshat të vogël u realizua shumë shpejtë, dhe kjo falë këtij zhvillimi teknologjik. Por, realizimi i idesë së globalizmit, që peshku i madh ta gëlltit peshkun e vogël, mbeti një pikëpyetje e madhe.

Megjithatë, luftërat speciale të përqendruara në tri drejtime kryesore kanë synime dhe qëllime djallëzore, të cilat shkojnë deri nivelin e shkatërrimit të vetë qenies njerëzore si tërësi, kuptohet pasi ta shkatërrojnë bazën e saj për riprodhim, që është familja, apo institucioni i martesës. Martesa e bazuar në ligjet e natyrës, mbi të cilat ligje Allahu ka vendosur edhe formën dhe mundësinë e riprodhimit dhe shëndetit të riprodhimit, e ajo është martesa e

mashkullit me femrën, duke respektuar dhe mirëkuptuar njëri-tjetrin.

Jam plotësisht i bindur se të gjithë besimtarët e besimit islam që e njohin mirë fenë islame dhe kanë vetëdije të plotë fetare islame, por edhe të tjerët që kanë studiuar thellë sistemet shoqërore dhe fenë, e kanë të qartë se vetëm feja dhe sistemi islam garanton për shoqërinë shëndet të plotë riprodhues.

Martesa e bazuar në ligjet e natyrës, mbi të cilat ligje Allahu ka vendosur edhe formën dhe mundësinë e riprodhimit dhe shëndetit të riprodhimit, është ajo martesë e mashkullit me femrën, duke respektuar dhe mirëkuptuar njëri-tjetrin.

Zhvillimi nën hijen e respektimit të dispozitave të Sheriatit islam dhe ndjekja e rrugëve të udhëzimit hyjnor është një qëllim themelor i ekzistencës. Ne e shohim këtë duke e quajtur tokën “vendbanim”, siç e kuptojmë në kuadër të urdhrit hyjnor për Ademin, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, dhe gruan e tij, pas largimit nga Xheneti për të praktikuar mesazhin dhe misionin e jetës në tokë, duke treguar se aderimi në fe krijon lumturi. Të qenit larg Zotit të Plotfuqishëm pengon rrugën e jetës, krijon ankth dhe vret njerëzit. Zoti i Plotfuqishëm thotë: “Ai (Allahu) u tha: “Zbritni prej aty që të gjithë, do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Nëse u vjen nga Unë udhëzim (libër e pejgamber) kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur (në dynja) e as nuk ka për të dështuar (në jetën tjetër). E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kiametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: “Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?” Ai (Allahu) thotë: “Ashtu si i harrove ti argumentet Tona që t’i ofruam, ashtu je ti i harruar sot.” (Ta Ha, 123-126).

Zhvillimi njerëzor nën hijen e besimit islam është plot me pozitivitet dhe shpie në ekzistencën e kombit më të mirë të krijuar ndonjëherë për njerëzimin. Për këtë arsye, Zoti i Madhëruar ka thënë: *“Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Lehti Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë. Në këtë (që u përmend) ka mjaft argumente për një popull të dëgjueshëm. E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”* (El Enbija, 105-107). Njëpërmjet vargjeve fisnike, vërejmë se trashëgimia e tokës kufizohet vetëm te robërit e drejtë të Zotit, dhe ata janë ata, marrëdhënia e të cilëve me Zotin, Zotin e botëve, është e shëndoshë, ashtu siç ata janë të përshtatshëm për të zhvilluar dhe ndërtuar tokën. Vini re gjithashtu se ajetet fisnike bëjnë të qartë se mesazhi i Profetit ishte mëshirë për botët dhe nën hijen e mëshirës, zhvillimi njerëzor arrihet në formën e tij optimale. Në mungesë të përkushtimit ndaj fesë së vërtetë të Zotit, që është Islami, Zoti na ka përmendur në Kuranin famëlartë se hipokritët bëjnë ngatërresa në tokë dhe nuk e reformojnë atë: *“E kur atyre u thuhet: “Mos e prishni rendin në tokë!” Ata thonë: “Ne jemi vetëm përmirësues! Vini re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë.”* (El Bekare, 11-12). Në kontekstin e asaj që përmendëm, na bëhet e qartë se përkushtimi ndaj fesë islame është arsye për zhvillimin njerëzor dhe pasurimin e aftësive të tyre në fushat e zhvillimit, qoftë zhvillim sasior apo cilësor.

Rritja sasimore në Islam është një qëllim dhe një metodë, dhe ne gjejmë në Kuranin e shenjtë një grup tekstesh që thërresin për pasardhës dhe riprodhim dhe tregojnë se fëmijët janë një nga bekimet e Zotit për qeniet njerëzore. Efekti mbetet i Plotfuqishmi në një shprehje falënderimi për robërit e Tij: *“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisën (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”* (En Nisa, 1). Në lutjen e Zekerijas, paqja qoftë mbi të, drejtuar Zotit të tij, i Madhërishtmi tha: *“Aty në atë moment Zekerijaja e lut Zotin e tij e thotë: “Zoti im, më falë edhe mua nga ana Juaj një pasardhës (fëmijë) të mirë, vërtet, Ti je dëgjues i lutjes.” Në kontekstin e të folurit për robërit e të Gjithmëshirshmit, Zoti i Madhëruar thotë: “(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që thonë: “Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit.”* (Furkan, 74).

Zhvillimi sasior i racës njerëzore është një ligj hyjnor në univers, pasi riprodhimi është një qëllim në të gjitha krijesat e gjalla, kështu që është më i rëndësishëm dhe më i nevojshëm për bijtë e Ademit për shkak të pozitës së tyre të trashëgimisë dhe sovranitetit mbi universin. Ai është i rëndësishëm edhe për detyrën e njohjes me njëri-tjetrin dhe gërshtimin e



interesave, pavarësisht se sa kohë do të qëndrojnë në tokë. Zoti i Madhëruar thotë: *“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëme popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”* (El Huxhurat, 13).

Nëse doktrina islame kërkon zhvillimin njerëzor brenda kornizës së sasisë, kjo nuk do të thotë se sasia është një qëllim në vetvete, por ajo synohet në kuadrin e rritjes së shpirtit, vigjilencës së mendjes dhe kapacitetit. Prandaj, Islami refuzon bollëkun, çdo bollëk pa cilësi efektive. Kjo është arsyeja pse ne shohim në vargjet e mëparshme që mbartin thirrjen për prodhim të bollshëm njerëzor atë që tregon domosdoshmërinë e cilësisë që ngre vlerën e këtij bollëku. Në lutjen e Zekerijas, paqja qoftë mbi të, gjejmë fjalën “Zekerija, alejhi salam, nuk dëshiron pasardhës, por ai dëshiron pasardhës të mirë dhe të drejtë, që do të kenë ndikim efektiv në shoqërinë.” Profeti paralajmëroi kundër teprimit pa peshë, pasi është si një rritje kancerogjene që e lodh trupin dhe nuk i bën dobi. Kjo erdhi në thënien e tij: “Popujt do të mblidhen kundër juve, ashtu siç mblidhen ngrënësit rreth tasit të tyre të ushqimit.” Shokët e tij e pyetën: “O i Dërguari i Zotit, a do të jemi (ne myslimanët) të paktë atë ditë?” I Dërguari i Allahut u tha: “Jo do të jenë të shumtë atë ditë, por ju do të jeni si lumi i përroit dhe Zoti do t’ua heqë frikën nga zemrat e armiqve tuaj dhe do të hedhë dobësi në zemrat tuaja.” “Po ku është arsyeja?” – kur e pyetën, i Dërguari i Zotit tha: Dashuria ndaj (kënaqësive) të botës dhe urrejtja ndaj vdekjes.” (E transmeton Ahmed dhe Ebu Davudi, hadith sahih).¹

Zoti i Madhëruar në Kuranin famëlartë, zhvillimin ekonomik dhe çështjen e jetesës e ka lidhur me besimin, bindjen dhe respektimin e dispozitave të Sheriatit, sepse në këto shtylla islame ka nxitje serioze për punë, përpjekje dhe rritje materiale. Zoti i Madhëruar thotë: *“Dhe sikur banorët e fshatrave të kishin besuar dhe të kishin frikë, Ne do t’u jepnim bekime nga qielli dhe toka, por ata gënijën, andaj Ne i kapëm me atë që ata fitonin.”* (El Araf, 96).

¹ Sahihul Xhamia el Sagir ve Zijadetuhu li el Shejkh el Albanij, f. 8183.

Humanizmi dhe toleranca e myslimanëve përgjatë historisë (1)

Lavdrim Hamja

Kurani, burimi kryesor i dispozitave islame, e ka bërë të qartë dhe e ka vizatuar pastër dhe drejt mënyrën e jetës islame, për secilin mysliman, i cili ka besuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij a.s., në mënyrë që të praktikojë saktë Islamin. Duke u nisur nga kjo, themi se shoqëria islame ngrihet mbi bazën e akides (besimit), prej ku i merr edhe tërë dispozitat dhe ligjet e saj, etikën, rregullin, moralin dhe kjo akide është Islami. Një shoqëri e tillë, e ngritur mbi bazat islame, quhet shoqëri islame.

Humanizmi dhe toleranca janë dy karakteristika prej karakteristikave të tjera të plota dhe të përsosura të Islamit, me të cilat Allahu i Madhëruar i ka urdhëruar robërit e Tij myslimanë të stolisën me to dhe të punojnë sipas tyre kudo që të ndodhen, duke formuar kështu një shoqëri të denjë njerëzore, e cila përgjatë historisë së saj, ka treguar me fakte dhe me vepra, se është shoqëri që nderon jetën dhe respekton të drejtat njerëzore, ndaj kujtdo, pa marrë parasysh se çfarë besimi ka, apo cilës racë i përket.

HUMANIZMI

Në Kuran, fjala njeri përmendet plot 63 herë, ndërsa fjala njerëz përsëritet plot 240 herë. Madje, një sure e tërë ka emrin “Njeriu” (El Insan). Allahu i Madhëruar në Kuranin famëlartë thotë: “O ju njerëz, Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë

Humanizmi dhe toleranca janë dy karakteristika të plota dhe të përsosura të Islamit, me të cilat Allahu i Madhëruar i ka urdhëruar robërit e Tij myslimanë të stolisën me to dhe të punojnë sipas tyre kudo që të ndodhen.

popuj e fise që të njiheni. Me të vërtetë, më i nderuari nga ju tek Allahu është më i devotshmi. Me të vërtetë Allahu është i Ditur, i Gjithënjohur!” (El Huxhurat, 13).

Përsëri, Allahu i Madhëruar në Kuranin famëlartë thotë: “O ju njerëz, kijen frikë Zotin tuaj, i Cili ju krijoi prej një vete të vetme dhe prej saj krijoi bashkëshorten e saj, e prej të dyve krijoi burra shumë e gra. Kijen frikë Allahun, me të Cilin luteni (përbetoheni) dhe farefisnin. Me të vërtetë Allahu është Mbikëqyrës mbi ju.” (En Nisa, 1).

Duke treguar për cilësitë e robërve të Tij të bindur dhe të denjë, Allahu i Madhëruar i përshkruan ata se e nderojnë njeriun, kushdo qoftë ai, pa marrë parasysh se çfarë besimi ka, madje edhe nëse është armik dhe ka dalë për t'i vrarë. Myslimani është person, i cili e vlerëson jetën dhe beson se atë e ka dhënë Zoti, Krijuesi i botëve, dhe se vetëm Ai ka të drejtë ta marrë. Myslimani, në çfarëdo gjendje qoftë, i bindet Zotit dhe zbaton parimet islame me përpikëri dhe se asnjëherë nuk del jashtë këtyre parimeve, dhe se çdo gjë e bën për hir të Zotit dhe për të fituar kënaqësinë e Tij dhe jo për falënderim apo kënaqësi të dikujt tjetër. Në Kuranin famëlartë, Allahu i Madhëruar, duke treguar për humanizmin e besimtarit, thotë: “Ushqejnë me ushqim, nga dashuria e Tij, të varfrin, jetimin dhe robin e luftës. Me të vërtetë ne ju ushqejmë për hir të



Allahut, nuk kërkohet nga ju shpërblim e as falënderim!” (El Insan, 8-9).

Ndërsa, Pejgamberi a.s., në Haxhin e Lamtumirës, iu drejtua haxhilerëve të pranishëm dhe të gjithë myslimanëve e mbarë njerëzimit deri në Ditën e Kiametit, me një porosi të pavdekshme në fushën e humanizmit, e cila duhet të shkruhet me shkronja të arta dhe të promovohet te të gjithë brezat, duke u thënë: “O ju njerëz, Zoti juaj është Një; babai jua është një! Nuk ka dallim një arab nga një jo arab, dhe as një jo arab nga një arab; as një i kuq nga një i zi, dhe as një i zi nga një i kuq, vetëm në devotshmëri. Më i nderuari nga ju tek Allahu është më i devotshmi. A jua kumtova?” I thanë: “Po, o i Dërguar i Allahut”. Tha: “Le t’ia kumtojë i pranishmi atij, që nuk është i pranishëm!”¹

Me këtë porosi të artë, Pejgamberi a.s. vendosi bazat e shoqërisë njerëzore mbi të cilat duhet të ndërtohet marrëdhënia ndërnjerëzore. Të gjithë jemi krijesat e Allahut dhe të tillë duhet të jetojmë dhe duhet të sillemi me njëri-tjetrin.

TOLERANCA

Sado që dikush mundohet ta mbulojë dhe ta deformojë këtë karakteristikë të myslimanëve përgjatë tërë historisë së tyre, që nga koha e Pejgamberit a.s. dhe deri më sot, është e pamundur. Është e pamundur, sepse myslimani ka për kushtetutë fjalën e Allahut, Kuranin famëlartë dhe traditën profetike dhe asnjëherë nuk ka dalë dhe as nuk do të dalë jashtë kësaj kushtetute hyjnore dhe parimeve qiellore.

Nëse Allahu i Madhëruar, Krijuesi i gjithësisë ka toleruar në çështje besimi, që është edhe çështja më madhore e kësaj jete, atëherë për gjëra të tjera as nuk diskutohet dhe as që merren parasysh përpara besimit. Janë disa ajete, në sure të ndryshme, ku Allahu i Madhëruar e bën të qartë se njerëzit i ka lënë të lirë dhe nuk i ka detyruar të besojnë, pra i ka toleruar duke i lënë të lirë të zgjedhin. Ai thotë: “Nuk ka

imponim në fe!” (El Bekare, 256); “Nëse ndonjë prej idhujtarëve të kërkon mbrojtje, atëherë mbroje derisa të dëgjojë fjalën e Allahut, pastaj dërgoje në vendin e sigurt të tij. Kjo, sepse ata janë njerëz, që nuk e dinë!” (Et Tevbe, 6); “Sikur të kishte dashur Zoti yt, patjetër që do të kishin besuar të gjithë mbarë sa janë në tokë. A ti, do t’i detyrosh njerëzit, që të jenë besimtarë?” (Junus, 99).

Duke u nisur nga këto ajete, myslimanët që nga koha e Pejgamberi a.s. dhe përgjatë gjithë historisë së tyre, e deri më sot, dhe deri sa ta ketë shkruar Zoti, do të shpalosin virtytet e besimit të tyre të mishëruara në jetën e përditshme. Për të mos mbetur vetëm te teoria, le të paraqesim disa shembuj ilustrues, se si myslimanët arritën t’i praktikojnë parimet e tolerancës përgjatë rrjedhës së tyre në histori.

Fillimisht, kam dëshirë të filloj me parimin që njihet në shkencën e historisë, ku thotë se, dëshmitë e kundërshtarit (të armikut), që janë pozitive, pranohen dhe merren për bazë, sepse parimisht kundërshtari mohon të vërtetën dhe të drejtën e armikut. Kështu që nëse pala konfliktuese flet pozitivisht, atëherë dëshmia e tyre merret për bazë.

ÇFARË KANË THËNË JOMYSLIMANËT PËR TOLERANCËN E MYSLIMANËVE?

Laura Vecci Vaglieri,² orientaliste italiane, duke folur për marrëveshjet që myslimanët kanë nënshkruar, ka thënë: “Këtyre popujve iu dha e drejta t’i ruajnë e t’i posedojnë fetë, traditat dhe zakonet e tyre të vjetra, me kusht që ata, të cilët nuk e përqafojnë Islamin, t’i paguajnë një taksë të drejtë shtetit islam, që quhet xhizje. Kjo taksë ishte shumë më e lehtë sesa taksa që myslimanët ishin të detyruar t’i paguanin vetë shtetit të tyre. Në shkëmbim të kësaj takse, jomyslimanëve u siguroheshin të drejta dhe mbrojtje, të cilat nuk ndryshonin aspak nga të drejtat dhe mbrojtja që gëzonin vetë myslimanët. Kështu, vepra e Pejgamberit a.s. dhe e kalifëve rashidinë të drejtë, u bë ligj, që myslimanët ishin të detyruar ta ndiqnin. Nuk është aspak teprim të këmbëngulim duke thënë se,

Islami nuk mjaftoi vetëm me thirrjen për tolerancë fetare, por e tejkaloi këtë duke e bërë tolerancën pjesë të ligjit të tij fetar.”³ Gjithashtu, Laura Vecci Vaglieri ka thënë: “Paguani një xhizje fare të lehtë dhe gëzoni mbrojtje të plotë, ose përqafohi fenë islame, hyni në ymetin tonë dhe gëzoni të drejta të njëjta me të drejtat tona.”⁴

Gustav Le Bon⁵ shprehet kështu rreth kësaj çështje: “Xhizje e papërfillshme, shumë më e paktë sesa taksa që paguhej ndaj padronëve të tyre të mëparshëm.”⁶

Lui Massignon⁷ e ka quajtur Islamin në këndvështrimin shoqëror: “Qeveria e barazisë hyjnore, ose Teokratizmi që do barazinë”.

Orientalisti gjerman, Orlish Herman ka shkruar: “Ajo që më ka tërhequr vëmendjen gjatë studimeve të mia për periudhën e mesjetës, është shkalla e lartë e tolerancës që myslimanët gëzojnë, veçanërisht Salahudin Ejubi. Ai ishte shumë tolerant ndaj të krishterëve, madje ai ishte më shumë tolerant sesa vetë të krishterët me veten e tyre. Të krishterët nuk u sollën në të njëjtën mënyrë ndaj Islamit. Islami është fe tërheqëse, kjo ndoshta ka të bëjë me qartësinë e mesazhit islam dhe për shkaqe të tjera, të cilat nuk i di. Në qoftë se shikojmë Afrikën, aty ku grupet islame dhe të krishtera qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, (natyrisht përpjekjet janë për pastrimin e popullsisë nga idhujtaria), do të gjejmë se fitorja i takon Islamit. Kjo, siç thashë më sipër, ndoshta vjen si rezultat i qartësisë së mesazhit islam dhe gjithashtu nga forca tërheqëse e mesazhit moral islam.”⁸

Robertson shkruan:⁹ “Pasuesit e Muhamedit a.s. janë populli i vetëm, që janë bashkuar mes përkushtimit fetar dhe tolerancës së tij. Pra, njerëzit së bashku me kapjen e tyre të fortë për fe, nuk kanë detyruar me forcë askënd të pranojë fenë e tyre.”¹⁰

Prej shembujve praktik të parimeve islame të tolerancës është edhe qëndrimi i shejhul islam, Ibën Tejmije, në kohën kur tartarët sulmuan Shamin. Shejh Ibën Tejmije shkoi te Katlushah për t’i kërkuar të lironte robërit. Komandanti i tartarëve e lejoi shejh Ibën Tejmijen të lironte robërit myslimanë dhe refuzoi t’i lironte njerëzit e ‘dhimmes’ (mbrojtjes). Ibën Tejmije i vendosur i tha: “Jo, nuk pranojmë ndryshe, veçse t’i lirosh të gjithë robërit, jahudi dhe të krishterë, sepse ata janë nën mbrojtjen tonë dhe nuk lëmë asnjë rob, as prej ‘dhimmes’ (mbrojtjes) e as prej fesë sonë.” Kur ai pa këmbënguljen e tij, ia liroi të gjithë robërit!”¹¹

Porosia e Ebu Bekrit r.a. për ushtrinë e Usame ibën Zejdit: “O njerëz, qëndroni pak t’ju jap 10 këshilla, të cilat t’i mësoni përmendsh:

Mos tradhtoni dhe mos plaçkitni;

Mos u tregoni të pabesë dhe mos masakroni;

Mos vrisni fëmijë;

Mos vrisni gra dhe pleq;

Mos prisni dhe mos digjni pemë;

Mos shkatërroni të mbjellat;

Mos mbysni kafshë, përveç nëse detyroheni për të ngrënë;

Rrugës ngado të kaloni, do të gjeni njerëz, të cilët janë mbyllur dhe janë përkushtuar nëpër manastire dhe sinagoga. Lërinë në punën e tyre dhe në atë që janë përkushtuar;

Gjatë rrugës, njerëzit mund t’ju ofrojnë ushqime dhe në qoftë se hani prej tyre përmendni emrin e Zotit, bëni Bismilah;

Ndërsa, kur të takoheni me armikun, me ushtarët që kanë dalë për t’ju luftuar, ata vritini.

Tani vazhdoni rrugën me emrin e Allahut, Bismilah.”¹²

“Marrëveshja Umerite”

Bismilahi Rrahmani Rrahim

Të drejtat që robi i Allahut, Umeri, prijësi i besimtarëve, ua dha banorëve të Iljes:¹³

“U jep atyre siguri për veten, pasurinë, kishat dhe kryqet e tyre. Për njerëzit e sëmurë, të shëndoshë dhe kushdo qofshin ata. Kishat do të qëndrojnë ashtu siç janë, nuk do të shkatërrohen dhe as nuk do të ndryshohen. Nuk do të konfiskohet asgjë prej pasurisë së kishave dhe as prej pasurisë së tyre. Njerëzit do të jenë të lirë dhe nuk do të detyrohen dhe as nuk do të ushtrohet presion mbi ta për të ndryshuar fenë.”

Për çdo gjë që është shkruar në këtë marrëveshje, ka besën e Allahut, garancinë e të Dërguarit të tij, të kalifëve dhe të gjithë myslimanëve.

Dëshmitarë për këtë marrëveshje janë: Halid ibën Velid, Amër ibën Asi, Abdurrahman ibën Auafi dhe Muavije ibën Ebu Sufjani. Marrëveshja u nënshkrua në vitin 15 h-637.¹⁴

1 Hadith me zinxhir të saktë nga Xhabir ibën Abdilah r.a..

2 Laura Vecci Vaglieri, profesoreshë e gjuhës arabe në Universitetin e Napolit. Ka një libër të përkthyer arabisht që titullohet “*Difaun anil Islam*” (Në mbrojtje të Islamit).

3 *Difaun anil Islam*, Laura Vecci Vaglieri, fq. 34-35.

4 *Po aty*, fq. 32.

5 Gustave Le Bon (1842-1931), filozof dhe sociolog francez. Prej librave të tij të shtrenjtë është “*Hadaretul arab*” (Qytetërimi arab).

6 “*Hadaretul arab*” (Qytetërimi arab), Gustave Le Bon, fq. 134.

7 Lui Massignon (1883-1962), orientalist francez, i cili i ka kushtuar rëndësi përhapjes së botimeve Halaxh.

8 *Alem*, nr. 290, e shtunë, më 2 shtator 1989.

9 William Robertson Smith (1846-1894), orientalist skocez.

10 *Hadir alemil islamij*, 1/104.

11 Mexhmul-Fetava, Shejhul islam Ibën Tejmije; mblodhi dhe renditi, Abdurrahman ibën Muhamed ibën Kasim en Nexhdi dhe djali i tij, Muhamedi, v. 28, f. 617-618, me shkurttime, botim Darul Ihja el Kutub el Arabije.

12 *El Kamil fit Tarih*, 2/227, Tabariu, 3/226.

13 Ilja: emri i qytetit të shenjtë Bejtul Makdis, kuptimi i saj: Shtëpia e Allahut. Shih: *Mu’xhemul Buldan*, 1/293.

14 Tabariu, 3/609, Jakubij, 2/167.

Karta e Medinës dhe esenca e saj

Nehat Shehu

Është prej gabimeve më të mëdha fakti që shumë historianë e konsiderojnë Magna Kartën angleze si kushtetutën e parë të shkruar. Sipas kërkimeve të dijetarëve dhe hulumtuesve të mirëfilltë del që Karta e Medinës është kushtetuta e parë e shkruar nga njerëzimi. Karta e Medinës i paraprinë kushtetutës amerikane të vitit 1787 dhe Magna Kartës angleze të vitit 1215.

KONCEPTI I KARTËS

Kushtetuta e parë me shkrim e Medinës, e njohur edhe si Karta e Medinës, është hartuar dhe shpallur nga Pejgamberi a.s. në vitin 622 për popullin e Medinës, i cili përfshinte jo vetëm emigrantët dhe myslimanët lokalë, por edhe hebrenjtë (jehudët) dhe jomyslimanët e tjerë dhe fiset e tyre jomyslimane. Kushtetuta kishte për qëllim rregullimin e jetës së një shoqërie multi-fetare e që numri i kësaj shoqërie të Medinës arrinte në dhjetë mijë. Kjo kushtetutë e shkruar i dha shoqërisë medinase konceptin e shpërnguljes së pushteteve, që më vonë u bë baza praktike e demokracisë. Ajo siguroi një aftësi të moderuar dhe të balancuar për të gjitha komunitetet që jetonin në atë shoqëri. Për herë të parë në histori, ajo lindi idenë e një vendi gjeografik, i cili do të përfshinte të gjitha besimet dhe kulturat në një popull të vetëm. Koncepti i sundimit të ligjit, gjithashtu, doli nga kjo kushtetutë, për herë të parë. Ai siguroi konceptin e respektimit të ligjeve lokale dhe zakoneve të të gjitha fiseve dhe feve që jetonin së bashku. Ai garantoi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e të drejtave të grave, të drejtat sociale, të drejtat kulturore, lirinë fetare dhe të drejtat e pakicave që jetonin në shtet. Ajo e shpalli Medinën si një shtet të paqes dhe sigurisë, i lirë nga çdo lloj dhune dhe terrorizmi. Profeti a.s. më pas themeloi shtetin e parë islam. Ky është një dokument i shquar politiko-kushtetues dhe konstituimi i parë i shkruar i demokracisë në historinë njerëzore. Të gjitha kushtetuta më vonë u themeluan mbi të. Parimet e saj janë të bazuara në Kuran dhe Sunet. Ky dokument është konsideruar

Kushtetuta kishte për qëllim rregullimin e jetës së një shoqërie multi-fetare, e që numri i kësaj shoqërie të Medinës arrinte në dhjetë mijë.

nga dijetarët dhe mendimtarët myslimanë si kushtetutë e shtetit të parë islam, e themeluar nga Profeti Muhamed a.s. në Medinë në vitin 622. Thelbi i këtij dokumenti ishte të shqyrtojë klauzolat kryesore të këtij dokumenti së bashku me komentet e shkurtra mbi idetë e tyre kryesore. Objektivat e këtij shqyrtimi janë të trefishta. Migrimi i Profetit a.s., nga Meka në Medinë, formoi një pikë kthese të rëndësishme në rrjedhën e historisë islame, duke pasur parasysh atë që e themeloi dhe që bëri një ndryshim të thellë e rrënjësor, si në nivelin politik, social, ashtu edhe në atë ekonomik. Historianët janë të një mendimi se migrimi ishte një deklaratë për shfaqjen e shtetit islam. Që nga momenti kur mbërriti në Medinë, Profeti a.s. filloi punën për të mbështetur shtyllat e vendit të ri islam mbi themele të forta.¹ Kjo kartë ndër të tjerat synonte: 1. Lidhjen e myslimanëve me Allahun e tyre të Plotfuqishëm, duke themeluar xhaminë dhe duke thirrur besimtarët në të me anë të ezanit; 2. Raportin e mirë ndërmjet myslimanëve, duke bërë vëllazërimin e ensarëve dhe muhaxhirëve dhe

duke vendosur themelet e një shoqërie islame; 3. Lidhjen mes myslimanëve dhe jomyslimanëve (ithtarëve të Librit), duke vendosur nenet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërmjet tyre; 4. Ndërtimin i infrastrukturës së qëndrueshme në qytet-shtetin e ri, kjo duke u themeluar lagjet e ndryshme, e pastaj duke u themeluar institucionet, rrugët, tregjet etj.;² 5. Mbrojtja e shtetit të ri, duke formuar edhe ushtrinë, e cila do ta mbronte këtë shoqëri në rast të kanosjes së ndonjë rreziku nga armiku.

Pra, Kushtetuta ose Karta e Medinës u formua gjashtë shekuj para Magna Kartës angleze. Ajo u ekzekutua dhe u zbatua për 10 vjet dhe u zbatua nga 10,000 qytetarë që jetonin në Medinë në atë kohë. Në fillim, dihet se %45 e popullsisë së përgjithshme në Medinë përbëhej nga arabë jomyslimanë, %40 përbëhej nga hebrenj dhe vetëm %15 përbëhej nga myslimanë. Këto shifra u regjistruan nga vetë Profeti a.s. përmes një regjistrimi, që ai kishte porositur. Me fjalë të tjera,

Profeti a.s. hartoi Kartën e Medinës si një sovranitet për pakicat. Qëllimi i tij ishte të qeverisnin një shoqëri multi-fetare pluraliste, në një mënyrë që lejonte lirinë fetare për të gjithë. Karta përbëhet nga 47 klauzola, të cilat përcaktojnë formimin e një shteti sovran kombëtar me një shtetësi të përbashkët për të gjitha komunitetet. Karta mbron të drejtat themelore të njeriut për të gjithë qytetarët, duke përfshirë barazinë, bashkëpunimin, lirinë e mendimit dhe lirinë e fesë. Paragrafi 25 thekson në mënyrë specifike se hebrenjtë dhe arabët jomyslimanë kanë të drejtë të praktikojnë besimin e tyre pa asnjë kufizim. Shkurt, Karta e Medinës ishte dokumenti i parë në histori për të vendosur lirinë fetare si një e drejtë themelore kushtetuese. Sipas Mark Grahamit, madhështia e Muhamedit a.s. qëndronte në politikë, po ashtu edhe në frymëzim. Një nga ngjarjet më të jashtëzakonshme që do të ndodhnin gjatë kësaj kohe ishte hartimi i Besëlidhjes së Medinës (Sahifetu el Medineh), të cilën, disa e konsiderojnë si Kushtetutën e parë të botës. Besëlidhja ishte një traktat mes arabëve dhe hebrenjve të qytetit. Të gjitha grupet (myslimanët, hebrenjtë dhe arabët jomyslimanë) u zotuan të jetojnë në harmoni qytetare, të qeverisur nga këshilla dhe konsultimi reciprok. Pakti i lidhi këto grupe të ndryshme në një pakt të përbashkët mbrojtës dhe përcaktoi se hebrenjtë e qytetit ishin një bashkësi me myslimanët, se ata ishin të lirë të praktikonin fenë e tyre. Ky dokument ishte një hap revolucionar përpara një qeverisjeje civile. Pavarësisht nga disa mosmarrëveshje ndërmjet myslimanëve dhe hebrenjve në Medinë, ky plan i tolerancës ndër-fetare do t'i shërbejë Islamit dhe popujve të tij në të ardhmen.

Shteti i parë islam nuk u themelua nën hijen e shpatave, siç besohet zakonisht në disa qarqe, por nën sigurinë e një kontrate shoqërore, që quhet Kushtetuta e Medinës. Nga të gjitha akuzat, Kushtetuta e Medinës ndezi pishtarin e lirisë, duke formuar një shtet të lirë për një komunitet pluralist të përbërë nga myslimanë, hebrenj e paganë. Ky shtet i pashembullt, i lirë, i pari i këtij lloji në historinë intelektuale dhe politike të qytetërimit njerëzor, u themelua nga vetë Profeti a.s. në vitin 622, domethënë më shumë se 1300 vjet përpara Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut (1948), si dhe parashikonte një shtet modern të tolerancës pluraliste, fetare, aty ku të gjithë jetonin të qetë, të lumtur, e kurrë të cenuar nga dikush për shkak të përkatësisë së tyre etnike apo fetare apo racore. Kjo ishte Karta e Medinës dhe ky ishte sistemi në shtetin e formuar nga Profeti a.s..^{3 4}

RËNDËSIA E KARTËS SË MEDINËS

Karta e Medinës është një dokument historik, jo vetëm në historinë myslimane, por edhe në historinë kushtetuese të botës. Ky statut i përmbledhni të gjitha aspektet e jetës në Medinë, përfshirë edhe jetën politike, fetare dhe shoqërore. Arritja e saj më e madhe ishte sjellja e fiseve luftarake së bashku për të formuar një qeveri dhe vendosja e paqes afatgjatë në mes tyre. Ai i dha fund anarkisë mbizotëruese dhe mbrojti jetën, lirinë, pronën dhe lirinë fetare të të gjithë njerëzve të përfshirë në marrëveshje. Ajo themeloi një shtet ku të drejtat dhe përgjegjësitë e barabarta u siguruan realisht



për të gjithë qytetarët. Karta e Medinës zëvendësoi fisnikërinë fisnore me një rend të ri shoqëror dhe krijoi një shtet kombëtar me një strukturë të re shoqërore, ku të gjithë ishin të barabartë dhe nuk kishte dhunë e padrejtësi ndaj askujt, por kishte bashkëjetesë, liri të besimit, të mendimit, të zhvillimit të jetës dhe mbi të gjitha synohej bashkëpunimi mes të gjithë shtetasve në të mirën e shtetit të ri e të sapoformuar.⁵

KARTA E MEDINËS DHE OBJEKTIVAT MADHORE TË SAJ

Karta e cila vendos bazat kushtetuese të qeverisjes nga ana e profetit Muhamed a.s., nuk cek veçse parimet madhore dhe qëllimet më sublimë të sheriatit islam. Ajo nuk ndalet te degëzimet dhe ligjet e detajuara të cilat pranojnë interpretim dhe mund të ndryshojnë sipas kohës dhe vendit. Karta vendos parimin e lirisë së besimit dhe fesë: "Hebrenjtë kanë fenë e tyre dhe myslimanët kanë fenë e tyre", gjë e cila e zhvesh Muhamedin a.s. nga çdo formë imponimi dhe pushteti, edhe pse ishte udhëheqësi i shtetit. Liria e besimit ishte e garantuar, bazuar në tekstin e Kartës së Medinës, për të gjithë qytetarët e shtetit të ri. Islami ua garantoj njerëzve liritë e tyre, u garantoj lirinë për të zgjedhur, sepse Islami e njeh natyrën e njeriut, atë natyrë me të cilën e krijoi vetë Zoti i gjithësisë. Në shumë ajete, Kurani e thekson të drejtën e njerëzve për të zgjedhur besimin e tyre me liri të plotë, ndër to: "S'ka detyrim në fe." (El Bekare, 256); "Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata që gjenden në tokë. Vallë, ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?!" (Junus, 99).

Një nga bazat themelore të bashkëjetesës që gjendet në Kartën e Medinës është edhe drejtësia. Karta në fjalë e vendosi drejtësinë si një parim kushtetues të qeverisjes së shtetit. Ai ishte parim i bashkëjetesës mes qytetarëve të shtetit që udhëhiqej nga Muhamedi a.s.. Teksa lexon pikat e Kartës, të bie në sy përsëritja e fjalës "drejtësi" e cila përmendet plot tetë herë. Karta flet edhe për detyrat e secilit, si në gjendje paqeje, ashtu edhe në gjendje lufte. "Hebrenjtë përballojnë jetesën e tyre dhe myslimanët të tyren." Këtu bëhet fjalë për gjendjen e paqes. Kurse në rast lufte: "Hebrenjtë shpenzojnë për luftën bashkë me myslimanët, përderisa luftohen si shoqëri." Kjo

është përsëritur edhe në pikën 24 të Kartës së Medinës.

Karta thekson se drejtësia e plotë dhe gjithëpërfshirëse është e garantuar për të gjithë dhe se “Këtë Kartë nuk e shkel veçse një zullumqar dhe gjynahqar.” Karta u garanton të drejtën e lëvizjes së lirë të gjithë qytetarëve njëloj. “Kushdo që del jashtë Medinës është i sigurt, kushdo që qëndron në Medinë është i sigurt, përveç atyre që bëjnë padrejtësi dhe parregullsi.” Karta mbyllet me fjalët: “Zoti e mbrojte atë që sillet drejt dhe i frikësohet Atij. Muhamedi është i Dërguari i Zotit.”

Drejtësia ndërmjet qytetarëve dhe ndërmjet tyre e pushtetarëve, konsiderohet me të drejtë si një nga parimet e para kushtetuese të shariatit islam. Në Kuran, Zoti urdhëron për diçka të tillë në shumë ajete në mënyrë të qartë, të pakontestueshme dhe që nuk lënë vend për interpretim. “Zoti urdhëron për drejtësi dhe mirësi.”

Karta e Medinës thekson se drejtësia e gjyqësorit është baza për garantimin e bashkëjetesës mes qytetarëve të shtetit. “Kush vret pa të drejtë, dënohet me vdekje, përveç në rastin kur familjarët pranojnë dëmshpërblimin.”⁶ Karta i obligon të gjithë qytetarët që të jenë kundër zullumqarit, si një dorë e vetme dhe se nuk ka rrugë tjetër veçse ta ndihmojnë njeriun që i është bërë padrejtësi. Karta ka hedhur bazat e një parimi gjyqësor të rëndësishëm, siç është distancimi nga mbështetja e kriminelëve dhe keqbërësve, duke mos i strehuar dhe fshehur, sepse kjo cenon drejtësinë. “Nuk i lejohet një besimtari që e ka pranuar përbajtjen e kësaj Karte, që ka besuar Zotin dhe botën tjetër, që të ndihmojë kriminelin dhe ta strehojë atë. E nëse e bën këtë, mbi të qoftë mallkimi i Zotit dhe i engjëjve, mbi të qoftë zemërimi i tyre ditën e Kiametit. Kjo vepër e tij nuk mund të dëmshpërblehet dhe për të nuk ka pendim.”⁷

Njëkohësisht, Karta thekson një parim tjetër gjyqësor të rëndësishëm, përgjegjësinë individuale për çdo krim të kryer dhe për rrjedhojë, edhe dënimi është personal, vetëm për personin që e ka kryer atë. Askush tjetër nuk mund të mbajë përgjegjësi në vend të autorit të krimit. Diçka të tillë, Karta e thekson në më shumë se një nen të saj “Përveç atij që bën krim dhe padrejtësi, për të cilën nuk mban përgjegjësi askush tjetër veç tij.” “Nuk ngarkohet me përgjegjësi askush për fajin e një tjetri.” Karta e Medinës hodhi bazën e lirisë së besimit dhe zgjedhjes së fesë. “Hebrenjtë kanë fenë e tyre dhe myslimanët të tyren”. Kështu, nuk i lejohet askujt t’i imponojë dikujt tjetër një besim të caktuar. As vetë të Dërguarit të Zotit a.s., i cili ishte në cilësinë e udhëheqësit legjitim të shtetit, nuk i lejohej t’ia impononte besimin ndokujt. Karta në fjalë i garantonte lirinë e besimit të gjithë qytetarëve të shtetit të Medinës. Këto ishin ndryshime që në total i kishte sjellë

“Kush vret pa të drejtë, dënohet me vdekje, përveç në rastin kur familjarët pranojnë dëmshpërblimin.”

(Muhamedi, a.s.)

Islami, por që ritheksoheshin edhe njëherë nëpërmjet kësaj Karte.

Përgjegjësinë individuale e thekson Kurani në disa ajete, ndër të cilat: “*Asnjë shpirt i ngarkuar nuk do të mbartë barrën e tjetrit.*” (Fatir, 18); “*Çdo njeri është peng i veprave të veta.*” (Tur, 21).

Vlera e bashkëjetesës mes qytetarëve të shtetit të ri, të cilën e theksoi Karta e Medinës, i nxiti qytetarët për ta vënë në praktikë dhe për ta konsideruar si virtut të madh ndihmën ndaj njëri-tjetrit, këshillën dhe respektin. Karta hodhi bazën e parimit për domosdoshmërinë e mbështetjes së njerëzve ndaj të cilëve bëhen padrejtësi dhe persekutohen. “Askush nuk mban përgjegjësi për shkeljet e tjetrit dhe se i persekutuari duhet të gëzojë mbështetje.” Në Kartë theksohet se komunikimi me respekt dhe mirësi, ndihmon për bashkëjetesën mes qytetarëve.

Të drejtat e fqinj, Karta e Medinës, i barazon me të drejtat e njeriut dhe se fqinji duhet të kërkojë lejen e qytetarëve të tjerë për të marrë në mbrojtje një person nga jashtë. Kushdo që e respektonte këtë marrëveshje nga hebrenjtë, do të gëzonte

mbështetjen dhe ndihmën e myslimanëve, pra kishte barazi në të drejta qytetare.⁸ Një parim tjetër i theksuar nga kjo kartë kushtetuese, rreth jetesës së përbashkët, ishte se një popull i vetëm i një shteti, mund të përbëhej nga një diversitet fetar, racor dhe kulturor, ku të gjithë ndanin njëloj si të drejtat, ashtu dhe detyrimet financiare dhe ushtarake dhe që gjykohehin nga të njëjtat ligje të drejtësisë. Përgjegjësia e akteve kriminale do të ishte individuale dhe do të ndëshkohej vetëm personi që kryen krimin. Të gjithë do të gëzonin të njëjtat të drejta, do të ndanin po të njëjtat detyrime, do të respektonin normat morale, fqinjësinë e mirë. Në detyrimet dhe të drejtat politike, kushtetuese, ekonomike, ushtarake dhe pjellore, të gjithë qytetarët ishin njëloj, pavarësisht përkatësive fetare dhe etnike.⁹ Karta i jep të drejtën secilit grup që të ketë praktikata e veta, të cilat kanë të bëjnë me anëtarët e grupit dhe që nuk bien ndesh me të drejtat dhe detyrimet publike të të gjithë qytetarëve. Vihet re se Karta cek grupin e besimtarëve myslimanë që përbëhej nga muhaxhirët mekasë dhe mikpritësit medinas, ashtu siç cek edhe hebrenjtë, pavarësisht fiseve dhe aleatëve të tyre. Ajo cek edhe disa idhujtarë. Karta e ka shtjelluar qartësisht respektin për identitetin e çdo grupi brenda identitetit publik të shtetit. Ajo u ka njohur disa të drejta specifike myslimanëve, ashtu siç e ka bërë edhe me hebrenjtë, ndërkohë që i obligon të gjithë me detyrime të cilat nuk prekin identitetin e çdo grupi. Në Kartën e Medinës shohim se liria, drejtësia, barazia, respekti, mbrojtja, këshilla, janë të drejtat e çdo qytetari dhe individi të shtetit të Medinës, pavarësisht përkatësisë së tij ndaj një



grupi apo një tjetri, pavarësisht besimit dhe bindjes së tij në një fe apo një tjetër.¹⁰ Karta ua linte portën e hapur të gjithë qytetarëve hebrenj, që nëse u bëhet ftesë për paqe, t'i përgjigjen, ashtu siç i obligonte të gjithë besimtarët myslimanë që t'i përmbahen marrëveshjes përveçse me armiqtë në fe. Teksa lexon këtë Kartë, të vjen ndërmend marrëveshja dhe besa që profeti Muhamed a.s. ua dha të krishterëve të Nexhranit, në paktin me të cilët shkruhej: "Banorët e Nexhranit dhe rrethinat e tij, kanë besën e Zotit dhe të Muhamedit, të Dërguarit të Zotit, për pasuritë, jetën, tokat, fenë, njerëzit prezentë dhe ata në udhëtim, si dhe gjithçka tjetër që është në duart e tyre, sado e vogël apo e madhe të jetë. Nuk ndryshohet asnjë nga peshkopët e tyre, asnjë murg dhe prift. Tokat e tyre nuk do t'i shkelë ushtria. Kushdo prej tyre që kërkon një të drejtë, do t'i jepet sipas drejtësisë, përderisa nuk kanë bërë padrejtësi."¹¹

DIVERSITETI – LIGJ HYJNOR

Karta e Medinës, apo "Pakti i Medinës" për të cilën Muhamedi a.s. tregoi interes të madh derisa e hodhi në letër, hodhi themelet e bashkëjetesës mes qytetarëve të qytetit të ri të ri themeluar nga ai, qytet të cilin e udhëhiqte ai vetë. Pasi u vendos në Jethrib, ai ia ndryshoi emrin duke e quajtur Medine, vëllazëroi mes muhaxhirëve mekas dhe vendasve, edhe pse i përkisnin fiseve nga më të ndryshme. Pastaj, ai ngriti shtetin e parë islam të pavarur.

Kushtetuta e Medinës shpalli parimet e qeverisjes së shtetit të ri, detyrimet e qytetarëve, marrëdhëniet mes tyre dhe lidhshpëtimin që në këtë rast ishte profeti Muhamed a.s. dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet kushtetuese. Leximi i këtij pakti na njeh me një tekst kushtetues të pashembullt dhe të panjohur më parë në historinë e mendimit njerëzor. Ai është unik për nga bashkëjetesa që përcjell mes qytetarëve të ndryshëm të një shteti të porsalindur. Një ndër parimet madhore që pikaset kollaj në këtë kartë është dhe ai i diversitetit, pranimit i tjetrit pavarësisht besimit, racës dhe kulturës. Karta në fjalë, ua njohu hebrenjve të drejtën e të qenit një komb, bashkë me besimtarët myslimanë. Kjo nuk ishte një e drejtë që u njihej vetëm hebrenjve të fisit Benu Auf, por përfshinte edhe hebrenjtë e fiseve Benu Nexhar, Benu Harith, Benu Saide, Benu Xheshm, Benu Thalebe, Benu Eus, Benu Xhifne etj..

Karta e Medinës ishte ajo që e themeloi dhe e qartësoi këtë parim për të gjithë qytetarët. Sipas saj, myslimanët dhe hebrenjtë në Medine, në shtetin e profetit Muhamed a.s., konsiderohen si një komb i vetëm: "Hebrenjtë e Benu Auf, janë qytetarë të një kombi bashkë me myslimanët. Hebrenjtë kanë fenë e tyre, kurse myslimanët fenë e tyre. Këtu bëjnë përjashtim vetëm ata që bëjnë padrejtësi, por që marrin në qafë vetëm veten dhe familjen." Në këtë Kartë, ceket qartë theksimi që Islami i bën pranimin të diversitetit fetar. "Hebrenjtë kanë fenë e tyre dhe myslimanët fenë e tyre." E megjithatë, pas kësaj ceket fakti se të dy palët përbëjnë një kombësi të vetme politike dhe kushtetuese, edhe pse secili ka fenë e vet përkatëse. Me këtë rast, vlen të përmendim atë që ceket në Kuranin fisnik: "Ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time." (El Kafirun, 6).

Në fund, mund të themi se Karta e Medinës është një shembull historik i përpjekjeve për të krijuar një shoqëri të drejtë dhe harmonike, ku grupet e ndryshme fetare dhe etnike mund të bashkëjetojnë në paqe dhe respekt reciprok. Ky dokument tregon se Profeti Muhamed kishte një vizion për një komunitet të bashkuar dhe të drejtë, ku të gjithë anëtarët respektojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin.

1 Ali Muhammad Sallab, *Yehud el Madina: Ahd el Resul we el-'Ahd el Rashidi*, Mektebe et Tevbeh, 2008, f. 310.

2 Po aty, f. 311.

3 Abdulkadir Tash, *Diraseh Tahlilije li vethikatu el Medine el Munevere*, Dar el fikr, 2000, f. 200.

4 Fatime Ebu Alij, *Jehud el Medine fi dhil el hadara el islamije*, Dar el Xhejl, 2010, f. 245.

5 <https://www.zaninalte.al/2015/03/vlerat-e-bashkejeteses-dhe-parimet-e-saj-ne-karten-e-medines/>

6 Ali Muhamed Sallab, f. 315.

7 Po aty, f. 315.

8 Husejn Munis, *Dirasat fi Vethikat el-Medina*, Merkez ed-dirasat el arabije, 1995, f. 210.

9 Po aty, f. 211.

10 Po aty, f.212.

11 Po aty, f.212.

12 Muhamed Hamza el Zejni, *Vethikatu el Medine Dirase Tahlilije*, Dar el fikr el Arabij, 2005, f. 176.

Zemra e besimtarit

Miran Mehmeti

Padyshim se zemra e shëndoshë konsiderohet si faktori kryesor, që kontribuon në ndërtimin e një raporti të pashkëputur ndërmjet besimtarit dhe Zotit. Pësia e një zemre të shëndoshë reflektohet në shumë ajete kuranore, e cila përmendet gjithmonë në kontekstin e një mjeti që besimtari i devotshëm e posedon. Shumë ajete kuranore flasin rreth zemrës dhe se si ajo është e lidhur ngushtë me besimtarin e vërtetë, që e ka frikë Zotin e tij. Për më tepër, ajeti i vijues potencon këtë çështje: *“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten.”* (El Enfal, 2).

Ky ajet kuranor dëshmon rolin e zemrës te besimtari, e cila vlerësohet si një peshore matëse e besimit të tij dhe mbështetjes që tregon besimtari ndaj Zotit të Plotfuqishëm. Gjithashtu, ndër karakteristikat e besimtarit të devotshëm është edhe përmendja e shpeshtë e Allahut xh.sh., si dhe veprat e mira që ai i bën në vazhdimësi. Të gjitha këto virtyte që i posedon besimtari janë të lidhura me cilësinë e zemrës së tij. Për këtë çështje Zoti xh.sh. thotë: *“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut! Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ka çdo mirësi dhe vendbanim të mrekullueshëm!”* (Rrad, 28-29).

Nga ky ajet mësojmë se, që njeriu të jetojë një jetë stabile dhe kuptimplote, nevojitet që të ketë së pari besim në Zotin. Një dhe që zemra të jetë e nënshtruar ndaj Tij. Vetëm kështu mund të arrihet paqja e brendshme dhe mirësitë e kësaj bote dhe arritja e shpërblimit në Ahiret.

Rëndësia dhe pozita e zemrës është përmendur edhe nga modeli më i mirë i një zemre të shëndoshë, nga Muhamedi a.s.. Ai në një hadith thekson se: “Një copëz mishi gjendet në

“O Zot, Ti që i ndryshon dhe i rrotullon zemrat! Bëji zemrat tona të qëndrueshme në fenë Tënde!”

(Muhamedi, a.s.)

trupin e njeriut. Nëse është e mirë, i gjithë trupi është i mirë, dhe nëse është e prishur, i gjithë trupi është i prishur. Ajo është zemra.”¹ Ky hadith na njofton se zemra nuk vlerësohet si një organ që vetëm pompon dhe ka funksionin e qarkullimit të gjakut, por funksioni i saj ka edhe karakter shpirtëror, ngase është epiqendra nga e cila buron besimi dhe morali i besimtarit. Në të kundërt, nëse zemra dobësohet dhe prishet, ky rezultat do të prodhojë të njëjtin efekt tek i gjithë trupi. Pra, ashtu siç është zemra, rezulton të bëhet edhe trupi jonë.

Meqë zemra në Islam është burimi i udhëzimit të besimtarit, Pejgamberi Muhamedi a.s. i kushtonte vëmendje të madhe asaj. Nga lutjet e Pejgamberit a.s. ishte: “O Zot, Ti që i ndryshon dhe i rrotullon zemrat! Bëji zemrat tona të qëndrueshme në fenë Tënde!”² Kjo lutje dëshmon për rolin e pazëvendësueshëm

që ka zemra në rrugëtimin tonë drejt devocionit dhe përkushtimit ndaj Krijuesit të gjithësisë.

Në mënyrë që zemra e besimtarit të mbetet e kuruar dhe e shëndetshme, duhet që vazhdimisht të ushqehet me vepra të mira dhe me adhurime. Disa nga veprat e mira që na ka porositur Pejgamberi ynë, Muhamedi a.s., përmenden në hadithin vijues, në të cilën tregohen një njeri i cili kur iu ankua Pejgamberi a.s., për ngurtësinë e zemrës, ai i tha: “Ushqeje një të varfër dhe ledhatoje kokën e një jetimi.”³

Veprat e mira mund ta ringjallin zemrën e sëmurë e cila e kërkon padyshim ilaçin e saj. Prandaj duhet të kemi parasysh se ndjekja e urdhërësive kuranore dhe këshillave profetike është një hap i domosdoshëm për t’u ndërmarrë për trajtimin e zemrës. Në mungesë të kësaj, zemra mund të ngurtësohet, saqë harron porositë hyjnore që i ka zbritur Zoti i Madhërishtëm. Ngurtësimi i zemrës është simptoma famëkeqe që rezulton nga kjo gjendje, e cila mund ta shpie njeriun në humbje dhe devijim. Për këta persona, Zoti në Kuran thotë:

“Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta.” (El Bekare, 74).

Allahu xh.sh., në këtë ajet kuranor e krahason zemrën e ngurtë me gurin, duke e konsideruar pastaj edhe më të fortë se vetë ai. Kjo sepse guri, edhe pse nga natyra është i ngurtë, mund të çahet. Por, zemra ka potencialin të bëhet aq e ngurtë, saqë asgjë nuk mund ta zbus më. Ky krahasim na bën të mendojmë se si disa zemra njerëzore bëhen aq të ngurta dhe të pandjeshme, saqë bëhen më të ashpra sesa guri, duke mos lejuar që të depërtojnë as mëshira dhe as udhëzimi i Allahut.

Në një hadith tjetër, Aisheja r.a., tregon se një beduin shkoi te Pejgamberi a.s dhe i tha: “Ju i puthni fëmijët, ndërsa ne nuk i puthim ata!” Pejgamberi a.s i tha: “Çfarë të bëjë unë, kur Allahu ta ka hequr mëshirën nga zemra?!⁴

Këto dhe shumë argumente të tjera sheriatike tregojnë se si burim i besimit dhe i virtyteve me të cilat mund të pajiset myslimani janë si rezultat i zemrës së tij. Dijetarët islam e kanë kuptuar prej kohësh rëndësinë e zemrës. Për këtë janë angazhuar për të kuptuar në hollësi zemrën e mirë. Dijetari i mirënjohur Ibën Kajim el Xheuzije, kur flet për çështjen e zemrës, thotë: “Zemra e pastër është ajo zemër e cila është e pa cenuar nga shirku, smira, urrejtja, koprracia, mendjemadhësia, dashuria pas dynjasë dhe postit. Ajo është e pa cënueshme nga çdo gjë që të largon nga Allahu, nga çdo dyshim që kundërshton lajmin e Tij, nga çdo epsh që kundërshton urdhrin e tij, nga çdo dëshirë që bie ndesh me dëshirën e Tij, si dhe nga çdo ndarje që e ndan atë prej Allahut.”⁵

Në anën tjetër, ekzistojnë shumë kanale që mund ta dëmtojnë zemrën e besimtarit. Një nga tabiinët më të njohur Hasan el Basriu, identifikoi gjashtë gjëra që e prishin zemrën: 1) bëjnë mëkate duke shpresuar se do të pendohen; 2) mësojnë, por nuk punojnë sipas dijes; 3) e nëse punojnë sipas saj (dijes), nuk janë të singertë; 4) hanë nga furnizimi i Allahut, por nuk e falënderojnë; 5) nuk ndahen të kënaqur me ndarjen-aktimin e Allahut, si dhe 6) varrosin të vdekurit e tyre por nuk marrin mësim.⁶

Duhet të kemi parasysh se nëse dëshirojmë ta përmirësojmë veten tonë, duhet nisur gjithmonë nga përmirësimi i zemrës, ngase pikërisht nga ajo burojnë cilësitë e lavdëruara që e ngritin pozitën e besimtarit tek Allahu Fuqiplotë. Një shembull se si shprehet devotshmëria e besimtarit në adhurimet e tij e gjejmë te rasti kur njëri nga sahabët më të devotshëm të Pejgamberit Muhamedit a.s Omer bin el Hattabi pa një burrë duke ulur qafën në namaz, kështu që ai i tha: “O pronar i qafës, ngrije qafën, përulësia nuk është në qafë, por përulësia është në zemra. Kush i frikësohet Zotit, Ai do ta mbrojë atë, kush i mbështetet Atij, Ai do t'i mjaftojë atij, kush e falënderon Atë, Ai ia shton furnizimin, e kush i jep hua, do ta shpërblejë. Pra, bëjeni devotshmërinë bazën e



zemrës suaj dhe qartësinë e vizionit tuaj, sepse nuk ka punë për atë që nuk ka qëllim, nuk ka të mirë për atë që nuk ka frikë dhe asgjë e re për atë që nuk ka karakter.”⁷

Pra nga ky rast e kuptojmë se edhe shokët e Pejgamberit a.s., gjenerata më e mirë që ka ekzistuar në mbarë njerëzimin, e trajtonin zemrën si thelbin e devotshmërisë dhe burim të veprave të mira.

Rregullimi i zemrës dhe përmirësimi i vazhdueshëm i saj është një obligim parësor, ngase përmes saj ne e ndërtojmë identitetin tonë si besimtarë të përkushtuar ndaj urdhrave të të Madhit Zot. Mirësitë dhe begatitë që burojnë nga kjo zemër janë të pafundme, ngase kjo na garanton sukses në këtë botë dhe në jetën e përtejme. Megjithatë njerëzit mund të pajisen me shëndet, dituri, pasuri dhe me pasardhës, të gjitha këto të mira nuk do të mbesin përgjithmonë. Por, ajo që mbetet si një garancë e vetme për të fituar kënaqësinë dhe rehatinë e përjetshme është zemra, e cila iu është nënshtuar Allahut xh.sh.. Prandaj duke i pasur parasysh të gjitha këto gjëra që u thanë, Zoti na porositi në Kuran: “Dhe mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit, në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Esh Shuara, 87-89).

- 1 Transmeton Muslimi në Sahihun e tij.
- 2 Transmeton Ummu Seleme në Sahihun e Muslimit, nr.2654.
- 3 Transmeton Ebu Hurejra në veprën e Ibën Maxhes, me nr. 4217.
- 4 Sahihu i Buhariut, Aisheja e transmeton hadithin nga Pejgamberi a.s., hadithi nr. 5998, fq. 608.
- 5 Imam Ibën Kajimi në librin e tij “Ed-da ue ed Deua”, fq. 282.
- 6 <https://sedatislami.wordpress.com/hasan-basriu/>
- 7 https://mawdoo3.com/%D8%A3%D9%82%D9%88%D8%A7%D9%84_%D8%B9%D9%85%D8%B1%D8%A8%D9%86_%D8%A7%D9%84%D8%AE%D8%B7%D8%A7%D8%A8

Intervistë më prof. Muhamet Mustafën

Nga tradita familjare, te sfida e ekonomisë moderne

NJË RRUGËTIM FRYMËZUES I PROFESORIT MUHAMET MUSTAFA

I nderuari profesor, së pari shprehim kënaqësinë tonë dhe ndihemi të nderuar që t'ju kemi në një intervistë ekskluzive për revistën "Dituria Islame"!

Ju keni lindur në një fshat nga rrethi i Prishtinës, fshati Rimanishtë dhe vini nga një familje me traditë fetare dhe kombëtare, a mund të na flisni pak për prejardhjen tuaj?

Është kënaqësia ime! Rimanishta është një fshat 15 kilometra larg kryeqytetit. Unë vij nga familja Mustafa, emër nga stërgjyshi im Mustafa. Ai i la trashëgimi të begatë për pasardhësit. Qe punëtor i madh, më shumë miq të njohur dhe fetar i devotshëm. Njërin nga shtatë djemtë e tij – Rexhepin (gjyshin tim) e shkolloi për hoxhë dhe ai shërbeu si imam në Prishtinë, dhe pastaj edhe si imam kryesor për xhamitë në fshatrat e Gollakut, në Halabak, në Koliq e në vende të tjera. Në vitin 1926, para thujse 100-vjetësh, ai si 52-vjeçar, vendosi ta bëjë rrugën e haxhit. Gjatë asaj rruge të bekueme, qe e caktuar që në Mine të ndërroi jetë. Babai im Sylejmani ishte atëherë vetëm 5-vjeçar. Gjyshja ime Zahidja (nga familja Hasani-Bajraktari, Batllavë) dhe axha Haliti, Zoti i shpërbleftë, u kujdesen që ta shkollojnë për hoxhë. Pas disa përgatitjeve paraprake me mësim të disa hoxhallarë, e regjistruan në Medresenë "Pirinaz" të Prishtinës. Ai vijoi këtë institucion me mësimet e studimet e tij gjatë viteve 1931 – 1941, nën përkujdesjen e myderrizit mulla Ahmet Mardoçit për rreth 10 vjet. Nëna ime Rabija, që vinte nga familja Azemi, nga Pollata e Podujevës, ishte një bashkëudhëtare e denjë e babait jo vetëm në punët e shtëpisë, por edhe për edukimin tonë (dy motrave të mia dhe vëllait Rexhepit) me shembullin personal.

Cilat ishin sfidat më të vështira gjatë rrugëtimit tuaj shkollor dhe akademik?

Sigurisht që ka qenë sistemi shkollor dhe edukativ i bazuar në ideologjinë marksiste e leniniste, me qëndrim rigjid ndaj fesë, por edhe kufizimet materiale, sidmos në fillim, në vitet 1950 e 1960, në fazën kur Kosova ishte shumë e pazhvilluar dhe vuante nën një regjim tepër të ashpër policor. Ndonëse në ato kushte, mund të them se ndoshta më shumë

se 90%, e nxënësve agjëronin. Pos në raste të rralla, kjo disi tolerohej në heshtje nga drejtoritë e shkollave dhe personeli arsimor. Një herë vendosëm, sa ishim në shkollën fillore të Besisë, që e gjithë klasa e VII ta bojkotojmë mësimin për ditën e Bajramit. Kujdestari i klasës Rushid Osmani na bëri vetëm një qortim simbolik. Nuk kemi pasur rast që të na detyrojnë ta prishim agjërimin. Gjatë shkollimit dhe punëve publike që kam pasur, nuk kam frekuentuar xhamitë, deri më 1990 kur ra ai sistem. Babai u gëzua shumë kur më vërejti në xhami atëherë. Siç thashë ishin këtu edhe kufizimet e natyrës materiale. Sidomos për ne që ishim me origjinë nga fshati. Ishte një ekonomi familjare disi e vetëqëndrueshme me produkte nga bujqësia, blegtoria, pemët e primet, por paraja e gatshme dhe fitimi i saj deri në vitet e vona 70' ka qenë një problem serioz. Prandaj të shkolloheshe në qytet ka qenë një sakrificë jo e vogël familjare dhe personale. Më vonë, në studimet në Fakultetin e Ekonomisë, në studimet pas-diplomike për master në Zagreb dhe studimet e doktoratës në Beograd, ishte një atmosferë më liberale në kuptim të shtrëngësave të regjimit. Megjithatë, gjithnjë mbetshin prezente sfidat politike. Në Zagreb kishim një mbështetje të madhe në vitet 70' të shekullit të kaluar. Para mbrojtjes së tezës së doktoratës, në Universitetin e Beogradit, në vitin 1985, njëri nga antarët e komisionit, bëri vërejtje dhe kërkesa me motive politike që teza të korrigjohej. Pas refuzimit tim, puna u zvarrit diku 6-7 muaj,

"Ndonëse në ato kushte, mund të them se ndoshta më shumë se 90%, e nxënësve agjëronin. Pos në raste të rralla, kjo disi tolerohej në heshtje nga drejtoritë e shkollave dhe personeli arsimor."





por në fund mentori dhe dekani i fakultetit refuzuan kërkesat e tija.

Meqë jeni djalë i një hoxhe me mjaft shumë autoritet për një kohë, gjatë fundshekullit të kaluar në Kosovë (jeni djali i mulla Sylejman Mustafës - Sylë Rimanishta), cilat ishin porositë e paharruara nga babai që kanë lënë gjurmë të fuqishme në formimin tuaj si personalitet?

Është e vështirë që të veçohet diçka, ngase gjithçka që ai bënte, puna rreth obligimeve si imam, aktivist dhe udhëheqës shumëvjeçar në Vakëfin e Prishtinës dhe në Kryesinë e BIK-ut, si dhe udhëheqja e familjes së ngushtë e të gjerë, kanë qenë me shumë porosi dhe mësim, që gjithsesi nxirren nga shembulli i tij personal. Në përgjithësi shembujt vijnë nga dashuria e tij për dijen e drejtësinë. Ai lexonte shumë, asnjëherë jo më pak se 5-6 orë në ditë, merrte shënime gjatë leximit, përgatitej shumë seriozisht për ligjërimet e hytbetë. Duke e analizuar bibliotekën e tij, studiuesi Mahmud Arnaudi, hasi në këto shënime nga të cilat ai sajoi një , e cila edhe u botua si libër nën përkujdesjen tij, “Kandili i rrugës” 2009. Zoti e shpërbleftë studiuesin e zellshëm Mahmud Arnaudi për këtë punë fisnike! Babai kishte një disiplinë thuajse tepër strikte sa i përket leximit të Kuranit dhe librave të tjerë, si dhe për kryerjen e obligimeve si imam. Sa udhëhiqte KBI-në e Prishtinës më ka mbetur në kujtesë përkushtimi për konsolidimin financiar dhe përmirësimin e pozitës materiale të imamëve në Prishtinë. Veç kësaj, ai kujdesej për mirëmbajtjen e lidhjeve dhe marrëdhënieve familjare dhe në përgjithësi për zgjidhjen e konflikteve lidhur me marrëdhëniet ndërnjerzore e pronësore në xhematë. Për këto ishte shumë i spikatur. Kishte shoqëri dhe rreth të gjerë që i priste në odë dhe shpesh kishte dëshirë që vetë t’u përgatiste kafetë. Ligjërimi tij i qartë dhe i strukturuar mirë dhe i kuptueshëm, është një shembull që ka ndikuar gjithashtu edhe tek unë besoj.

Cilën e konsideron trashëgiminë më të çmuar nga babai juaj për juve, dhe për institucionin e Bashkësisë Islame në përgjithësi?

Dedikimi ndaj detyrave të punës. Veç punës si imam, e cila kërkon përkushtim të madh, ai kryente edhe detyrën si kryetar i Vakëfit, përkatësisht KBI-së së Prishtinës. Vënia në shërbim të ngritjes së nivelit të punës e të gjitha resursve – pasurisë së vakëfit dhe burimeve njerëzore. Përkushtimi i vazhdueshëm për mësim-besim dhe edukim të gjeneratave të reja. Nuk më kujtohet të ketë pauzuar shumë nga organizimi i mësim-besimit në xhami. Maturia, por edhe vendosmëria për realizmin e të drejtave dhe shfrytëzimi i të gjitha mundësive për arritje të reja. Dashuria dhe respekti për fenë islame, përkundër kritikave dhe sulmeve që bëheshin në atë kohë për organizimin e mësim-besimit. Kishte një përkushtim për mbrojtjen e traditave të pastra të fesë sonë. Ndoshta edhe pse babai i tij kishte ndërruar jetë në Meke, por sigurisht edhe nga dashuria ndaj vendeve të shenjtat, ndaj Krijuesit dhe Pejgamberit, kanë bërë që rreth 15 herë ta ketë marrë rrugën e haxhit. Më kujtohen rrëfimet e gjalla, shumë të pasura me përmbajtje dhe ndjenja për përshtypjet nga secili udhëtim atje, e sidomos nga njerëzit dhe ulematë e njohur nga e gjithë bota që i takonte atje. Ai kishte një raport respekti dhe dashurie të singertë për kolegët e shokët e tij ulema – Hasan efendi Nahin, mulla Sherif Ahmetin, mulla Sadri Prestreshin, mulla Adem Tërnavën, dr. Rexhep Bojën, hfz. Ismail Haki, h. Jetish Bajramin, mulla Bahtir Majacin, mulla Ramë Kurtollin, dajën Mulla Bahtirin, mulla Rashid Osmanin, me haxhi Jashar Jasharin, bashkëpunëtorin e tij në KBI të Prishtinës, haxhi Mehmet Gashin, Mustafa Der-vishollin, dhe gjithashtu ulematë më të ri në BIK, të prirë nga Naim ef. Tërnavë dhe shumë kolegë të gjeneratës më të re që në atë kohë filluan të afrimohen dhe të merrnin përgjegjësi për zhvillimet në BIK dhe më gjerë. Myftiu i tanishëm, Naim ef. Tërnavë, atëherë drejtor i Medresesë “Alauddin”, mbajti një fjalë shumë dinjitoze dhe frymëzuese para një xhemati prej disa mijëra vetash, me rastin varrimit të tij më 28 shkurt 1998. Natyrisht unë kam shumë momente kujtimesh e përjetimesh nga babai që mbesin të paharrueshme. Ato i kam përshkruar më detalisht në librin tim me rrëfime mbi ngjarjet në retrospektivë “Kapërcimi i vetmisë” (UET Press, Tiranë, 2016). Respekti dhe komunikimi i tij me kolegët e xhematin ka qenë shembull që jam munduar ta ndjek edhe unë në punën time. Jemi të lumtur që gjithë kjo trashëgimi e pasur e traditës familjare po vazhdonet nga nipi im Arbi, që tani po vazhdon studimet në Universitetin “Al Azhar”. Allahu i ndihmoftë dhe ia ndriçoftë rrugën që ka nisur!

Meqë nga formimi juaj edukativo-arsimor jeni ekonomist dhe keni një opus të bujshëm të veprimtarisë suaj në këtë fushë, a mund të na thoni se cilat janë principet e shëndosha të

zhvillimit ekonomik të një vendi, natyrisht në mënyrë specifike për ne këtu në Kosovë?

Ne tash po jetojmë në kohën e revolucionit IV industrial, të njohur me emrin Industria 4.0, që bazohet në digjitalizim të aktiviteteve, operacioneve dhe transaksioneve biznesore, duke e rritë produktivitetin, racionalizuar kostot dhe duke ndikuar në mënyrë vendimtare në aftësinë konkurruese të bizneseve dhe rrjedhimisht edhe të ekonomive kombëtare. Për të ndërtuar një ekonomi dhe shoqëri prosperuese, patjetër që duhet të ndiqen këto procese. Duhet pasur parasysh se si faktorë dominantë zhvillimi në kushtet bashkëkohore merren: sistemi i qeverisjes, informacionet dhe dituria. Kur flasim për sistemin e qeverisjes kemi të bëjmë me shtetin e përgjegjshëm që siguron liritë individuale dhe ligjore dhe barazinë e qytetarëve para ligjit. Si dhe për shfrytëzim të resurseve, ligjet e drejta dhe zbatimin e tyre korrekt, evitim të çdo diskriminimi (mbi baza racore, kombëtare, fetare, gjinore), sistemin gjyqësor të pavarur dhe të drejtë. Krahas këtyre, për t'u siguruar një kohezion i domosdoshëm social është e domosdoshme të gjendet një drejtpeshim, raport i drejtë, midis interesave individuale dhe kolektive dhe mbi këtë bazë të realizohet barazia në qasje në edukim, shëndetësi, punësim e përdorim të resurseve. Kësaj i shtohet dhe një politikë e rishpërndarjes, që siguron drejtësi sociale. Për shkak të rrethanave të vështira historike, por edhe për shkak të dobësive në qeverisjen ekonomike deformimeve të ndryshme në zbatimin e ligjit, korrupsionit e të ngjashme, Kosova është ballafaquar me një prapa ngelje në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe social. Ajo tani është diku në nivelin rreth 65% të mesatares së zhvillimit të vendeve fqinje (6 vendet e Ballkanit Perëndimorë), matur me paritetin e fuqisë blerëse (matur me produktet e shërbimet që mund t'i blejmë ne me një sasi parash këtu në Kosovë dhe ato që me të njëjtën sasi mund t'i blejmë në BE) jemi diku rreth 1/3 e nivelit mesatar të BE27.

Nga leximet tua që sigurisht i keni edhe për bazat e ekonomisë islame, a mendoni se të tillat janë relevante për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së një vendi edhe në kohën bashkëkohore?

Fatkeqsisht nuk mund ta quaj veten sa duhet të informuar lidhur me zhvillimit aktualë rreth ekonomisë islame. Parimet ekonomike islame që burojnë nga Kurani i madhërishëm dhe mësimet nga Suneti i Pejgamberit, në esencë krijojnë parakushtet që të arrihet një optimum i balancimit midis

interesave kolektive dhe individuale, të nxitë aktiviteti ekonomik dhe efikasitetin në kushtet e ligjeve të drejta, paqes sociale dhe drejtësisë sociale. Zaten në bazë të këtyre ligjeve, shoqëritë islame kanë qenë kampione të zhvillimit social ekonomik, teknologjik e shkencor shekuj me radhë. Përse sot nuk është kështu, shpjegimi është i ngjashëm si edhe për të gjitha shoqëritë që ngelin prapa. Shkaku kryesor është cilësia e qeverisjes, e institucioneve qeverisëse, kapacitetit i tyre dhe politikave që zbatojnë ato. Ne jemi dëshmitarë se shumica e vendeve myslimane sot ballafaqohen me prapa ngelje në zhvillim ekonomik, human dhe social të shoqëruara edhe me deformime në zbatim të ligjit e drejtësisë dhe shkelje të interesave individuale dhe interesave kolektive e shoqërore.

Megjithatë në këto dy tri dekadat e fundit, kemi një rritje të interesit shkencor dhe praktik biznesor për parimet e ekonomisë islame, e sidomos financave islame. Rritja e sivejtmë e transaksioneve financiare islame është ndër më dinamiket, 10-15%, duke arritur vlerën e US\$6.67 trilionë në vitin 2027. (Islamic Finance Development Report 2023). Veç kësaj, kemi edhe një lloj globalizmi të financave islame dhe aplikim i tyre jo vetëm në vendet me dominim të popullsisë myslimane, por edhe në vendet e tjera si për shembull në Britani të Madhe.

“Duhet pasur parasysh se si faktorë dominantë zhvillimi në kushtet bashkëkohore merren: sistemi i qeverisjes, informacionet dhe dituria.”

Viti 2008-ta ishte viti i krizës së vërtetë financiare në nivel global, e cila e futi ekonominë e shumë shteteve në një recension tejet kompleks, asokohe kishte disa ekonomistë të shquar perëndimorë që patën deklaruar se brenda kornizave të përgjithshme të platformës ekonomike islame mund të gjendet shtegdalja për krizën e asaj kohe? Çfarë mendoni, për çfarë flisnin ata njohës të asaj fushe?

Po është e vërtetë se në kohën e krizës së 2008, dhe më pastaj në vazhdim u rrit interesimi për produktet financiare islame, të cilat vejnë në spikamë një lidhshmëri midis përfitimeve dhe bartjes së rrezikut të gërshtuar me parimet etike. Skandalet që ndodhen në disa banka të njohura zbuluan dobësi në qeverisjen korporative si mungesë e parimeve etike dhe transparencës. Ideja ishte se sistemi duhet të mbrohet nga një situatë kur lihen pas dore parimet e transparencës, ato etike dhe të drejtësisë, dhe kur të motivuar nga përfitimi i bonuseve dhe përfitimeve të tjera rrisht fshihet dhe bartet tek aktorët e tjerë në zinxhirin e qeverisjes. Sipas studimeve krahasimore, shihet se bankat e bazuara në parimet islamike patën goditje shume të vogla nga kriza

financiare e vitit 2008 në krahasim me ato konvencionale dhe gjithashtu arritën profite më të mira.

Bankimi islam është një produkt atraktiv që në shumë vende islame, por edhe këto perëndimore po gjen shtrirje dhe interesim, a mund të na thoni se cila është e veçanta e këtij produkti financiar?

Në shumë trajtime, duke përfshirë edhe publikimet e Bankës Botërore si për shembull “Economic Development and Islamic Finance” (2013) një përmbledhje kontributesh të autorëve më në zë të kësaj fushe përgjigja është pozitive. Mësimet nga ekonomia dhe financat islame kane relevancë për një zhvillim modern dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Kjo aq më parë kur këto inkadrojnë në procesin e aktiviteteve ekonomike, komerciale e financiare edhe parime në formën e vlerave morale dhe spirituale brenda një bilanci midis efikasitetit ekonomik dhe mirëqenies njerëzore. Pra kjo nënkupton që individët të shfrytëzojnë potencialin e tyre që ua ka dhënë Krijuesi i Gjithëfuqishëm duke përdorur burimet natyrore të siguruar nga po ky Krijues, për të përmbushur nevojat individuale dhe ato kolektive e shoqërore. Për këtë sigurohet një frymë e bashkërenditjes dhe konsultimit në vendimmarrje, si dhe respektimi i kontratave mbi transaksionet biznese dhe financiare dhe mbi të gjitha transparencën. E gjithë kjo ndikon në forcimin e besimit reciprok të partnerëve dhe drejtësisë në shpërndarje. Synimi dhe parimi bazë është një drejtësi në përdorimin e burimeve dhe ndarjen e shpërndarjen e përfitimeve për të maksimizuar mirëqenien sociale.

A ka hapësirë ligjore brenda kornizës juridike të Republikës së Kosovës për ndonjë produkt të bankimit islam siç janë: Murabaha (kontratë e definuar si ndarje e humbjes dhe e fitimit, PLS ‘Profit and Loss Sharing’), Mudaraba (Partneritet pasiv) ose Musharaka (Partneritet aktiv)...?

Mendoj se parimisht nuk do të duhej të kishte pengesa. Fakti se deri tani në Kosovë nuk është licencuar asnjë bankë e tillë duket se është neglizhenca që BQK-ja të zhvillojë aktet nënligjore rregullative lidhur me procedurat e procesit të aplikimit dhe licencimit. Si duket këto akte ende nuk janë zhvilluar as pas shumë viteve nga aprovimi i Ligjit sistemor organik për bankat në Kosovë dhe për këtë nuk ka asnjë arsye. Është tejet normale që në kontekstin e Kosovës të funksionojnë bankat islamike, ato vetëm do t’i pasuronin instrumentet financiare dhe jam i bindur se do të ndikonin pozitivisht në rritjen e mundësive për zgjidhje nga bizneset dhe konsumatorët, si dhe do të përmirësonin konkurrencën në sistemin bankar, i cili ka nevojë që të avancohet. Përndryshe produktet e financimit islam që i përmendet, munden të zbatohen në bashkëpunimin e bizneseve në baze të kontratës midis tyre. Aq më shumë tani po afirmohet gjithnjë e më shumë dhe produkti i quajtur “Sukuk”, që ka bërë me bonat e thesarit që i emiton shteti, letra me vlerë, e

që kompanitë dhe individët mund t’i blejnë dhe marrin përfitimin në harmoni me normën e rritjes ekonomike të vendit përkatës. Vlera e këtyre bonove të emituar deri në kuartalin e parë të vitit 2024, ka arritur US\$ 65.4 miliardë. Kjo do të mund të ishte një alternative më e mirë për shumë shtete që të financojnë projektet e tyre zhvillimore në vend që të ngarkohen me borxhe nga kreditë e jashtme bankare.

Kamata dhe normat e larta të interesit si një burim i përfitimit të ekzagjeruar në sistemin bankar kapitalist, a mund të kenë alternativë tjetër dhe a mbijetojnë dot bankat pa aplikimin e normës së interesit në produktet e veta?

Interesi apo kamata në kushtet e sotme i nënshtrohet parimeve të tregut në aspektin e kërkesës për kredi dhe ofertës nga bankat, si dhe politikave rregullative të politikës monetare të shteteve që udhëhiqen nga bankat qendrore të secilit vend. Pjesa dërmuese e shteteve në këtë mënyrë evitojnë pozicionin monopolist dhe spekulativ në formimin e lartësisë së normës së interesit. Megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk ka probleme të natyrës së kartelave kur bankat i ikin konkurrencës midis tyre për të siguruar një lartësi të caktuar të interesit dhe kamatës. Kjo është forma dominante e sotme e funksionimit të tyre. Alternativa ka dhe po shihet se njëra nga këto që po gjen afirmim është edhe financimi islam.

A mendoni se është hulumtuar e avancuar mjaftueshëm ajka e teksteve hyjnore islame, për të parë brenda tyre kornizat gjenerale të një ekonomie të qëndrueshme në kohën moderne?

Jo, sigurisht! Financimi islam mundet dhe duhet të përsoset dhe krijohet një infrastrukturë rregullative ligjore që e mbështet atë. Por sa do të jetë efektiv varet siç e kam theksuar edhe më lartë nga cilësia e institucioneve dhe politikave, përkushtimi i tyre që të zbatojnë ligjet dhe drejtësinë e barazinë.

Cila do të ishte porositë juaj për studiuesit e ekonomisë dhe hulumtuesit e disiplinave islame në kontekstin tonë gjeografik dhe fetar-kombëtar?

Mendoj se është e nevojshme që në kuadër të edukimit islamik, por edhe sekular e laik të futën përmbajtje të parimeve të ekonomisë islame dhe financave islamike. Kjo sot është e pranishme gjithandej nëpër botë, duke përfshi edhe sistemin edukativ në vendet perëndimore dhe nuk ka asnjë arsye që programet mësimore e kurrikulat universitare mos t’i përfshijnë këto përmbajtje. Kjo vlen edhe për aktivitetet kërkimore e shkencore, si dhe për ngritjen e vetëdijes se bizneseve për mundësitë që ofrojnë produktet dhe shërbimet e ekonomisë dhe financave islame.

Intervistoi: Mr. Driton Arifi

Tendenca mediokre për kthim në fenë e të parëve

Granit Sadiku

Është e vërtetë se bukuria i deh njerëzit herë pas here, sidomos ajo e fjalës së shkruar dhe asaj të thënë. Për disa mund të mos jetë më me rëndësi e vërteta mbrapa fjalës, por vetë forma e thënies së saj. Ndërsa ka edhe të tjerë, qëllimkëqij, të cilët nuk pranojnë gjëra të tjera pos kovencave të caktuara që kanë intenca të sipërtheksuara përçarëse. Në kohën tonë, ashtu si edhe disa herë në kohë më të përparshme, janë shfaqur një grup shoqëror, të cilët pretendojnë se e kanë gjetur mënyrën se si të bëhet një shqiptar autokton – i vërtetë. Sipas tyre, kushti i parë që duhet ta plotësojë i tilli është që të mos jetë mysliman, ngase kjo fe na paska ardhur nga armiku ynë shekullor dhe tani rruga jonë drejt integritetit evropian na vështirësohet teksa i përkasim asaj. Dikur qëllimi i tyre dukej gati kombëtar, pastaj doli të ishte anti-islamist, ndërsa tani vonë e zbuluam se paska qenë thjesht dorë e zgjatur e Serbisë, me misionin kryesor të një pushtuesi: “*ndaj, përçaj, pushto*”.

Ndoshta dikush që mund t'i lexojë këta rreshta, ngrit dyshimin e tij se si mundet që një organizatë aq e thirrur në patriotizëm e shqiptarizëm të jetë dorë e zgjatur serbe. Epo, historia na ka mësuar se shpesh për “*interesa edhe djalli e citon Biblën*”. E këta njerëz nuk mund të jenë asses të preokupuar që të jenë patriotë apo atdhedashës. E vetmja dëshirë dhe fiksim i tyre është që të jenë antiislamistë.

FEJA E SHQIPTARIT ËSHTË...

Në vitin 1881, kur gëlonte në fushën e letërsisë fryma rilindëse e shkrimit, Pashko

Në kohën tonë, ashtu si edhe disa herë në kohë më të përparshme, janë shfaqur një grup shoqëror, të cilët pretendojnë se e kanë gjetur mënyrën se si të bëhet një shqiptar autokton – i vërtetë.

Vasa do ta botonte poemën e njohur “*O moj Shqypni*”. Ideja e rilindësve, në përgjithësi, ishte krijimi i Shqipërisë dhe i shqiptarit. Dhe për këtë përpjekje punonin vazhdimisht, me një frymë të pashtershme të idealit kombëtar. Pashko Vasa ishte njëri ndër këta ideologë. Me punën dhe angazhimin e tij më pak brenda shtetit, e më shumë nëpër udhëtimet e tij në Turqi, Itali, Bosnje etj., u mundua të shkruante për çështjen shqiptare dhe ta mbronte atë. Madje, sipas disa burimeve, ai kishte marrë pjesë edhe në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Por, ajo që i tejkalon përmasat e uniflkimit dhe bashkëjetesës mes shqiptarëve, është pikërisht fraza e përdorur në këtë nëntitull nga vargjet në vijim:

Çoniu, shqyptarë, prej gjumit çoniu,

Të gjithë si vllazën n'nji besë shtërngoniu,

E mos shikoni kisha e xhamia:

Feja e shqyptarit asht shqypitaria!

Patriotizmi dhe nacionalizmi janë dy nocione që në raste jo të pakta dalin përballë njëra-tjetrës. Nacionalizmi i përzier me religion nuk është i panjohur në historinë e botës. Qysh nga Perandoria Bizantine, bota njohu idenë e përzierjes së idesë nacionale me atë kombëtare. Madje edhe më vonë, kur modeli bizantin u përvetësua nga serbët me modelin e tyre shpirtëror që e quanin “*Sveti Sava – Shën Sava*”. Më vonë u krijua një term i veçantë që specifikonte këtë formë manifestimi të nacionalizmit dhe religjionit, që u quajt “*Shën-savizmi*”. Shën-savizmi (sveto-savlje) presupozonte shkrirjen e idesë së



religjionit, kombit dhe shtetit që ishte ideuar nga po ky njeri.

Historiani i kulturës, Branimir Anzulović, ndër të tjera thekson ndikimin e veçantë të Kishës Serbe në nacionalizmin e saj. Ai thoshte: “Shën-savizmi e sheh kombin si të shenjtë për shkak të identifikimit të tij me të vetmin besim të vërtetë. Kjo bindje pasqyrohet në referencën që peshkopi Velimirović bën për kombin në terma që zakonisht janë të rezervuar për Perëndinë: “Ndonëse serbët numerikisht s’janë një komb i madh, jeta dhe historia e tyre janë një punë filigrani e harmonisë dhe e bukurisë së papërshkrueshme.”²

Ekzistonte rreziku permanent që këto vargje të kuptoheshin në mesazhin e tyre të parë (dhe real). Nga disa njerëz u kuptua që, thjesht, ideja e Vasës ishte bashkimi i shqiptarëve pa dallim feje. Ndërsa ekzistonte pikëpamja tjetër, e cila prapëseprapë s’mund t’i ikte frazës “*mos shihni kisha e xhamia*” (Digresion: ndoshta fryt i këtij mendimi ka qenë regjimi komunist, i cili vite më vonë bëri që njerëzit vërtet të mos guxonin të shihnin kisha e as xhami). Pashko Vasës ashtu siç nuk mund t’ia mohojmë idenë e kombëtarizimit, nuk mund t’ia mohojmë edhe idenë aversive ndaj religjioneve dhe predikuesve të tyre. Kjo arsyetohet me vetë vargjet e tij, ku thotë: “*Priftnit e hoxhët ju kanë hutue, Për me ju damun me ju vorfnue!*”. Por, a nuk e dinte Pashko Vasa se Shqipëria në atë kohë kishte

Lëvizja e Deçanit, lëvizja për braktisjen e fesë islame dhe rikthimin në fenë e të parëve – çuditërisht, jo në paganizëm, por në krishterizëm – i kanë si pretekst të gjithkohshëm vargjet nga Pashko Vasa.

edhe priftërinj e hoxhallarë, të cilët i dhanë shumë çështjes kombëtare?! Kjo ide, përkundër qëllimit të autorit, ishte në thelb përçarëse dhe indinjuese. Pashko Vasa në emër të kombit krijoi dallimin e madh se “tjetër gjë është të jesh shqiptar, e tjetër gjë është të jesh mysliman apo krishterë”. Nuk duhet të kryqëzohet tani ai për vargjet e tij, të cilat mund të kenë qenë shkas i një dëshpërimi e zemërimi – apo edhe besimi. Mirëpo, realiteti është që ai ishte indikator i parë i kësaj përçarjeje të mendësisë unifikuese.

Lëvizja e Deçanit, lëvizja për braktisjen e fesë islame dhe rikthimin në fenë e të parëve – çuditërisht jo në paganizëm por në krishterizëm – i kanë si pretekst të gjithkohshëm këto vargje nga Pashko Vasa. Mirë, le t’i kenë! Vetëm se duhet të kihet parasysh fakti që një nacionalizëm i tillë është ekstrem, e fundi i ekstremizmit dihet që gjithmonë është humnera.

Nëse na kanë “hutuar” hoxhallarët – ngase zakonisht nuk i citojnë pasardhësit e Vasës tërësisht vargjet e tij deri në fund – atëherë mos mbeteshim kurrë pa hoxhallarë si Ymer Prizreni, i asaj kohe kur po shkruheshin këto vargje, dhe priftërinj si Gjergj Fishta, i cili ishte figurë me plot kuptimin e fjalës unifikuese kombëtare.

TENDENCË MEDIOKRE NË RRIJTJE

Nuk të dhëmb gjithaq fakti se në popullin tonë ka njerëz mbi mesataren budallenj që

shprehin mendimet e tyre, ngase sistemi demokratik përveç të tjerash e lejon këtë. Por është i dhimbshëm fakti se si e tërë hapësira televizive sot u jepet atyre që, përveç që nuk kanë kurrfarë vlere edukative e arsimore, janë promovuesit e duhur të mediokritetit dhe ideve të tjera injorante. Sot hapësira televizive është kthyer në një ambient, bar, bulevard, kafene, e pse jo edhe klub nate – pa hequr censurat e moshave të ndjeshme, ku çdokush, ama çdokush që ka një histori (sado e kotë që të jetë ajo) mund ta nxjerr në publik atë.

Pikërisht fuqia mediale ka arritur që “namin” e kësaj lëvizjeje ta përhapë anekënd. Dhe njerëzit që ftohen zakonisht në emisione, janë ata që me karizmin e tyre shkaktojnë më shumë dramë apo të qeshura në audiencë. Pra, këto emisione para së gjithash synim e kanë karizmin. Ajo që duhet të na trishtojë ne, si myslimanë shqiptarë, është fakti se botë-kuptimi islam i njerëzve që kanë kontakt të vazhdueshëm me këto medie, fatkeqësisht po zbehet. E kësaj, edhe kur njohuritë burimore u ofrohen përpara tyre, e kanë të vështirë të zgjedhin se cila është e mira, e cila e keqja. Duke folur për këtë aspekt, meriton të ceket një mendim i shkruar në fletoren personale të një sulltani, e cila u zbulua vetëm pas vdekjes së tij. Është fjala për sulltan Abdylhamitin e dytë, i cili kur flet për rëndësinë e Islamit në botë në atë kohë, thotë: “Perandoria jonë është një vend fetar dhe ashtu do të mbetet. Nëse botëkuptimi fetar prishet, kjo do të thotë se perandorisë sonë i ka ardhur fundi. Për ne është e trishtueshme që vendet me popullsi myslimane janë në dorën e Fuqive të Mëdha.”³

Frika e Abdylhamitit ishte e qëlluar, ngase njerëzit e braktisën fenë dhe rruga e tyre kryesore që i bënte të bashkuar u ndërpre. Ai i shihte si faktorë fuqitë e mëdha të asaj kohe, ndërsa sot armiqetë më të dëmshëm të fesë islame janë mediokrët, të cilët duke i dhënë hapësirë mediatike tendencave armiqësore përçarëse, po shkaktojnë armiqësi në mesin e një shoqërie shqiptare.

“SHIH KALLABALLËKUN E JO PAZARLLËKUN!”

Kur filluan që një numër as treshifror, të konvertoheshin në krishterizëm – ndonëse s’kishin pasur të bënin kurrë me Islam – na u

“Perandoria jonë është një vend fetar dhe ashtu do të mbetet. Nëse botëkuptimi fetar prishet, kjo do të thotë se perandorisë sonë i ka ardhur fundi. Për ne është e trishtueshme që vendet me popullsi myslimane janë në dorën e Fuqive të Mëdha.”

(Abdylhamiti II)

shfaqën Lëvizja e Deçanit si forcë në rritje e sipër. Kallaballëku po ngutej! Duhej vetëm e vetëm të konvertoheshin, t’i ndërronin emrat, dhe kështu ta dëshmonin shqiptarizmin e tyre. Madje edhe na ngushëllonin, gjoja se ngadalë-ngadalë njerëzit do ta braktisnin xhaminë e do t’u bashkëngjiteshin atyre.

Këta njerëz të gjorë, asnjëherë nuk arritën ta kuptonin se përmes ndërrimit të emrave e besimeve të tyre nuk e dëshmojnë vendosmërinë, por e dëshmojnë luhatjen. Si mundet që një njeri i vendosur të kompleksohet nga vetë emri i tij? Pra, “pazarllëku” i tyre arrinte suksesin kur në këmbim të vlerës së identitetit të lindur dhe religjionit, fitonin nacionalizmin shqiptar. Dua ta mbyll artikullin me një anekdotë metaforike, që flet më së miri për grupin e lëvizjes për braktisjen e fesë islame.

“I bleu Nastradini voët ka dy pare e i shitke ka ni pare. Ju tubojshin gjinja kallabllak para ti me ble, se kërkush nuk i shitke ma lirë se ai, se ngjeti ishin ka dy pare.”

E pyeti ni dost:

Qysh Nastradin, voët i ke ble ka dy pare e po i shet ka ni pare?

Nastradini i thot:

Mos ma kqyr pazarllakun, po kqyrma kallabllakun.”⁴

Referenca:

1. <https://letersishqip.com/pashko-vasa/krijime-letrare/o-moj-shqypni>.
2. Branimir Anzulović, *Serbia hyjnore – nga miti te gjenocidi*, Botimet
3. Koha, Prishtinë, 2017.
4. Sulltan Abdylhamit, *Kujtimet e mia nga politika*, Sira, Prishtinë, 2021.
5. Anton Çeta, *Prozë popullore nga Drenica*, Enti i teksteve dhe i mjeteve
6. mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë, 1990.
7. <https://letersishqip.com/pashko-vasa/krijime-letrare/o-moj-shqypni>
8. Branimir Anzulović, *Serbia hyjnore – nga miti te gjenocidi*, Botimet Koha, Prishtinë, 2017, f. 51.
9. Sulltan Abdylhamit, *Kujtimet e mia nga politika*, Sira, Prishtinë, 2021, f. 202.
10. Anton Çeta, *Prozë popullore nga Drenica*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë, 1990, f. 147.

Disa shqiptarë “evropianë” dhe gjysmë identiteti fetar

(KONVERTIMET NË KOSOVË)

Emine A. Vezaj – Ciroka

Vala e konvertime në Kosovë, e cila me gjasë më shumë është mediale, sesa grup njerëzish që me vetë dëshire po “*largohen*” nga besimi i mëparshëm nuk është as risi dhe nuk paraqet asnjë sfidë për besimin islam, i cilin vazhdon të jetë më i madhi. Në anën tjetër kjo as nuk na frikëson, sepse gjendja e përgjithshme e gjitha xhamive në Kosovë është pikërisht spektakolare. Çështja e konvertimeve mund të jetë një problem i komplikuar, sepse përveç dimensionit fetar, aty është edhe dimension i shoqëror dhe psikologjik, por kjo erë konvertimesh më shumë t’i kujton ata fëmijët e lënë pas dore në edukim, të cilët me këmbëngulje bëjnë diçka që nuk e kanë të lejuar dhe që i kapërcen mundësitë e tyre. Në fakt, shikuar me objektivitet, besimi është diçka private dhe medialiteti apo orkestrimi që po i bëhet këto kohë vetëm se po trazon një konflikt që në nënqiellin tonë nuk ka ndezur zjarr edhe atëherë kur u munduan armiq të mëdhenj për ta bërë atë.

Shqiptarët, shekuj më parë kanë sendërtuar përkatësitë e tyre fetare dhe janë pajtuar me të, duke bashkëjetuar në paqe dhe harmoni. Andaj, çdo përpjekje për prishjen e kësaj baraspeshe, nga kushdo qoftë ai, do të na kthehet si bumerang të gjithë neve, dhe me pasoja të paparashikueshme.

Vala e konvertime në Kosovë, e cila me gjasë më shumë është mediale, sesa grup njerëzish që me vetë dëshire po “*largohen*” nga besimi i mëparshëm nuk është as risi dhe nuk paraqet asnjë sfidë për besimin islam.

Ne të gjithë pa dallim, myslimanë e të krishterë, u pajtuam për Gjergj Kastriot Skënderbeun – për hero kombëtar, ashtu siç ishte ai pa u thelluar më shumë se çfarë thonë historianë vendorë e ndërkombëtarë për përkatësinë e tij fetare. U pajtuam me Nëna Terezën, si bamirëse dhe humanitare për të nderuar kombin shqiptar. U pajtuam me ndërtimin e kishave katolike edhe nëpër ato vende ku nuk kishte popullatë katolike, vetëm e vetëm për të ruajtur harmoninë fetare që kemi trashëguar ndër shekuj. U pajtuam, që në qendër të Prishtinës të ngritët katedralja, e vlerësuam si shkrimtar mbarëkombëtar tashmë të ndjerin Ismail Kadarenë, pavarësisht sulmeve direkte ndaj Islamit e myslimanëve..., a mos është rastësi që Evropa e zgjodhi ta ngrejë deri në reputacion internacional si autorin më të rëndësishëm bashkëkohor në gjuhën shqipe pikërisht atë Ismail Kadare, i cili reputacionin e tij të lartë e përdori që ndër shqiptarët të promovojë idenë radikale se pranimi i Islamit përbën gabimin më të madh ndër shqiptar. D.m.th., ne pranuan e pranuan, saqë asnjë nga këto konvertime nuk është risi dhe nuk paraqet rrezik për ne si besimtarë, sepse siguria e besimit tonë kalon limitet emocionale dhe lojërat e mundshme politike të dirigjuara nga qarqet e shërbimet sekrete ose nga paqartësia e disa individëve që fajësojnë klerikë të



caktuar dhe gjoja si reaksion vendosin për t' u larguar nga ajo që ne besojmë bindshëm se është e vërteta.

Ne besojmë te liria e plotë e njeriut se përndryshe: ***“Po të donte Zoti yt do t'i krijonte njerëzit një popull.”*** Andaj diversiteti në aspektin fetar, kombëtar, racor e gjuhësor është në natyrën e kësaj bote. Me të drejtë ipeshkvi i ndjerë i Kosovës z. Mark Sopi pohonte se “Ne të gjithë e besojmë një Zot të vetëm, por secili e beson dhe adhuron atë në mënyrën e vet.”

PËRSE KONVERTIMET?

Në radhë të parë duhet vënë theksi te demontimi i mitit dashakeq për islamizimin e dhunshëm dhe përgënjeshtrimi i këtij falsifikimi ideologjik është imperativ absolut për shqiptarët. Ballkani është i vetmi territor në botë, në të cilin pushteti politik i shtetit - pushtues, gjatë tërësë së shekujve ka lënë liri të plotë të zgjedhjes dhe praktikimit të identitetit fetar, gjuhësor dhe kulturor për të gjithë popujt, pa marrë parasysh në numrin e tyre. Kishat, manastiret, sinagogat, me shkollat e tyre etj.. Duhet të jepet qartë e vërteta! Aq më tepër sepse është falsifikuar në mënyrë sistematike, ndërsa ky falsifikim ka krijuar shtresime të mëdha të mosmarrëveshjeve të thella dhe armiqësive të paarsyeshme ndaj myslimanëve shumicë. Me moskokëçarje të pabesueshme flitet për traditën islame të shqiptarëve si për një handicap dhe gabim historik, pra si për një gabim i cili mund të mënjanohet dhe përmirësohet edhe sot. Është përpunuar receta sa e thjeshtë aq edhe efikase, se si të përmirësohet ky gabim historik duke hequr dorë nga identiteti i tyre islam dhe që ta zëvendësojnë me atë romak-katolik, i cili korrespondon në tërësi me identitetin modern evropian dhe vlerat evropiane.

Së këndejmi, secili besim bën çmos që besimtarët e vet t' u mbesin besnikë prapëse te fesë së vet. Në veçanti kjo ndjenjë

është e theksuar në ato mjedise ku besimtarët e një besimi të caktuar janë pakicë. Sepse ata si të tillë edhe e ndiejnë veten të rrezikuar nga dominimi i shumicës. Islami vërtet është një lloj rreziku për ta! Por ata e dinë mirë se ky rrezik nuk vjen nga Islami si fakt konkret shpirtëror dhe shoqëror, por nga ndjenja e forcës tërheqëse, të cilën Islami e ka për ta, kurse ata duan ta fshehin sa prej të tjerëve e aq me shumë prej vetvetes. Kjo drojë e paargumentuar, përveç me bazën e saj psikologjike, është kushtëzuar edhe me faktin sociologjik dhe politik, se Islami si formë e jetës ka të bëjë me gjitha aspektet e shoqërisë dhe pranimi eventual i modelit islam kulturor do t'i ndryshonte rrënjësisht shumë karakteristika të paradigmës shoqërore për të ashtuquajturat shoqëri bashkëkohore perëndimore. Ky është një realitet që duhet të pajtohemi. Andaj, edhe bëhen përpjekje që secila fe të jetë sa më e organizuar dhe sa më afër besimtarëve të vet.

POR PËRSE E BËJNË KËTË?

Sepse, ata asnjëherë nuk krijuan një lidhje serioze me Zotin;

Ata asnjëherë nuk krijuan një dashuri për Profetin;

Ata asnjëherë nuk besuan se ka një shpërblim për besimtarët e drejtë;

Ata asnjëherë nuk e panë Islamin si zgjedhje të parë në festat e tyre e as në lidhjet, martesat, e vdekjet;

Ata asnjëherë nuk e kërkuan Islamin në tryezat e tyre, ndërsa ushqimi hallall është inekzistent dhe nuk i dihet emri;

Ata asnjëherë nuk kërkuan një xhami për fëmijët e tyre.

Tani, çfarë humbi Islami ose çfarë na bënë konvertimet e tyre kur realisht këta individë as nuk janë e nuk ishin pjesë e Islamit. Janë njerëz që për kohën që kanë jetuar “myslimanë” kanë qenë jashtë Islamit edhe si numër.

Shkurorëzimi dhe pasojat e tij te fëmijët

Mr.sc. Gyltene Dërguti

Kur dy të rinj krijojnë një lidhje martesore, shpeshherë nisen me ëndrra të mëdha për një jetë të lumtur, duke mos i parë të metat e njëri-tjetrit, ose edhe duke pasur pritshmëri të larta nga pala tjetër. Martesa apo krijimi i familjes para së gjithash nënkupton përgjegjësi dhe përkushtim. Është foleja ku realizohen të gjitha nevojat biopsiko-sociale në formë reciproke dhe të respektuar. Është foleja ku realizohet vazhdimësia e brezave, foleja ku lindin fëmijët dhe institucioni i parë i cili ndihmon në zhvillimin dhe edukimin e shëndetshëm të fëmijëve. Por ja që ndonjëherë njëri nga çifti, apo të dy nuk arrijnë të përshtaten në martesë, apo nuk arrijnë ta përballojnë martesën dhe lind nevoja për shkurorëzim – shpërbërjen e martesës. Shpeshherë brenga për të ardhmen e fëmijëve i vë para një dileme se a të vazhdohet në një martesë të palumtur, në një martesë nën dhunë, të sakrifkohet jeta për fëmijët, apo të shkurorëzohen e të shpëtojnë veten. Por bashkë me veten, nëse a po

shpëtohen apo po dëmtohen fëmijët, është dilema që vazhdon më tutje?!

Vendimi për shkurorëzim është tejet subjektiv, tejet individual dhe duhet të analizohet thellë e mirë para se të merret si nga individ, si çifti, po ashtu edhe nga këshillëdhënësi qoftë ai psikolog, psikiatër, teolog, terapist çifti apo terapist familjar. Ngase sado që shkurorëzimi është një zgjidhje e problemit, ai me vete bartë pasoja jo vetëm gjatë procesit të shkurorëzimit apo për një periudhë afatshkurtër, por ato mund të jenë afatgjata që përcjellin procesin tërë jetësor. Dhe si i tillë shkurorëzimi jep efekt sa mbi çiftin të cilët e shpërbëjnë martesën, gjithashtu edhe mbi fëmijët e tyre, familjet e tyre të gjera e po ashtu efektet zgjerohen edhe mbi shoqërinë dhe shtetin.

EFEKTET E SHKURORËZIMIT TE FËMIJËT

Procesi i shkurorëzimit ngërthen në vete pasiguri dhe emocione të shumta, fillimisht për çiftin. Sado që disa prej tyre edhe mund të ndahen në mënyrë ta quajmë miqësore apo me maturi, gjithsesi është një proces stresues për të dyja palët. Por po ashtu edhe për fëmijët, sidomos nëse gjatë procesit apo edhe pas realizimit të shkurorëzimit çifti dhe fëmijët nuk marrin mbështetje profesionale, gjë që akoma nuk është shumë e zakonshme te ne. Ndonëse shpeshherë kur fillon shkurorëzimi zyrtar ata mund të referohen që të kërkohet ndihmë profesionale, apo kur fëmijët janë të vegjël medoemos kërkohet edhe vlerësimi psikologjik prej psikologut klinik për mirëbesimin e fëmijëve. Kjo fazë mund të jetë e vonshme, pasi që çifti mund të kenë kaluar nëpër etapat e shkurorëzimit joformal shumë kohë më parë dhe debatet, konfliktet apo rastet e dhunës të shumta mund t'i kenë paraprirë shkurorëzimit para të cilave fëmijët mund të jenë ekspozuar disa herë. Mungesa e mbështetjes profesionale



e rritë rrezikun më shumë për pasoja të fëmijët. Është cekur edhe më lart që pasojat e shkurorëzimit mund të jenë edhe afatgjate duke ndikuar në jetën psiko-sociale të fëmijëve, duke rritur rrezikun që të zhvillojnë probleme të ndryshme, përfshirë shëndetin fizik dhe atë psikik. Ata i shoqëron ndjenja e mërzisë, izolimit në vete nga ana tjetër disa të tjerë mund të përjetojnë zemërim dhe shpërrthime emocionale. Te fëmijët mund të zhvillohen probleme me atashimin, ankthin dhe depresionin, si dhe në të ardhmen mund të kenë çrregullim në sjellje, rrezik për abuzim me alkool, me substanca narkotike, përfshirje në marrëdhënie të hershme seksuale, në adoleshencë flirtim me shumë partnerë, probleme në ndërtimin e raporteve me të tjerë, vështirësi të mbajnë marrëdhënie të ngushta me të tjerë dhe në ndërtimin e raporteve bashkëshortore në të ardhmen.

Varësisht nga mosha në të cilën janë fëmijët, shkurorëzimi mund të ndikojë më shumë ose më pak. Në moshë të vogël fëmija mund të zhvillojë ndjenjë faji për shkurorëzimin e prindërve. Ata mund ta fajësojnë veten se mund të kenë bërë diçka të gabuar dhe si rezultat i sjelljes së tyre prindërit janë shkurorëzuar. Mund të shfaqin sjellje regressive, siç është thithja e gishtit apo enuresis nocturna – urinim në shtrat, ngrënie të thonjve etj., e cila shfaqet si një manifestim i dhimbjes emocionale dhe si një mënyrë për ta qetësuar stresin dhe ankthin e përjetuar.

Kur fëmijët iu besohen nënës, në vendin tonë kryesisht nëna dhe fëmijët janë të detyruar të ndërrojnë vendbanimin, kështu që fëmijët, krahas që do të jenë larg babait të tyre, detyrohen të ndryshojnë edhe shkollën. Me këtë nënkupton ndërrimin e mësimdhënësve, të shoqërisë së klasës dhe shoqërisë së lagjes. Kjo gjë krahas shkuroëzimit sjell stres më vete dhe fëmijët ndonjëherë hasin vështirësi në përshtatje me rrethin e ri, kanë vështirësi të ndërtojnë raportet me bashkëmoshatarë, por ndodh të hasin edhe në bullizëm – ngacmim në rrethin e ri.

Disa fëmijëve mund t'i vijë turp për shkurorëzimin e prindërve. Në veçanti në rrethet e vogla ku e njohin njëri-tjetrin. Fëmija, për t'i shmanjur pyetjeve dhe

Te fëmijët mund të zhvillohen probleme me atashimin, ankthin dhe depresionin, si dhe në të ardhmen, mund të kenë çrregullim në sjellje, rrezik për abuzim me alkool, me substanca narkotike, përfshirje në marrëdhënie të hershme seksuale etj.

komenteve në lidhje me shkurorëzimin e prindërve mund të izolohehet nga rrethi social dhe aktivitetet e dëshiruara sociale.

Disa fëmijëve mund t'i ndikojë në rënien e interesimit për mësim, probleme me koncentrimin, si rezultat bie suksesi akademik, bëjnë mungesa të shumta në shkollë dhe përfshihen në sjellje problematike. Shpesh ju mungon mbikëqyrja e mjaftueshme, ngase nëna ose babai i shkurorëzuar është i mbingarkuar me përgjegjësi të dyfishtë, si dhe për shkak të stresit personal të përjetuar nuk arrijnë të ofrojnë mbështetjen e mjaftueshme për fëmijën e tyre.

Ndonëse fëmijët, sjellje agresive apo delikuede, mund të shfaqin edhe me qëllim që të tërheqin vëmendjen e prindërve si rezultat i frustrimit që e përjetojnë nga shkurorëzimi i tyre.

Stresi i shkurorëzimit mund të ndikojë edhe në çrregullimin e oreksit të fëmijëve dhe çrregullimin e gjumit. Disa mund të kenë humbje të oreksit dhe si rezultat mund të humbin peshë, ndërsa disa të tjerë të hanë shumë pa kontroll dhe kjo të ndikojë në obezitet – mbi-peshë. Gjumi mund të përcillet në formën e tepruar duke fjetur shumë gjatë natës dhe disa orë gjatë ditës, forma tjetër është forma e pagjumësisë, e cila pason me abuzim me teknologji informative, qëndrim të tej zgjatur në rrjete sociale, në lojëra online deri në varshmëri ndaj tyre.

Në rastet kur martesë shpërbëhet për shkak të dhunës në familje dhe nëse fëmijët kanë qenë të ekspozuar në rastet e dhunës, shkurorëzimin edhe mund ta mirëpresin dhe ka raste kur vetë fëmijët marrin iniciativë, qoftë për denoncim të dhunës, qoftë edhe për inicimin e shkurorëzimit të prindërve. Megjithatë edhe në këto raste pasojat mund të jenë prezente për shkak të stresit të përjetuar gjatë rasteve të dhunës së shkaktuar nga prindi apo cilitdo anëtar tjetër i familjes, i cili ka ushtruar dhunë. I pason ndjenja e fajit për inicimin apo edhe denoncimin, por edhe mund të fajësohen nga ana e abuzuesit ku në të shumtën e rasteve është babai apo ndonjë anëtar tjetër i familjes.

Disa janë të rrezikuar të zhvillojnë PTSD - çrregullimi i stresit pas traumës, ku në vete



bartë rikujtimin dhe ri përjetimin emocional të ngjarjeve traumatike të dhunës.

Pse fëmijët shfaqin rezistencë për takime?

Një gjë që e lehtëson procesin pas shkuro-rëzimit është edhe matura e prindërve gjatë kontaktit me fëmijët. Prindërit dhe të rriturit e tjerë në familje duhet të jenë shumë të kujdesshëm kur flasin për palën tjetër. Edhe pse burri mund të jetë i lënduar emocionalisht nga gruaja, apo anasjelltas, gruaja nga burri, në prani të fëmijës nuk duhet të flasin për përvojat negative dhe të përdorin etiketime negative për ish-bashkëshortin apo ish-bashkëshorten. Në raste të caktuara fëmijëve ju thuhet “ja ky, kjo si babai i vet ose nëna e vet”. Eventualisht kur i mbajnë takimet qoftë në institucionet e QPS-së apo jashtë saj përdorin fjalë ofenduese për nënën apo babanë me të cilin jeton fëmija. Kjo gjë e lëndon fëmijën, e bën të refuzojë takimet dhe ndikon negativisht në ndërtimin e imazhit për veten. Ndodhë që prindi me të cilin jeton fëmija e përdorë si *formë të hakmarrjes* ndaj ish-bashkëshortit apo bashkëshortes dhe nuk e lejon të mbajë kontaktin me prindin, ia fshehë kujdesin e treguar, dhuratat etj., pa qenë i vetëdijshëm se me këtë e ka lënduar fëmijën e vet. Ndonjëherë fëmijët për shkak të komenteve negative që dëgjojnë nga të rriturit për babanë apo nënën me të cilët nuk jetojnë

Bashkëshortët të cilët kanë fëmijë duhet të jenë të vetëdijshëm që prindërimi i tyre nuk përfundon me shkuro-rëzim.

“për t’iu hyrë në hatër” mund të sillen sikur nuk duan ta takojnë. Apo presionin që e ndjejnë pasi kthehen prej kontaktit duke diskutuar “se çfarë të tha”, “çfarë bëtë”, “si ishte”, e bëjnë të papërbalueshme emocionalisht për disa fëmijë dhe i bën t’i shmangen takimit me babanë apo nënën.

Ndonjëherë dhimbja që përjetojnë sa herë që ndahen nga prindi sidomos kur fëmijët i janë besuar babait dhe kontaktet janë të rralla me nënën mund të vërehet rezistencë për takime si nga ana e fëmijës po ashtu edhe nga nëna. Pafuqia që ndjejnë për ta përjetuar dhimbjen e ndarjes i bën të rezistojnë. Në të kaluarën, në të shumtën e rasteve fëmijët iu janë besuar baballarëve dhe me t’u martuar gruaja ndonjëherë ish-burri ka shfaqë rezistence që t’ia lejojë fëmijët për vizitë e ndonjëherë burri i radhës ia ka ndaluar edhe t’i përmendë se ka pasur dikur fëmijë. Kjo padrejtësi ka qenë e dyfishtë, si ndaj nënës duke ia mohuar një nevojë emocionale bazike të amësisë, njëkohësisht edhe fëmijëve iu është mohuar nevoja për ta takuar nënën e tyre.

Vlen të përmendet që është vërejtur shpeshherë që fëmijët e çifteve të shkuro-rëzuara *piqen para kohe*, bashkë me marrjen e të drejtës së familjes, atyre ju merret edhe një pjesë e fëmijërisë. Duke i parë të rriturit me



probleme, duke vuajtur apo duke tentuar t'i fshehin problemet, edhe fëmijët marrin një rol prindëror për t'i mbrojtur prindërit nga përjetimet emocionale.

SI MUND TË MBËSHTETEN FËMIJËT?

Edhe pse në fillim, çdonjëri shkurorëzimin mund ta përjetojnë më të vështirë, me kalimin e kohës kur ata ta pranojnë si fakt, arrijnë të përshtaten me jetën e re. Bashkëshortët të cilët kanë fëmijë duhet të jenë të vetëdijshëm që prindërimi i tyre nuk përfundon me shkurorëzim. Ata duhet të punojnë me veten sa më shumë, ta pasurojnë veten me metoda të shëndosha të disiplinimit dhe se mllëfin, ndjenjën e hak-marrjes, xhelozinë apo çfarëdo ndjenje që ndiejnë ndaj ish-bashkëshortit apo ish-bashkëshortes të jenë në gjendje të mos i ngufatin fëmijët me to.

E para që është me rëndësi, prindërit duhet paraprakisht të jenë të hapur me fëmijët e tyre, t'i përgatisin se po ndodh shkurorëzimi, t'u tregojnë se kjo është për shkak të mos-marrëveshjeve që kanë mes vete burri dhe gruaja dhe jo për shkak të fajit të fëmijëve.

Është shumë e rëndësishme t'u bëhet me dije se kudo që vendoset të jetojnë fëmija, dashuria për ta është e pashtershme dhe këtë t'ua dëshmojnë me të vërtetë si dashuri të pakushtëzuar.

T'ju ofrojnë siguri se do të kujdesen për ta në vazhdimësi.

T'iu tregojnë se edhe ata po përjetojnë stres në këtë proces: t'i ndajnë emocionet me fëmijët si mërzinë, ankthin për të ardhmen etj., kështu që fëmija do ta kuptojë që është normale të përjetojë ndjenja të tilla dhe do ta ketë më të lehtë t'i ndaj

përjetimet emocionale qoftë me nënën apo me babanë dhe t'i inkurajojnë që t'i shprehin emocionet e tyre.

T'ua mësojnë fenë e tyre, angazhimi në kurse fetare i ndihmon të bëhen më të përgjegjshëm dhe i mbron nga përfshirja në dukuri negative, tërthorazi e rregullon shëndetin mendor.

Angazhimi i fëmijëve në aktivitete sportive dhe sociale e ndihmon zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve dhe lehtëson procesin e përshtatjes.

Të përdorin metoda të përshtatshme disiplinore sipas moshës. Prindërit dhe të rriturit duhet të kenë kujdes të mos jenë tolerant tejmase nga dhembshuria, apo ndonjëherë mund të ndodhë ekstremi tjetër nga frika e llastimit mund të sillen tepër rigjid.

Gjatë kontaktit me fëmijët, të shfrytëzojnë kohën të flasin për nevojat dhe interesat e fëmijëve, t'i shmangen bisedave shpotitëse për prindin me të cilin jeton fëmija.

Të kërkohet ndihmë profesionale për veten e tyre dhe për fëmijët, varësisht nga nevoja te pediatri, psikologu i shkollës, psikologu klinik, punëtori social, psikiatri i fëmijëve, psikiatri për të rritur etj..

“Duke qenë bashkërisht të përgjegjshëm e të përkushtuar mund t'iu ndihmojmë fëmijëve të rriten dhe të edukohen sa më të shëndetshëm.”

Literatura:

- Coşkun, S. *Boşanma ve üzzerinde etkisi*. <https://sefacosgun.com.tr/bosanna-cocuklar-uzzerindeki-etkisi/>
- *Divorce and Children: Guidelines for Parents*: <https://www.nationwidechildrens.org/family-resources-education/health-wellness-and-safety-resources/helping-hands/divorce-and-children-HH-IV-72-1/98>, revised 5/17 Copyright 1998, Nationwide Children's Hospital.
- Judicial Council of California Administrative Office of the Courts, *Parenting after Separation, A Handbook for Parents*, <https://pas.familieschange.ca.gov/sites/all/themes/opas2/assets/docs/PAS-EN-Handbook.pdf>, 2014.
- Kelly, J. B. (2000). Children's adjustment in conflicted marriage and divorce: A decade review of research. *Journal of the American Academy of Child & Adolescent Psychiatry*, 39(8), 963-973.
- *The Effects of Divorce on Children & How to Help them Cope*: <https://www.psych.uic.edu/research/community-based-children-and-family-mental-health-services-research-program/in-the-news/the-effects-of-divorce-on-children-how-to-help-them-cope>, data: September 26, 2022.
- Yılmaz, L. *Boşanma Sürecinde ve Sonrasında Psikolojik Zorluklar*. <https://www.evimdekipikolog.com/blog/bosanna-sureci-ve-sonrasinda-psikolojik-zorluklar>, 5 ocak 2023.

Fenomeni i divorcit në Kosovë - shkaqet dhe ndryshimet sociale

Dr. Ferdi Kamberi

Një nga temat më të studiuara në kuadër të shkencave sociale është tema e familjes, martesës, të drejtat ligjore dhe divorci. Këto tema, qysh herët, kanë zgjuar kureshtjen e studiuesve eminentë social, sepse familja ka përbërë thelbin kryesor të shoqërisë. Sot, familja ka evoluar dukshëm në raport me të kaluarën, dhe shihet si bërthama kryesore e shoqërisë. Familja ka parimet, normat, vlerat dhe funksionet me të cilat shquhet dhe konsiderohet si e 'shenjtë' në kuptimin e zhvillimit të shoqërisë, dhe pa të cilën shoqëria nuk do të mund të ekzistonte dot. Ajo është zhvilluar përmes fazave dhe zhvillimeve të ndryshme që nga themelimi i saj deri më sot. Megjithatë, ka kaluar edhe në shumë sfida, me të cilat përballet. Prej sfidave me të cilat ballafaqohet familja sot është padyshim dhuna dhe divorci. E para apriori nënkupton anën e errët të familjes, që paraqet "një model të sjelljeve sulmuese dhe shtrënguese, duke përfshirë sulmet fizike, seksuale dhe psikologjike, si dhe detyrimin ekonomik, që të rriturit ose adoleshentët përdorin ndaj partnerëve të tyre intim".¹ Përderisa e dyta, është një e drejtë ligjore pothuajse në të gjitha vendet e botës, por që sjellë pasoja sociale, psikologjike, ekonomike, jo vetëm për individin, por edhe për familjen dhe shoqërinë. Divorc, do të thotë ndarje në mes të dy bashkëshortëve. Divorci është një "fenomen i zakonshëm në komunitetin e sotëm. Por gjithsesi përfaqëson një stresues të madh jetësor për individët e përfshirë, me pasoja potencialisht të forta

Sipas faqes zyrtare 'World Population Review' normat e divorcit sipas shteteve për vitin 2024 në 1000 banorë janë: Maldivet, me një normë divorci prej 5.52 për 1000 banorë, e cila kryeson botën në divorce, pjesërisht për shkak të faktorëve kulturorë dhe fuqizimit të grave.

negative për shëndetin mendor dhe fizik të të gjithë anëtarëve të familjes".² Divorc do të thotë fundi i martesës, pra pezullimi i detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore të martesës dhe zgjidhje e lidhjeve të martesës në mes të dy personave ose një çifti, dhe sot pothuajse të gjitha vendet e botës e lejojnë divorcin përveç Vatikanit dhe Filipineve, përderisa Malta te në vitin 2011 e ka lejuar një gjë të tillë. Si fenomen është parë si e kundërta e martesës dhe e familjes, pasi që me shkurorëzimin apo ndarjen e çiftit mbarojnë edhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Sipas faqes zyrtare 'World Population Review' normat e divorcit sipas shteteve për vitin 2024 në 1000 banorë janë: Maldivet, me një normë divorci prej 5.52 për 1000 banorë, e cila kryeson botën në divorce, pjesërisht për shkak të faktorëve kulturorë dhe fuqizimit të grave.³ Gjithashtu, divorci është i shprehur dukshëm edhe në vendet tjera, si: ShBA, Kanada, Rusi, por edhe në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Ballkanin Perëndimor, përfshirë shtetin e Kosovës. Me fjalë të tjera, fenomeni i divorcit është shndërruar në një rutinë, e cila edhe pse në aspektin ligjor kërkon kohë për shkak të procedurave burokratike, në praktikë çdo ditë e më shumë është duke u rritur jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet e tjera. Ky fenomen, në Kosovë është i lejuar, pasi konsiderohet si pjesë e të drejtave të njeriut, por që procedurat për të ardhur deri tek ai janë goxha burokratike dhe marrin kohë deri në vendimin e formës së prerë nga ana e

gjykatës. Zakonisht, kjo bëhet me qëllim që çiftet mund edhe të pendohen dhe mos të vije deri te ndarja e familjes dhe përjetimit të një mori pasojave kryesisht sociale dhe psikologjike. Sipas ligjit për familje theksohet se “martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës. Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente. E drejta për ngritjen e padisë për shkurorëzim nuk mund të kalohet te trashëgimtarët, por trashëgimtarët e paditësit mund të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë. Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje”.⁴ Ligji për familjen e lejon divorcin/shkurorëzimin dhe tregon edhe për të drejtat dhe format për të parashtruar padi pran gjykatës. Kësisoj, përmes ligjit potencohet e drejta e çifteve për të kërkuar divorc për shkaqe ose rrethana të ndryshme.


TË DHËNAT DHE TRENDËT E RITJES SË DIVORCIT

Fenomeni i divorcit është bërë një ndër problemet më të theksuara në Kosovë. Ky fenomen ka ekzistuar edhe më parë, por për shkak të faktorëve të ndryshëm ka qenë më pak i

pranishëm se sa sot. Por, me zhvillimin e shoqërisë, si duket të dhënat tregojnë të kundërtën, pra një rritje të trendit të divorcit, jo vetëm në Kosovë, por edhe në vende të tjera. Sido që të jetë, përderisa në të kaluarën familjet kryesisht kanë qenë të mëdha me më shumë anëtarë dhe kanë jetuar në bashkësi, divorci ka qenë më pak i pranishëm dhe kjo edhe për shkak të faktorëve të ndryshëm, përfshirë këtu mungesën e institucioneve shtetërore, të drejtën zakonore dhe sistemin kryesisht patriarkal. Ndërsa, tani kemi familje me më pak anëtarë, funksionimin e institucioneve të shtetit, përfshirë edhe zhvillimin e legjislacionit, por që divorci vazhdon të ketë rritje dhe kjo për shkak të faktorëve të ndryshëm. Sociologu Gollopi, i cili është marrë me këtë problematikë dhe krahasimet në mes të para dhe pas vitit 1999, thekson se “shkurorëzimi ka shënuar një rritje të theksuar, madje nëse bëjmë një krahasim me fillimin dhe fundin e dekadës që lamë pas është trefishua (në vitin 2000 ishte 3.33%). Gjatë studimit të realizuar (me 2007), kemi ardhur në përfundime se në vitin 1970, çdo i 44 çift i kurorëzuar shkurorëzohej ndërsa, në vitin 2007, çdo i 11 çift i kurorëzuar shkurorëzohet”.⁵ Duhet theksuar se “prej viteve 1950 e deri në ditët e sotme kemi një lëvizje të ndryshme të shkallës së shkurorëzimeve, herë me tendencë rënie e herë me tendencë rritje. Kështu të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë për një rënie dhe rritje të kurorëzimeve dhe shkurorëzimeve/divorcit gjatë periudhave të ndryshme të cilat i kemi paraqitur, si vijon:

Viti	1955	1966	1987	2011	2014	2016	2017	2020	2023
Kurorëzimi	6815	8246	13350	16619	16239	16274	17112	13463	16978
Shkurorëzimi	426	514	260	1469	1243	1110	1072	1614	2023
Mesatarja	6.2	6.3	1.9	8.9	7.6	6.8	6.2	12	12

Tabela 1: Pasqyrimi i kurorëzimeve, shkurorëzimeve dhe mesatares sipas viteve 1955 – 2023.⁶



Diagrami 1: Pasqyron kurorëzimet dhe shkurorëzimet sipas viteve 1955 – 2023.⁷

Viti	1955	1966	1987	2011	2014	2016	2017	2020	2023
Shkurorëzimi	426	514	260	1469	1243	1110	1072	1614	2023
Sipas zgjatjes së martesës									
0 vjet	30	22	18	129	120	97	103	12	42
1	41	33	23	211	147	169	144	132	177
2	56	40	26	159	149	140	141	159	217
3	52	43	30	154	113	94	101	131	126
4	32	47	21	139	118	91	76	185	156
5 – 9	143	144	70	384	319	279	248	469	711
10 - 14	29	98	39	104	126	122	115	242	321
15 e më shumë	43	87	33	189	151	118	144	284	462
Numri i mbajtjes së fëmijëve									
Pa fëmijë	233	294	129	1110	814	730	739	-	-
Një	113	115	68	231	113	122	86	-	-
Dy	55	62	36	80	156	139	120	-	-
Tre e më shumë fëmijë	26	43	27	48	160	119	127	-	-

Tabela 2: Pasqyrimi i kurorëzimeve, zgjatjes së martesave dhe numrit të mbajtjes së fëmijëve sipas viteve 1955 – 2023.⁸

Bazuar nga të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (të cilat janë përpunuar nga ne) del se nga viti 1955 e deri në vitin 2023 ka pasur rënie dhe rritje si të kurorëzimeve po ashtu edhe të shkurorëzimeve/divorceve, të cilat janë manifestuar edhe nga ndikimi i një mori faktorëve.

Përderisa në vitin 1955, numri i kurorëzimeve ka qenë 6815, numri i shkurorëzimeve ka qenë 426, me një mesatare prej 6.2.

Në vitet 80, shohim se numri i kurorëzimeve është rritur dukshëm lart prej 13350, kurse numri i shkurorëzimeve ka shënuar rënie vetëm në 260 raste të regjistruara me një mesatare prej 1.9. Në vitin 2011, në regjistrimin e popullsisë, del se ka pasur 16619 kurorëzime dhe 1469 shkurorëzime me një mesatare prej 8.9. Kurse, në vitin 2023, numri i kurorëzimeve është rritur në 16978 dhe numri i shkurorëzimeve po ashtu është rritur në 2023 ose me një mesatare prej 12. Sipas viteve, shohim se në vitet e fundit shkurorëzimet kanë shënuar një rritje të dukshme në raport me vitet e mëparshme. Sa i përket shkurorëzimeve/divorceve dhe raportit me kohëzgjatjen e martesës dhe numrin e fëmijëve, të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, theksojnë, si vijon:

Siç mund të shohim në tabelën nr. 2, zgjatja e martesës ka pasur rënie dhe ngritje të kohë pas kohe, dhe siç mund të shihet në vitet e fundit martesat nuk zgjasin më shumë se tre

vitet e para, gjë që tregon për problemet e theksuara dhe krizën në familjen shqiptare. Po ashtu, pjesa tjetër e tabelës pasqyron shkurorëzimet sipas viteve dhe numrin e fëmijëve, ku prijnë shkurorëzimet pa fëmijë, pastaj shkurorëzimet me dy fëmijë, me një dhe në fund edhe me tre dhe më shumë fëmijë. Të gjitha këto të dhëna janë një alarm për shoqërinë kosovare se gradualisht familja e cila dikur është konsideruar si ‘strehë’ për anëtarët e saj, po e humb atë ndjenjë e dikurshme, është duke u konsumuar martesë dhe kjo ka bërë që të shpërfaqen edhe këto shifra të larta të divorceve, të cilat bartin edhe pasojat shumta.

SHKAQET DHE PASOJAT E DIVORCIT

Ndryshimet dhe zhvillimet sociale, të cilat kanë ndodhur në Kosovë, padyshim se kanë prekur edhe çështjen e familjes si agjens i parë i socializimit. Përderisa dikur familja është konsideruar familja e fortë e cila iu ka bërë ballë shumë furtunave të ndryshme dhe sfidave, sot nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Periudha e tranzicionit, faktorët e jashtëm dhe të brendshëm kanë ndikuar që të ketë evoluim të familjes. Familja në të kaluarën ka qenë më shumë tradicionale dhe në formën patriarkale, ku pushtetin e kanë pasur më shumë burrat dhe se rolet gjinore kanë qenë të ndara. Sot, familja ka lëvizur dukshëm në formën e familjes egalitare, drejt një barazie të theksuar në të gjitha poret e jetës në mes të burrit dhe gruas. Sido që të jetë, pavarësisht ndryshimeve

Divorci është një e drejtë e individit, por që prodhon efekte të tjera jo vetëm individuale, por edhe kolektive.

dhe zhvillimeve të cilat kanë ndodhur, divorcet janë rritur dukshëm dhe kjo është evidente, sidomos te çiftet të cilat kanë edhe fëmijë dhe bartin pasojat. Divorci është një e drejtë e individit, por që prodhon efekte të tjera jo vetëm individuale, por edhe kolektive. Sot, studimet nënvizojnë se ka lloje të ndryshme të divorcit, mirëpo një tipologji e mundshme e divorcit mund të jetë: a) Divorci jo-fajtor sipas një sistemi, shpërbërja e martesës që nuk kërkon pretendimin ose dëshminë e fajit / fajtorit. Me fjalë të tjera, ky lloj divorci është i atillë që nuk kërkohet faji, apo fajtori, por merren si bazë faktet dhe arrihet deri te rasti në fjalë; b) Divorci fajtor, deri para vitit 1975 në shumicën e vendeve kërkohej që për divorc të sjellin edhe dëshminë e njëres dhe palës tjetër, madje në disa vende ende kërkohet një gjë e tillë, p.sh. në Nju Jork ende kërkohet faji/ fajtori; c) Divorci përmbledhës është kur bashkëshortët plotësojnë kërkesat e caktuara më parë, p.sh. kur një martesë bëhet për përfitime personale, materiale ekonomike, pastaj për marrjen e nënshtetësisë etj.; d) Divorci i pakontestueshëm paraqitet kur të dy palët (bashkëshortët) janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje me ose pa avokat; e) Divorci bashkëpunues po bëhet një model popullor sot gjithkund. Ky lloj divorci ekziston kur palët pajtohen të negociojnë për një zgjidhje me anën e avokatëve, në ndërmjetësim dhe shpesh me ndihmën e një specialisti neutral. Palët në këtë rast janë të autorizuar të marrin vendimet e tyre bazuar në nevojat dhe interesat e tyre personale; f) Divorci ndërmjetësues është atëherë, kur palët angazhojnë ndonjë avokat, ose avokati i rastit në fjalë mund të caktohet nga vetë organet gjyqësore.⁹ Para se të divorcohen çiftet, ata kalojnë në disa tranzicione gjatë këtij procesi, të cilat nuk janë aspak të lehta. Kësisoj, sipas Paul Bohannan, janë gjashtë të ashtuquajtura stacione të divorcit nëpër të cilat duhet të kalojë çifti që divorcohet: a) divorci emocional – shpreh përkeqësimin e martesës, rritjen e tensionit midis partnerëve, dhe zakonisht çon drejt ndarjes; b) divorci ligjor – është fundi i martesës nga ana ligjore; c) divorci ekonomik – ka të bëjë me ndarjen e pasurisë dhe të pronave; d) divorci bashkëprindëror – lidhet me problemet e kujdestarisë mbi fëmijët dhe të drejtat e takimeve me ta; f) divorci social – ka të bëjë me ndryshimet në rrethin shoqëror të të divorcuarve; e) divorci psikologjik – kur individ ndërpret lidhjet e mëparshme emocionale dhe përballon kërkesat e të jetuarit të vetëm.¹⁰ Një seri intervistash të Robert Weiss me burra dhe gra të divorcuara në ShBA, tregojnë një trajektore të qartë të përshtatjes që ndodh. Gratë vuajnë më shumë divorcin nga pikëpamje ekonomike, ndërsa nga pikëpamje psikologjike e sociale përshtatja është e njëjtë për të dy seksat. Në shumicën e rasteve të studiuar nga Weiss, vihet re se respekti dhe pëlqimi për njëri – tjetrin zhdukeshin që përpara ndarjes. Vendin e tyre e zinte mosbesimi dhe armiqësia. Nga ana tjetër, vazhdon të ekzistojë ndjenja e të qenit të lidhur emocionalisht me njëri – tjetrin. Edhe pse partnerët mund të



grinden keqas para ndarjes, ata provojnë një ndjenjë të thellë që Weiss e quan *hidhërimi i ndarjes*.¹¹ Sido që të jetë, në tërë këtë vorbulle të këtij fenomeni ekzistojnë disa nga shkaqet e divorcit, të cilat e kanë përcjellë edhe shoqërinë kosovare. Jennifer Litner psikologe në një artikull të botuar, thekson se disa nga faktorët e divorcit në shoqërinë bashkëkohore janë edhe mungesa e angazhimit, sfidat financiare dhe tradhtia janë disa nga shkaqet kryesore të divorcit në botë. Por mosha dhe kultura juaj mund të ndryshojnë gjithçka. Ajo numëron edhe disa faktorë të tjerë, si: mungesa e dashurisë dhe intimitetit, problemet e komunikimit, mungesa e simpatisë, besimit dhe respektit, pastaj ndarja për shkak të interesave dhe aktiviteteve të ndryshme. Çiftet që përballen me sfida për të pasur fëmijë gjithashtu duket se kanë më shumë gjasa të divorcohen nëse një familje më e madhe është një prioritet për një ose të dy partnerët.¹² Pjesa më e madhe e faktorëve të tillë janë prezentë edhe në shoqërinë shqiptare. *Së pari*, periudha e tej zgjatur e tranzicionit, e cila ka duplikuar një mori të vlerave për të cilat fatkeqësisht nuk ka ndonjë selektim se çka janë dhe si duhet prioritetizuar vlerat. *Së dyti*, problemet brenda për brenda familjes, të cilat apriori ndërliken me aspektin e dhunës në familje e cila është si rezultat i moskuptimit, aksesit të gabueshëm dhe mosdurimit. *Së treti*, tradhtia bashkëshortore, e cila është goxha e theksuar në mjedisin tonë social dhe si e tillë ka prodhuar divorce. *Së katërti*, faktorët socio – ekonomik, të cilët kanë prodhuar situata të shumta, madje duke arritur deri te konsumimi i martesës dhe hapjes së rrugës drejt divorcit. *Së pesti*, faktorë të tjerë janë edhe: dobësimi i rolit në familjen kosovare dhe rënia e prestigjit familjar krahasuar më parë,¹³ dhe të dy këta faktorë janë goxha prezentë në familjet shqiptare, gjë që ka bërë që të ndikojnë në rritjen e divorceve. Faktorë të tjerë, përfshijnë edhe faktorët tjerë individual, si: stresi, depresioni,

përdorimi i substancave psiko – aktive, alkooli, dhuna e shfaqur në familje, konsumimi i martesës, mungesa e fëmijëve, si dhe faktorë të tjerë. Shkaqet e divorcit janë paraqitur edhe në kuadër të ligjit për familjen, ku nënvizohet se “bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme. Shkaqet e shkurorëzimit janë mes të tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeq dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paafësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme.¹⁴

Divorci si fenomen social dhe juridik, nuk paraqet një ngjarje në jetë e cila mund të harrohet aq lehtë, mirëpo në të përfshihen disa etapa që nga: konflikti i brendshëm nga ajo që sociologët e quajnë inicori e deri në përfundimin e tij. Pra, nga ai/ajo që fillon konfliktin, pastaj ndarja, krijimi i një ambienti, tentativa në gjirin familjar, riorganizimi, rimartesa apo martesa e re, etj.. Të gjitha këto tregojnë se divorci nuk mund të përjetohej lehtë, prandaj edhe ka pasojat e tij që përfshijnë: depresion të vazhdueshëm, ankth, fobi sociale, agresivitet të lartë, izolim social, pasiguri në jetë, pesimizëm të thellë psikologjik, etj.. Po ashtu, studimet tregojnë që të divorcuarit përjetojnë sëmundje shpirtërore dhe fizike, madje ky problem ndikon edhe në problemet shëndetësore. Mirëpo, pasojat më të rënda janë për fëmijët, të cilët kanë një ndrydhje psikologjike apo atë që quhet latente (e fshehur), e cila i bartë ata/ato deri në periudha të ndryshme e që mund të manifestohen me sjellje jo sociale në raport me të tjerët¹⁵ dhe probleme të tjera të theksuara.

Si përfundim, mund të themi se fenomeni i divorcit viteve të fundit ka shënuar një rritje enorme në raport me të kaluarën. Si e drejtë ligjore, por me pasojat jo vetëm individuale, por edhe kolektive, divorci vazhdon të jetë sfidë serioze për zhvillimin e mëtutjeshëm të familjes shqiptare. Në këtë segment, është më se e rëndësishme që institucionet publike të kenë një strategji të zhvillimit mbi politikën popullore dhe zhvillimin e familjes dhe në kuadër të kësaj strategjie të ketë trajnime joformale për rolin dhe përgjegjësitë brenda familjes. Është e nevojshme që në kuadër të kurrikulave shkollorë, fokus të veçantë të ketë familja, të drejtat, roli dhe përgjegjësitë, në mënyrë që nxënësit të kenë një ngritje të vetëdijes mbi këto tema. Organizatat e shoqërisë civile, duhet të zhvillojnë avokime për mbrojtjen dhe zhvillimin e familjes, por edhe për obligimet, përgjegjësitë, shkaqet dhe pasojat e divorcit, në mënyrë që çiftet të analizojnë këto përgjegjësi apo obligime dhe mos të vije deri te divorci dhe shfaqja e pasojave sidomos për fëmijët. Qendrat për punë sociale, fokus duhet të kenë më shumë terapi familjare, në mënyrë që problemet e theksuara, si: stresi,

depresioni, varësia nga alkooli, droga, si dhe probleme të tjera, të zgjidhen brenda për brenda familjes dhe mos të vije deri te konfliktet apo shuarja e familjes. Organizatat fetare, të cilat kanë për qëllim organizimin e jetës fetare, duhet të fokusohen më shumë në ligjërimet mbi sakramentin e familjes, në mënyrë që të ruhet baza e familjes së shëndosh, pavarësisht faktit që divorci konsiderohet si e drejtë e individëve.

Literatura:

- Agjencia e Statistikave të Kosovës: “*Vjetari statistikor 2024*”, ASK, Prishtinë, 2024.
 - Ciabattari, Teresa: “*Sociology of Families, Change, Continuity, and Diversity*”, Saga, Pacific Lutheran University, London, 2017.
 - Damota Deribe. Mulugeta: “*The Effect of Divorce on Families' Life*”, Journal of Culture, Society and Development, Vol.46, 2019: DOI: 10.7176/JCSD.
 - GANLEY L. ANNE: “*Understanding Domestic Violence*”, Colorado, 2020.
 - Giddens, Anthony: “*Sociologjia*”, Fondacioni Soros – Çabej, Tiranë, 2004.
 - Giddens, at al: “*Introduction to Sociology*”, Norton & Company, 11 edition, New York, 2018.
 - Golloperi, Besim: “*Divorci dhe çrregullimet familjare*”, botuar në: <https://telegrafi.com/divorci-dhe-çrregullimet-familjare/>, 2013.
 - Golloperi, Besim: “*Shkaqet dhe pasojat e shkurorëzimit në Kosovë në periudhën 1950 – 2007*”, ACTA, Shoqata për Shkencë dhe Art LOGOS – 5, Shkup, 2010.
 - Kamberi, Ferdi: “*Dilemat e tranzicionit*”, Artini, Prishtinë, 2019.
 - Ligji Nr. 2004/32 për Familje i Kosovës.
 - Litner, Jennifer: “*The Top 12 Reasons for Divorce*”, artikull i botuar në: <https://psychcentral.com/relationships/top-reasons-for-divorce>, 2024.
 - World Population Review: “*Divorce Rates by Country 2024*”, marrë nga: <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/divorce-rates-by-country>
- 1 GANLEY L. ANNE: “*Understanding Domestic Violence*”, Colorado, 2020, fq. 16.
 - 2 Damota Deribe. Mulugeta: “*The Effect of Divorce on Families' Life*”, Journal of Culture, Society and Development, Vol.46, 2019: DOI: 10.7176/JCSD.
 - 3 World Population Review: “*Divorce Rates by Country 2024*”, marrë nga: <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/divorce-rates-by-country>
 - 4 Ligji Nr. 2004/32 për Familje i Kosovës, neni 68.
 - 5 Golloperi, Besim: “*Divorci dhe çrregullimet familjare*”, botuar në: <https://telegrafi.com/divorci-dhe-çrregullimet-familjare/>, 2013.
 - 6 Agjencia e Statistikave të Kosovës: “*Vjetari Statistikor 2024*”, ASK, Prishtinë, 2024, fq. 56-58.
 - 7 Po aty, fq. 58.
 - 8 Agjencia e Statistikave të Kosovës: “*Vjetari Statistikor 2024*”, ASK, Prishtinë, 2024, fq. 56-58.
 - 9 Kamberi, Ferdi: “*Dilemat e tranzicionit*”, Artini, Prishtinë, 2019, fq. 72.
 - 10 Giddens, Anthony: “*Sociologjia*”, Fondacioni Soros – Çabej, Tiranë, 2004, fq. 387-388.
 - 11 Po aty, fq. 388.
 - 12 Litner, Jennifer: “*The Top 12 Reasons for Divorce*”, artikull i botuar në: <https://psychcentral.com/relationships/top-reasons-for-divorce>, 2024.
 - 13 Kamberi, Ferdi: “*Dilemat e tranzicionit*”, Artini, Prishtinë, 2019, fq. 77.
 - 14 Ligji Nr. 2004/32 për Familje i Kosovës, neni 69.
 - 15 Kamberi, Ferdi: “*Dilemat e tranzicionit*”, Artini, Prishtinë, 2019, fq. 77.

Kanceri i gjirit

Dr .Vildana Goga – Çmega

Kanceri i gjirit është një nga shkaqet kryesore të vdekjeve të gratë, por, zbulimi i hershëm dhe trajtimi efektiv janë çelësi për t'i përmirësuar normat e mbijetesës. Sipas "Shoqatës Amerikane të Kancerit", shkalla e mbijetesës relative 5-vjeçare është më shumë se 90% kur kanceri i gjirit zbulohet herët dhe mbetet i lokalizuar. Kuptimi i simptomave, faktorëve të rrezikut dhe trajtimeve të disponueshme është thelbësor për rritjen e mbijetesës dhe ruajtjen e cilësisë së jetës.

Kanceri i gjirit është një sëmundje tumorale e shkaktuar nga shumimi i padëshiruar dhe i pakontrolluar i qelizave në indin e gjirit. Së pari, ai përhapet në nyjat limfatike, nën sqetull, nëpërmjet limfës, dhe nëse trajtimi vonohet përhapet edhe në organe të tjera.



Kanceri i gjirit është një sëmundje tumorale e shkaktuar nga shumimi i padëshiruar dhe i pakontrolluar i qelizave në indin e gjirit. Së pari, ai përhapet në nyjat limfatike, nën sqetull, nëpërmjet limfës, dhe nëse trajtimi vonohet përhapet edhe në organe të tjera.

Edhe pse shkakut e kancerit të gjirit nuk dihet saktësisht, megjithatë trashëgimia, ushqimi, statusi socio-ekonomik, gjendja menstruale, lindjet, ushqyerja me gji, pilulat kontraceptive dhe hormonet janë ndër faktorët e njohur. Ndonëse është më i shpeshtë në moshën 50-60 vjeç, sot është në dukje edhe në moshën 30-40 vjeçare.

Një në tetë gra është në rrezik të zhvillimit të kancerit të gjirit gjatë jetës së tyre. Në vendin tonë, çdo vit diagnostikohen rreth 450 gra me këtë sëmundje. Rrallë, kanceri i gjirit mund të prekë edhe burrat.

SHENJAT DHE SIMPTOMAT

Shenjat e zakonshme të kancerit të gjirit përfshijnë një gungë në gji, një trashje të lëkurës që ndihet ndryshe nga indi përreth, ndryshime në madhësinë ose formën e gjirit dhe ndryshime në pamjen e thithës, si rrafshim ose kthim brenda. Lëkura në zonën e gjirit mund të ndryshojë ngjyrë, bëhet me gropëza ose të duket si lëkurë portokalli. Në disa raste, mund të ketë lëkurë që çahet, skuqet, shfaqen luspa, rrjepje ose lëkura përreth thithës apo gjirit mund të shfaqet e plasaritur.

FAKTORËT E RREZIKUT

Disa faktorë mund të rrisin gjasat e zhvillimit të kancerit të gjirit. Këto përfshijnë të qenët femër dhe plakja (shumica e rasteve ndodhin te gratë mbi 55 vjeç), të pasurit e një historie familjare të kancerit të gjirit dhe mutacionet gjenetike të tilla si BRCA1 dhe BRCA2. Faktorë të tjerë përfshijnë fillimin e hershëm të menstruacioneve, menopauzën e



vonuar dhe lindjen e fëmijës në moshë më të vonë, të cilat gjithashtu rrisin rrezikun. Faktorë të tjerë përfshijnë të pasurit e gjoksit të dendur, ekspozimi ndaj terapisë me rrezatim, mbipesha, mungesa e aktivitetit fizik dhe konsumimi i alkoolit.

Ndërkohë që disa faktorë, si gjenetika dhe mosha, janë të pashmangshëm, disa ndryshime në mënyrën e jetesës mund të ndihmojnë në uljen e rrezikut të kancerit të gjirit. Këto përfshijnë ruajtjen e një peshe të shëndetshme, angazhimin në aktivitete të rregullta fizike, kufizimin e konsumit të alkoolit, dhënien e gjirit, shmangien e terapisë së zëvendësimit të hormoneve dhe, në raste me rrezik të lartë, marrjen në konsideratë të masave parandaluese si mastektomia profilakse ose marrja e medikamenteve.

DIAGNOZA

Kanceri i gjirit zakonisht zbulohet përmes mamografive, të cilat identifikojnë anomalitë e hershme. MRI-të mund të përdoren bashkë me mamografitë për të dalluar masat e forta nga ato të mbushura me lëng ose për të dhënë imazhe më të hollësishme pas gjetjeve anormale.

Nëse një kancer i mundshëm gjiri zbulohet gjatë shqyrtimeve, testet diagnostike si një biopsi janë të nevojshme për të konfirmuar diagnozën. Një biopsi përfshin heqjen e një sasive të vogël të indeve për shqyrtim mikroskopik. Pasi të konfirmohet kanceri, përcaktohet faza e tij bazuar në madhësinë e tumorit, përfshirjen e nyjave limfatike dhe nëse është përhapur në zona të tjera.

OPSIONET E TRAJTIMIT

Me ndryshimin e teknikave kirurgjikale dhe profileve të trajtimit, çdo ditë e më shumë aplikohen trajtime më të

Kanceri i gjirit zakonisht zbulohet përmes mamografive, të cilat identifikojnë anomalitë e hershme.

përditësuar. Në trajtimin e kancerit të gjirit përdoren metoda të ndryshme, në varësi të gjendjes së sëmundjes. Falë ilaçeve, kimioterapisë, radioterapisë dhe imunoterapisë, teknikat kirurgjikale gjithashtu kanë ndryshuar shumë.

Trajtimi i kancerit të gjirit zakonisht përfshin një ose më shumë nga qasjet e mëposhtme:

- Kirurgjia është trajtimi për kancerin e lokalizuar të gjirit, qoftë përmes një lumpektomie (heqjes së tumorit dhe indit përreth) ose mastektomie (heqjes së gjithë gjirit).

- Terapia me rrezatim mund të përdoret pas operacionit për të shkatërruar qelizat e mbetura të kancerit dhe për të ulur rrezikun e rikthimit.

- Kimioterapia përdoret për të shkatërruar qelizat e kancerit në të gjithë trupin, qoftë para ose pas operacionit për të zvogëluar tumoret ose për të eliminuar qelizat e mbetura.

- Terapia hormonale përdoret për kanceret pozitive ndaj hormoneve, duke bllokuar hormone si estrogeni që ushqejnë rritjen e kancerit.

- Terapitë e targetuara dhe imunoterapia janë trajtime të avancuara që ndërhyjnë me molekula specifike në qelizat e kancerit ose stimulojnë sistemin imunitar për të luftuar kancerin.

Diagnoza e hershme dhe plani i duhur i trajtimit të personalizuar mund të bëjë të gjithë ndryshimin në rrugën drejt shërimit.

REKOMANDIMET

Nga mosha 20-vjeçare, çdo grua duhet të kontrollojë të dy gjinjat nga sjetulla deri te thithka për 10 minuta në ditën e 5-të pas përfundimit të menstruacioneve, dhe të bëjë një USG. Pas moshës 40-vjeçare, për femrat rekomandohet ekzaminimi klinik i gjirit dhe mamografia.

Duhet kujdesi për një stil jetese sa më të shëndetshëm që të jetë e mundur. Vetëm në këtë mënyrë ulet rreziku edhe nga sëmundje të ndryshme, përveç kancerit të gjirit si:

- Mënjanimi i mbipeshës;
- Lëvizja e mjaftueshme;
- Mos konsumimi i alkoolit;
- Ushqimi i balancuar dhe i larmishëm, me shumë fruta dhe perime;
- Mos pirja e duhanit.



Kuptimi i injorancës

“INJORANCA ËSHTË MË E RREZIKSHME SE NJË MUNGESË E THJESHTË NJOHURIE”

Nada Hoteit

Injoranca është si një grup njerëzish, që jetojnë në errësirën e një shpelle nëntokësore, të lidhur në këmbë dhe në qafë, saqë nuk lëvizin dot as për të kthyer kokën dhe nuk kanë kujtim tjetër për jetën.



Në librin e tij “Republika”, filozofi grek Platoni, rrëfeu historinë simbolike të shpellës, e cila shpejt u bë imazhi më i famshëm i “injorancës” në të gjithë historinë e filozofisë. Në tregim, injoranca është si një grup njerëzish, që jetojnë në errësirën e një shpelle nëntokësore, të lidhur në këmbë dhe në qafë, saqë nuk lëvizin dot as për të kthyer kokën dhe nuk kanë kujtim tjetër për jetën. Kjo sepse kanë qenë të burgosur në këtë mënyrë që në fëmijëri. Përpara tyre, ata shohin vetëm hije lëvizëse të hedhura nga gjëra të panjohura për ta, të ndriçuara nga një zjarr vallëzues, që Platoni na thotë se qëndron diku prapa tyre që ata nuk mund ta shohin. Ky grup njerëzish fatkeq nuk di asgjë për këtë botë, përveç atyre hijeve dhe dëgjon vetëm jehonën e zërave të rojeve, të cilët nuk i kanë parë kurrë më parë. Kështu i kalojnë ditët.

TELASHET E INJORANCËS

Në këtë paraqitje të tmerrshme, e cila nuk është thjesht një shpellë e errët, por më tepër një telash i rëndë dhe një sprovë e plotë që Platoni e konsideroi më të keqe se burgu, më e tmerrshme se skllavëria dhe më afër vdekjes, thotë ai, duke marrë hua nga “Odisea” e Homerit. Kur i referohemi të vdekurve që jetojnë në ferrin e botës së përtejme, është më mirë të jesh një shërbëtor i përlurur i një zotëri të varfër dhe të durosh çdo gjë në këtë botë, sesa të jetosh dhe të shohësh atë që shohin.

Ndërsa mendojmë këtë dilemë të rreptë platonike, kuptojmë se mungesa e lirisë dhe kufizimi i lëvizjes fizike e kufizojnë botën e përvojës njerëzore në humnerën e injorancës së thellë, duke i penguar ata të hyjnë në përvoja të reja, që lejojnë të mësojnë dhe të hapin para tyre horizonte të ndryshme nga

ato me të cilat janë mësuar, kështu që nuk janë në gjendje të kuptojnë gjërat, ose të jenë të zënë me gjëra me vlerë, apo të shijojnë ndonjë vlerë të bukurisë.

SIPAS PLATONIT, INJORANCA DUKET SE ËSHTË PRODUKT I PAAFTËSISË

Megjithatë, në tregimin e tij, injorantët nuk e kuptojnë dhe nuk mund ta kuptojnë natyrën e gjendjes së tyre në të cilën po vuajnë, pasi ata do të besojnë në çdo kohë se e vërteta është asgjë veç atyre hijeve që kërcejnë para tyre në murin e shpellës, dhe përvojat e tyre të jetës do të jenë një përzierje e imagjinatave të përziera që jehojnë përsëri në zërat e rojeve të tyre.

Shpella e Platonit është padyshim një fantazi e pastër dhe lexuesi ndihet menjëherë mirënjohës për distancën tonë nga ai vend mizor dhe mbytës me të burgosurit e tij të varfër, por më pas, pothuajse i çmendur, vjen deklarata e zymtë dhe e frikshme e Platonit: “Ata janë si ne dhe ky është imazhi ynë.”

Pikërisht nga kjo pikë, Daniel De Nicola, profesor i filozofisë në Kolejin Gettysburg në Pensilvani, vazhdon në librin e tij të botuar nga Massachusetts Institute of Technology Press: “*Të kuptuarit e injorancës: Ndikimi tronditës i asaj që mund të mos dimë*”, në një udhëtim për të zbuluar përmasat e detit të injorancës dhe për të vërtetuar se ai është larg nga një mungesë e thjeshtë njohurie.

Ky libër vjen në një kohë të historisë botërore, të njohur si epoka e informacionit, kur njohuritë e një natyre elitare nuk janë më përtej mundësive të shumicës, pasi ajo ka mbetur për mijëra vjet të mos jetë mjaftueshëm i ditur, për të mos përmendur përhapjen e

njohurive të pasakta, besimet e rreme, verbërinë vullnetare dhe lajmet e rreme.

Qëllimi i De Nicola këtu duket se shkon përtej paraqitjes së një diskutimi filozofik të epistemologjisë (shkencës së dijes), pasi ai këmbëngul, të paktën në shumicën e rasteve, të mbajë debatin afër përvojës së lexuesit jo të specializuar, duke shpërngulur kështu të zakonshmen.

INJORANCA

Injoranca mund të përshkruhet si e afërt me një vend/kohë në të cilën jetojmë Shpella e Platonit, ku injorantët nuk e kuptojnë injorancën e tyre dhe mbështeten në të qenët të mësuar me të, duke armiqësor ndaj kujtdo që mund të përpiket të tërheqë vëmendjen e tyre për ndonjë gjë.

Ndryshe, dhe ata e konsiderojnë atë një heretik ose viktimë të një teorie konspiracioni kundër tyre, në krahasim me Parajsën e Dantes, për shembull, e kundërta e ferrit, ku injoranca është një gjendje lumturie e mbështjellë nga mungesa e vetëdijes.

Injoranca nuk është thjesht një shpellë e errët, por një gjendje e rëndë dhe një sprovë e plotë që Platoni e konsideroi më keq se burgu.


Injoranca mund të imagjinohet gjithashtu si një kufi ndarës që ndalon zgjerimin e njohurive tona, qoftë individuale apo kolektive, por hapësira jashtë atyre kufijve është e madhe dhe plot premtime, dhe vetë kufijtë nuk janë përfundimtarë dhe gjithmonë mund të zhvendosen përmes mësimit. Nëse një person lexon një libër çdo ditë të jetës së tij, do të ishte akoma më pak se numri i përgjithshëm i librave të botuar çdo vit vetëm në Shtetet e Bashkuara.

Injoranca mund të kuptohet edhe si një digë që e ndërtojmë me zgjedhje kur zgjedhim të mos dimë diçka, sepse besojmë se nuk ia vlen kostoja e dijes, ose sepse nuk përputhet me siguritë tona ideologjike, ose me motivimet tona të thella psikologjike.

PËRFUNDIM

Së fundi, këto vende/situata ku ne shkojmë, kufijtë me të cilët qëndrojmë dhe digat që zgjedhim të ngremë, krijojnë atë që mund të konsiderohet një horizont dhe drejtim për afrimin e njeriut dhe shoqërisë si dhe marrëdhëniet e tij me botën.

Ndërsa sqaron format e injorancës, De Nicola rishikon një sërë manifestimesh të saj në shoqëritë tona bashkëkohore dhe gjithashtu ngre kontradikta morale që lidhen me të, ndërsa abstragimi i injorancës trajtohet si një gjë e tmerrshme që duhet eliminuar. Ai gjithashtu beson se ndërtimi i besimit, ndonjëherë kërkon pranimin e një shkalle të caktuar të injorancës, dhe më pas...



Ai sugjeron metodologji të mundshme për menaxhimin e injorancës sonë, përmes kuriozitetit, kërkimit të dijes, arsimit të detyrueshëm dhe përdorimit të statistikave dhe probabilitetit, si dhe rregullimin e marrëdhënieve shoqërore përmes premtimeve, kontratat, marrëveshjet dhe detyrimet e ndërsjella.

Ndoshta gjëja më e vlefshme me të cilën përfundon De Nicola në këtë përpjekje për të kapur injorancën është paralajmërimi i tij kundër humbjes në nivelet individuale dhe kolektive të natyrshme në kulturën shoqërore, në të cilën injoranca bëhet një komponent i orientimit ideologjik, dhe më pas pretendimi i tij se “*pranimi dhe mundësia e injorancës sonë, ku mund të mos i kuptojmë kufijtë e të kuptuarit tonë, është vetëm dera e Urtësisë që të çon në një fushë njohurie që na lejon të braktisim njohuritë e rreme dhe të zvogëlojmë shtrirjen e injorancës sonë kokëfortë në ndjekjen e dijes. Edhe nëse ka lodhje dhe dhimbje që shoqëron procesin e të mësuarit.*”

<https://aawsat.com/>

Përktheu: Mr. Vehbi Shatri

Autori Daniel De Nicola

Lidhmëria ndërmjet shkencës dhe fesë islame

Mr. Njomza Sadriu

Lidhshmëria ndërmjet fesë dhe shkencës është temë e debatit të vazhdueshëm në filozofi dhe teologji. Deri në çfarë mase përputhen feja dhe shkenca? A janë besimet fetare ndonjëherë të favorshme për shkencën, apo ato në mënyrë të pashmangshme paraqesin pengesa për kërkimin shkencor? Fusha ndërdisiplinore e “shkencës dhe fesë”, e quajtur edhe “teologji dhe shkencë”, synon t’iu përgjigjet këtyre dhe pyetjeve të tjera. Ajo studion ndërveprimet historike dhe bashkëkohore midis këtyre fushave dhe ofron analiza filozofike se si ato ndërlidhen. Për ta kuptuar shtrirjen e shkencës dhe fesë dhe ndërveprimet e tyre, duhet të paktën të kemi një kuptim të përafërt të asaj që është shkenca dhe feja.

Në fund të fundit, “shkenca” dhe “feja” nuk janë terma përjetësisht të pandryshueshëm me kuptime të paqarta. Në të vërtetë, ato janë terma që u krijuan kohët e fundit, me kuptime që ndryshojnë në kontekste. Para shekullit të nëntëmbëdhjetë, termi “fe” përdorej rrallë. Për një autor mesjetar si Aquinas, termi “religio” nënkuptonte devotshmëri ose adhurim dhe nuk u zbatua në sistemet fetare jashtë asaj që ai e konsideronte ortodoksinë (Harrison 2015).

Termi “fe” mori kuptimin e tij aktual dukshëm më të gjerë përmes veprave të antropologëve të hershëm, si E.B. Tylor (1871), i cili përdori sistematikisht termin për fetë në mbarë botën. Si rezultat, “feja” u bë një koncept krahasues, duke iu referuar tipareve që mund të krahasoheshin dhe studioheshin shkencërisht, të tilla si ritualet, kufizimet dietike dhe sistemet e besimit (Jonathan Smith 1998).

Një mënyrë për të bërë dallimin midis shkencës dhe fesë është pretendimi se shkenca ka të bëjë me botën natyrore, ndërsa feja ka të bëjë me botën e mbinatyrshme dhe marrëdhënien e saj me natyroren. Karakteristika përcaktuese e Islamit është besimi në një Zot (Allah).

Pranë Kuranit, një burim i rëndësishëm i jurisprudencës dhe teologjisë është hadithi, një korpus gojor i thënieve, veprimeve dhe miratimeve të heshtura të profetit Muhamed a.s..

Pikëpamjet kryesore të besimit përfshijnë njëshmërinë e Zotit (tevhid), pikëpamjen se ka vetëm një Zot që krijoi dhe

mbështet universin, shpalljen profetike (në veçanti profetit Muhamed a.s.) dhe një jetë të përtëjme.

Shpallja hyjnore e sheh marrëdhënien e fesë me shkencën si marrëdhënie të dyanshme. Feja që e ka burimin të shpallja hyjnore, është udhë ndriçuese për njohjen e Zotit, kurse dijet shkencore argumentojnë se jeta dhe i gjithë universi ka një shpikës, Krijues fillestar, super inteligjent, me dituri të pakufizuara që njihet me emrin Zot.

Pra, feja islame e konsideron shkencën si mjetin real për të kuptuar më mirë udhëzimet e shpalljes hyjnore, nga ku e merr burimin feja. Duke e parë në këtë këndvështrim, këto të dyja duhet të jenë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën, por jo gjithmonë ndodh kështu, si në rastin e teorisë së evolucionit nga Çarls Darwin, apo teoritë e disa filozofëve të shekujve XIX-XX, që mbështeten në filozofinë materialiste. Por, ka dhe shkencëtarë të tjerë, që mbështeten në origjinën hyjnore të jetës.

Kur njeriu beson te Zoti, motivi për jetën është i qartë dhe pozitiv. Ai ndikon tërësisht në shëndetin mendor dhe fizik të tij. Kjo do të thotë se sjellja e njeriut që e ka mbushur ndërgjegjen e tij me besimin te Zoti, është shumë e mirë në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Kjo për faktin se ai, në ndërgjegjen e vet frenon çdo pasion negativ, duke treguar një moral të lartë të besimit të tij, të frymëzuar nga shpallja hyjnore. Energjitë që jep besimi në Zotin, e bëjnë trupin e tij të shëndetshëm fizikisht dhe psikologjikisht, duke i siguruar qëllimin bazë të mobilizuar, për të cilin ai u krijua.

Asnjë njeri që niset nga motive të pandershme në jetë dhe që për t’i ndërtuar ato bën veprime që janë të ndaluara nga ligjet e shpalljes hyjnore dhe nga ato të shtetit në të cilin jeton, nuk do të triumfojë. Përkundrazi, këto motive do të bëhen faktorë për shkatërrimin e tij si njeri. Prandaj duhen edukuar brezat e rinj me ndjenjën e besimit, që i përgatit të gjitha dëshirat për jetën në drejtimin pozitiv dhe jo negativ. Besimi forcon dinjitetin dhe vendosmërinë për të përballuar çdo pengesë që iu del njerëzve përpara dhe gjatë rrjedhës së jetës.

Marrëdhënia ndërmjet vendeve islame dhe shkencës është komplekse. Sot, vendet kryesisht myslimane, si Emiratet e Bashkuara Arabe, gëzojnë urbanizim dhe zhvillim të lartë teknologjik, por ato ende nuk kanë performancë të mirë në

metrikat e zakonshme të kërkimit shkencor, siç janë botimet në revista kryesore dhe numri i citimeve për shkencëtar, krahasuar me rajonet e tjera jashtë perëndimit si India dhe Kina (shih Edis 2007).

Kjo mungesë bashkëkohore e rëndësisë shkencore është e jashtëzakonshme, duke pasur parasysh se bota islame i ka tejkaluar shumë kulturat evropiane në gamën dhe cilësinë e njohurive të saj shkencore, përfshirë midis shekullit të nëntë dhe të pesëmbëdhjetë, duke shkëlqyer në fusha të tilla si matematika (algjebra dhe gjeometria, trigonometria në veçanti), astronomi (duke konsideruar seriozisht, por jo duke adoptuar, heliocentrizmin), optikën dhe mjekësinë.

Këto fusha të dijes zakonisht quhen “shkenca arabe”, për t’i dalluar ato nga kërkimet e shkencës që u ngritën në perëndim (Huff 2003). “Shkenca arabe” është një term i papërsosur, pasi shumë nga praktikuesit nuk folën gjuhën arabe, prandaj termi “shkencë në botën islame” është më i saktë.

Shumë shkencëtarë në botën islame ishin polimates, për shembull, **Ibën Sina (Avicena, 980–1037)**, konsiderohet zakonisht si një nga novatorët më të rëndësishëm, jo vetëm në filozofi, por edhe në mjekësi dhe astronomi. Kanuni i tij i mjekësisë, një enciklopedi mjekësore, ishte një libër shkollor standard në universitetet anembanë Evropës për shumë shekuj pas vdekjes së tij.

El Farabiu (rreth 872–rreth 950), një filozof politik nga Damasku, hetoi gjithashtu teorinë e muzikës, shkencën dhe matematikën.

Omer Khajjami (1048–1131) arriti famë të qëndrueshme në fusha të ndryshme si poezia, astronomia, gjeografia dhe mineralogjia.

Andaluziani **Ibën Rushdu (Averroes, 1126–1198)** shkroi mbi mjekësinë, fizikën, astronominë, psikologjinë, jurisprudencën, muzikën dhe gjeografinë, krahas zhvillimit të një teologjie filozofike të frymëzuar nga Greqia.

Një shtysë e madhe për shkencën në botën islame ishte patronazhi i kalifatit abasid (758–1258), me qendër në Bagdad.

Sunduesit e hershëm abasid, si **Harun Rashidi (sundoi 786–809)** dhe pasardhësi i tij Ebu Xhafer Abdullah el Mamuni (sundoi 813–833), ishin mbrojtës të rëndësishëm të shkencës.

I pari themeloi **Bejt el Hikme (Shtëpia e Urtësisë)**, e cila porositi përkthimet e veprave kryesore nga Aristoteli, Galeni dhe shumë studiues persianë dhe indianë në arabisht.

Ai ishte kozmopolit në pikëpamjen e tij, duke punësuar astronomë, matematikanë dhe mjekë nga jashtë, duke përfshirë matematikanët indianë dhe astronomët nestorianë (të krishterë).

Feja islame e konsideron shkencën si mjetin real për të kuptuar më mirë udhëzimet e shpalljes hyjnore.

Në të gjithë botën islame, bibliotekat publike të lidhura me xhamitë siguruan akses në një përmbledhje të gjerë njohurish, e cila përhapi Islamit dhe shkencën. Përdorimi i një gjuhe të përbashkët (arabe), si dhe i institucioneve të përbashkëta fetare dhe politike dhe marrëdhëniet e lulëzuara tregtare inkurajuan përhapjen e ideve shkencore në mbarë botën islame. Rënia e kalifatit abasid i dha një goditje shkencës në botën islame, por mbetet e paqartë pse ajo përfundimisht ngeci dhe pse nuk përjetoi diçka të ngjashme me revolucionin shkencor në Evropën Perëndimore.

Në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, ndërsa shkenca dhe teknologjia u rrënjosën fort në shoqërinë perëndimore, perandoritë myslimane po shuheshin ose kolonizoheshin. Idetë shkencore, të tilla si teoria evolucionare, u barazuan me kolonia-

lizmin evropian, dhe kështu hasën në mosbesim.

Lidhja e qëndrueshme midis kulturës perëndimore, kolonializmit dhe shkencës çoi në një pikëpamje konfliktuale më të spikatur të marrëdhënies midis shkencës dhe fesë në vendet myslimane.

Referencat:

- Al-Ghazālī, 11th century, *Tahāfut al-falāsīfā*, translated by Sabih Ahmad Kamali as *The Incoherence of the Philosophers*, Lahore: Pakistan Philosophical Congress, 1963.
- Allport, Gordon W. and J. Michael Ross, 1967, “Personal Religious Orientation and Prejudice.”, *Journal of Personality and Social Psychology*, 5(4): 432–443. doi:10.1037/h0021212
- Alston, William P., 1989, “God’s Action in the World”, in *Divine Nature and Human Language: Essays in Philosophical Theology*, Ithaca, NY: Cornell University Press, 197–222.
- Augustine, 416 [2002], *De Genesi ad litteram*, Translated as “The Literal Meaning of Genesis” in *On Genesis*, John E. Rotelle (ed.), Edmund Hill (trans.), (The works of Saint Augustine: A Translation for the 21st Century), Brooklyn, NY: New City Press, 2002, pp. 155–506.
- Aurobindo Ghose, 1914–19 [2005], *The Life Divine*, Pondicherry: Sri Aurobindo Ashram Press. Collection of essays initially published from 1914–19 and first revised and published as collection in 1939/1940, two volumes.
- Barbour, Ian G., 1966, *Issues in Science and Religion*, New York: Vantage.
- Dhanani, Alnoor, 2002, “Islam”, in *Science and Religion: A Historical Introduction*, Gary B. Fongren (ed.), Baltimore and London: Johns Hopkins University Press, pp. 73–92.
- Draper, John, 1874, *History of the Conflict between Religion and Science*, New York: Appleton
- Edis, Taner, 2007, *An Illusion of Harmony: Science and Religion in Islam*, Amherst, NY: Prometheus Books.
- Griffel, Frank, 2009, *Al-Ghazali’s Philosophical Theology*, Oxford/ New York: Oxford University Press. doi:10.1093/acprof:oso/9780195331622.001.0001
- Guessoum, Nidhal, 2011, *Islam’s Quantum Question: Reconciling Muslim Tradition and Modern Science*, London and New York: Tauris.
- Hameed, Salman, 2008, “Bracing for Islamic Creationism”, *Science*, 322(5908): 1637–1638. doi:10.1126/science.1163672
- Balla, Xhemal, 2021. “Marrëdhënia e Fesë me shkencën”, *Univers* 22 (2):119-27.
- Religion and Science (Stanford Encyclopedia of Philosophy)

18 Dhjetori – Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Arabe

Shkëlzen Hoxha

Gjuha arabe është pjesë e rëndësishme të llojllojshmërisë kulturore të njerëzimit. Ajo është një nga gjuhët më të përhapura dhe më të përdorura në botë, pasi flitet çdo ditë nga më shumë se 400 milionë njerëz në planet. Arabëfolësit janë të shpërndarë në rajonin arab, respektivisht në 22 vende arabe në Azi e Afrikë, dhe në disa rajone të tjera fqinje, si Turqia, Çadi, Mali, Senegali e Eritrea.¹

Për myslimanët, arabishtja ka një rëndësi të veçantë, pasi është gjuha e Kuranit, dhe namazi (rituali bazë në Islam) nuk mund të kryhet pa cituar disa nga fjalët universale të kësaj gjuhe. Gjuha arabe ka krijuar një format unikat dhe stile të saj të ndryshme, qofshin ato gojore apo të shkruara, qofshin ato prozë a poezi, vargje të mrekullueshme që magjepsin zemrat e mahnitin mendjet e tërë atyre që njohin këtë gjuhë.

Arabishtja mbizotëroi për shumë shekuj të historisë së saj si gjuhë e religjionit, politikës, shkencës dhe letërsisë dhe ndikoi drejtpërdrejt ose indirekt në shumë gjuhë të tjera në botën islame, si në gjuhën: turke, perse, kurde, urdu, malaje, shqipe dhe disa gjuhë të tjera afrikane si hausa dhe suahili, si dhe te disa gjuhë evropiane, veçanërisht ato mesdhetare, si spanjolle, portugeze, malteze dhe atë siciliane.

Kjo gjuhë përfaqësoi një nxitje për avancimin dhe përhapjen e njohurive dhe ndihmoi në transferimin e njohurive shkencore dhe filozofike greke, romake dhe persiane në periudhën e renesancës.

Nga artikuj të ndryshëm shkencorë në lidhje me kontaktin e gjuhës arabe me gjuhët e tjera, kuptohet se ndikimi i saj ishte i dukshëm, e sidomos sa i përket huazimit të fjalëve nga gjuha arabe në gjuhët përkatëse.²

Për më tepër, kjo gjuhë përfaqësoi një nxitje për avancimin dhe përhapjen e njohurive dhe ndihmoi në transferimin e njohurive shkencore dhe filozofike greke, romake dhe persiane në periudhën e renesancës. Dijetarët përkthyen vepra të filozofisë, mjekësisë, matematikës dhe astronomisë në arabisht, duke e pasuruar gjuhën me terma dhe koncepte të reja, shembull kemi rastin e El Kindit, i cili përktheu vepra të Platonit dhe Aristotelit.³

Përveç përkthimit, njohuritë u shtuan, por edhe u klasifikuan ashtu siç nuk ishte bërë më parë. Vlen të përmendet si rast i tillë dallimi i hershëm ndërmjet mjekësisë dhe farmacisë nga El Biruni në shekullin VII, i cili tha se farmacia u bë e pavarur nga mjekësia, ashtu siç janë të ndara gjuha dhe sintaksa nga kompozimi.⁴

Arabishtja u bë gjuha e administratës dhe qeverisjes në shumë rajone nën sundimin islam, duke fituar statusin zyrtar në një sërë vendesh.⁵ Futja e arabishtes si gjuhë tregtie lehtësoi lidhjet ekonomike midis kulturave të ndryshme, duke nxitur ndjeshëm zhvillimin



e tregtisë. Arabishtja u përhap teksa tregtarët dhe dijetarët myslimanë udhëtonin përgjatë rrugëve tokësore e detare, përmes “Rrugës së Mëndafshit”, duke ndihmuar në përhapjen e gjuhës arabe në rajone të ndryshme dhe gjithashtu duke lejuar vendosjen e dialogut midis kulturave.⁶

Gjuha arabe lirisht mund të konsiderohet si një urë lidhëse në mes njohurive paraprake dhe shkencës moderne. Orientalistët e epokës bashkëkohore konfirmojnë se reprezentimi i filozofive aristoteliane në Evropë gjatë periudhave mesjetare dhe të Rilindjes për sa i përket zhvillimit shkencor dhe letrar, u mbështet kryesisht në përkthimet nga arabishtja në latinisht si burimi i tyre kryesor.⁷

Në kontekstin e mbështetjes dhe promovimit të shumëgjuhësisë dhe multikulturalizmit në Kombet e Bashkuara, Departamenti i Komunikimeve Globale i Kombeve të Bashkuara – i njohur më parë si Departamenti i Informacionit Publik – miratoi një rezolutë në prag të kremtimit të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare për të festuar secilën prej gjashtë gjuhëve zyrtare të Kombeve të Bashkuara. Prandaj, u vendos që të festohej gjuha arabe më 18 dhjetor, pasi ishte dita në të cilën Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 3190 (XXVIII) e 18 dhjetorit 1973, u lëshua për të përfshirë gjuhën arabe midis gjuhëve zyrtare dhe të punës te Kombet e Bashkuara.

Në rrafshin kombëtar, kjo gjuhë është prezente në kulturën e popullit tonë me shekuj, që nga kalimi i një pjese të popullit tonë në fenë islame rreth shekullit XIII. Këtë e dëshmon fakti se në vitin kur u ndërtua xhamia e parë në këto hapësira, në vitin 1396 – në Kërçovë, kemi edhe institucionin e

jurisprudencës islame – kadiun në Jeni Pazar, si një instrument përcjellës i zbatimit të bazave islame.⁸

Kurse sot, gjuha arabe ligjërohet në tri institucione arsimore: në Shkollën e Mesme të Lartë “Medreseja Alauddin” që nga viti 1951; në Universitetin “Hasan Prishtina”, Fakultetin e Filologjisë, Departamentin e Orientalistikës, që nga viti 1973; dhe në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, që nga viti 1992.

Qëllimi i shënimit të kësaj dite është të rrisë ndërgjegjësimin për historinë, kulturën dhe zhvillimin e gjuhës. Rrjedhimisht ndërgjegjësimin mbi gjuhën arabe si një shtyllë e zhvillimit shkencor, letrar dhe filozofik, duke vulosur dhe vetë përparimin njerëzor dhe shoqëror përgjatë historisë.

Gjithashtu shënimi i kësaj dite me program aktivitetesh dhe ngjarjesh të veçanta, tërheq vëmendjen, nxit reflektim dhe kremton vlerën e kësaj gjuhe, e cila edhe sot ka rol të rëndësishëm në nivel botëror.

Shënimi i kësaj dite me program aktivitetesh dhe ngjarjesh të veçanta, tërheq vëmendjen, nxit reflektim dhe kremton vlerën e kësaj gjuhe, e cila edhe sot ka rol të rëndësishëm në nivel botëror.

- 1 <https://www.un.org/ar/observances/arabiclanguageday>
- 2 <https://public.websites.umich.edu/~thomason/temp/arabic.pdf>
- 3 <https://www.openculture.com/2017/06/how-arabic-translators-helped-preserve-greek-philosophy-and-the-classical-tradition.html>
- 4 <https://www.scienceopen.com/document/file/849d77ba-6c48-4bde-a072-69704bc93e19/PubMedCentral/849d77ba-6c48-4bde-a072-69704bc93e19.pdf>
- 5 <https://library.fiveable.me/key-terms/the-ancient-mediterranean-world/spread-of-arabic-language>
- 6 <https://en.unesco.org/silkroad/content/did-you-know-evolution-arabic-language-silk-roads>
- 7 https://www.researchgate.net/publication/333516912_Arabic_Literature's_influence_on_Renaissance_Europe_Beyond_Bias_Bertolacci,_A_2011
- 8 <https://orientalizmi.wordpress.com/2020/03/02/gjashte-shekuj-islam-institucional-ne-ballkan/>

Perceptimet e nxënësve të medreseve të Kosovës për gjuhën turke

Dr. Selim Selimi

Sipas raporteve të UNESCO-s, interesimi i treguar ndaj një Turqie, e cila po zhvillohet mjaft shpejt, e bashkë me të është rritur edhe ndikimi i saj në rajon, ka sjellë njëkohësisht edhe shtimin e interesimit ndaj gjuhës turke.

HYRJE

Gjuha padyshim është një mjet jetik për njerëzimin. Jo vetëm se është një mjet për të komunikuar mendimet, ndjenjat dhe idetë, por nëpërmjet komunikimit lidhen miqësitë, kulturat, marrëdhëniet ekonomike e sociale. Po ashtu, gjuha është një mjet i domosdoshëm i arsimit, aftësimit, kulturës dhe shkencës, pasi është një nga mjetet më të rëndësishme që sigurojnë marrëveshje midis njerëzve.

Gjatë gjithë historisë, shumë dijetarë kanë reflektuar mbi rëndësinë e gjuhës. Gjuhëtari Edward Sapir, ka thënë se gjuha nuk është vetëm një mjet për shprehjen e mendimeve, perceptimeve, ndjenjave dhe vlerave karakteristike të një komuniteti, mirëpo, ajo gjithashtu paraqet një shprehje themelore të identitetit shoqëror. Perceptimi i çdo njeriu për gjuhën është individual.

Turqishtja është një gjuhë shumë kup-timplote. Megjithatë, fakti që nuk është nga e njëjta familje gjuhësh si disa gjuhë të njohura në botë (angleze, frënge, gjermane) sjellë ndoshta pak probleme të mësuarit e saj. Një nga vështirësitë më të mëdha që haset në mësimin e turqishtes si gjuhë e huaj është se i përket familjes së gjuhëve ural-altaike, është gjuhë prapashtesore, ku vështirësi mund të haset në radhitjen e fjalëve në fjali, në krahasim me gjuhët indo-evropiane. Po e njëjta vështirësi shfaqet edhe për shqipfolësit. Në fakt, gjuha turke është e lehtë për të mësuar.

Studimi ynë synon të mësojë dhe të përshkruajë perceptimet për gjuhën turke të

nxënësve të medreseve, si dhe të studentëve të huaj që shkojnë nëpër institucionet e arsimit të lartë për të mësuar gjuhën turke. Nga ky këndvështrim, në këtë studim, grupi mësimor i nxënësve, i përgatitur për të mësuar turqishten si gjuhë të huaj në medresetë në përgjithësi, kurse në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë dhe paralelet e ndara fizike në Prizren dhe Gjilan në veçanti është përkufizuar. Përveç kësaj është përmendur edhe Instituti “Yunus Emre” qendrat kulturore turke dhe shumë departamente të turkologjisë, që shërbejnë jashtë shtetit turk për të mësuarit e gjuhës turke.

Vitet e fundit, Turqia ka avancuar, ka filluar të marrë një pjesë më të madhe në Tregun Ndërkombëtar Studentor Botëror. Përveç kësaj, ajo ka bërë një përpjekje për të krijuar një treg të ri, duke aktivizuar dinamikat historike, gjeopolitike dhe ekonomike në sferën e saj të ndikimit.

Në ditët e sotme, fusha e ndikimit të gjuhës turke është duke u zgjeruar sa vjen e më shumë. Sipas raporteve të UNESCO-s, interesimi i treguar ndaj një Turqie, e cila po zhvillohet mjaft shpejt, e bashkë me të është rritur edhe ndikimi i saj në rajon, ka sjellë njëkohësisht edhe shtimin e interesimit ndaj gjuhës turke. Turqishtja ka arritur vendin e pestë ndër gjuhët e botës. Kjo gjuhë flitet në një hapësirë gjeografike prej më se 12 milionë kilometrash katrorë, prej një popullsie e cila arrin numrin e 220 milionë njerëzve, duke u kthyer në një gjuhë, mësimdhënia e së cilës ka hyrë në shkollat e shumë shteteve. Gjuha

turke, falë mjeteve të telekomunikacionit, si interneti, televizioni, apo institucioneve që ofrojnë mësimdhënie të saj në programet e tyre mësimore, është kthyer në një gjuhë e cila dëgjohet sot në të katër anët e Kosovës, Shqipërisë, në shtetet e Ballkanit, si dhe përdoret në një hapësirë mjaft të gjerë gjeografike. Hapja e shkollave turke në Kosovë në vitin 1951 për komunitetin turk, që jetojnë në qytete dhe fshatra të Kosovës si në: Prishtinë, Prizren, Mamushë, Mitrovicë, Vushtrri, Gjiilan dhe Dobërran,² pastaj hapja e Departamentit të Orientalistikës (1974), Gjuhës dhe Letërsisë turke (1988), Fakulteti i Studimeve Islame (1992) në universitete të vendit, si dhe mësimi i lëndës gjuhë turke në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë dhe paralelet e ndara në Prizren e Gjiilan, janë vetëm disa prej institucioneve shkollore që ofrojnë mësimdhënie në gjuhën turke ose të gjuhës turke. Si pasojë e lidhjeve të ngushta historike që ekzistojnë mes dy popujve, atij shqiptar dhe atij turk, kjo paraqet një qasje të ndërsjellë dashurie dhe respekti.

TURQISHTJA SI GJUHË E HUAJ NË KOSOVË

Njohja e shqiptarëve me turqit i takon kohëve përpara osmanëve. Kështu filloi lidhja e shqiptarëve që njohin turqit me gjuhën turke që në epokën e Hunëve.³ Mirëpo, fakti që populli shqiptar dhe ai turk kanë ndarë të njëjtën histori, duke bashkëjetuar për shekuj me radhë, ka pasur ndikim në shumë fusha, si gjuha, kultura dhe feja. Një nga fushat ku dallohet më shumë ky ndikim është gjuha.⁴ Të qenët e turqishtes gjuhë zyrtare e shtetit osman i ka hapur rrugë edhe mësimin të turqishtes nga shqiptarët, si dhe ndikimit të turqishtes te shqipja. Ky ndikim që fitoi hov me zgjedhjen e Islamit nga shqiptarët e tregon veten në shumë fusha, nga feja tek arti, nga letërsia te shkenca e kultura. Shqipja e ndikuar nga turqishtja ka marrë prej saj më së shumti fjalë,

shprehje, fjalë të urta, grupe fjalësh dhe prapashtesa.⁵ Studimet e fundit tregojnë se numri i fjalëve turke në gjuhën shqipe është rreth 5.000.⁶

TURQISHTJA NË KOSOVËS GJATË REGJIMIT KOMUNIST

Së bashku me ndalimet që solli regjimi komunist në Kosovë pas vitit 1945, brenda kuadrit të një qasjeje paragjyquese ndaj Perandorisë Osmane, edhe gjuha turke u ndikua negativisht. Me ardhjen e regjimit komunist në pushtet, fjalët turke filluan të nxirreshin nga gjuha shqipe ose të mbeteshin jashtë përdorimit.⁷ Kurse në të folmet e popullit shqiptar në Kosovë vazhdon të mbeten edhe shumë fjalë me prejardhje turke. Medresetë që ishte hapur në vitin 1951 ishin në varësi të Kryesisë së Bashkësisë së Fesë Islame, e emëruar “Medreseja e Ulët Shqiptare të Prishtinës”. Deri në vitin 1962, këto medrese zhvillonin mësimin në gjuhën shqipe, kurse arabishten dhe turqishten e mësonin si gjuhë të huaja. Ndërsa pas vitit 1962, tani medreseja me emrin e ri “Medreseja e Mesme Alauddin në Prishtinë” deri në vitin 1990, zhvilloi vetëm lëndët arabisht, serbisht dhe anglisht si gjuhë të huaja. Në vitin 1990, me ndryshimet e bëra në planprogram si gjuhë e huaj në medrese prapë filloi të mësohej gjuha turke, ku edhe tani mësohet. Në anën tjetër, prej vitit akademik 1962/63, në kuadër të Shkollës Lartë Pedagogjike, në Prizren, hapet dega Gjuhë dhe Letërsi Turke dy vjeçare. Në vitin 1973, në kuadër të Universitetit të Prishtinës, hapet dega e Orientalistikës. Më vonë, në vitin akademik 1988-1989, në kuadër të Universitetit të Prishtinës është hapur edhe dega e Turkologjisë. Një pjesë e rëndësishme e turkologëve janë personalitete që kanë themeluar këto departamente ose kanë studiuar në këto fakultete.

TURQISHTJA NË KOSOVË PAS PERIUdhës Së KOMUNIZMIT

Në periudhën e komunizmit, nga viti 1962 deri në 1990, shumë pak shqiptarë mund të mësonin turqisht. Është me rëndësi të theksohet se as gjatë këtyre viteve në Medresenë “Alauddin” nuk mësohej turqishtja si gjuhë e huaj. Mirëpo ajo turqishte, që një kohë të gjatë flitej nëpër disa qytetet (Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Vushtrri, Gjiilan etj.) edhe nga vetë shqiptarët perceptohej si “gjuhë e qytetarëve (kasabali) të kulturës” për dallim nga vendet rurale, ku tanimë kjo gjuhë kishte humbur atë peshë që kishte dikur. Ndërsa në vitin akademik 1992/93, me hapjen e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, në programin e



studimeve është paraparë edhe gjuha turke si lëndë studimore gjuhë e huaj. Në këtë kohë, hapja e drejtorisë së “TIKA”-s (Agjencia e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Turk) (2002) dhe fillimi i punës së disa firmave turke në Kosovë, bënë që të përshpejtohej mësimi i turqishtes. Pas luftës së fundit në Kosovë (1988/89), e në veçanti pas shpalljes së Pavarësisë Kosovës (2008), përzgjedhja e nxënësve të Medresesë dhe nxënësve të tjerë për të vijuar studimet në Turqi, bëri që të shtohet interesimi i tyre për turqishten. Hapjen e Qendrave Kulturore “Junus Emre” në Prishtinë (2014), më vonë në Prizren dhe Pejë. Instituti “Yunus Emre” në Prishtinë, krahas mësimi të gjuhës turke, kryen edhe aktivitete të tjera kulturore artistike, si dhe ofron mbështetje në aktivitete të ndryshme shkencore. Po në vitin 2017/18, hapja e shkollës “Marif Shcol” shkollë e mesme në Prishtinë dhe Prizren, parashihte në planprogramet e saj edhe mësimin e gjuhës turke si gjuhë e huaj.

Në shtetet e Ballkanit, e sidomos në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Kosovë, në disa televizione kombëtare, lokale dhe platforma të tjera televizive shfaqen seriale të ndryshme dhe filma të kinematografisë turke, duke krijuar një ndikim kulturor dhe në aspekte të tjera në jetën e njerëzve. Në Kosovë këto seriale transmetohen me titra në gjuhën shqipe dhe në këtë mënyrë rritet edhe interesimi i njohjes së gjuhës dhe kulturës turke.

TURQISHTJA SI GJUHË E HUAJ NË MEDRESENË “ALAUDDIN”

Mësimi i gjuhës turke si gjuhë e huaj ka fituar rëndësi të madhe vitet e fundit. Mësimi i gjuhës turke për të huajt në përgjithësi zhvillohet në tri nivele si niveli bazë, i mesëm dhe i lartë. I njëjti klasifikim është bërë në Tekstin e Aplikimit të Përbashkët Evropian për Gjuhët, i cili është zhvilluar për të siguruar që sistemet e mësimi të gjuhëve në botë të kombinojnë aftësitë gjuhësore dhe që individët mund të

përdorin gjuhën që mësojnë në komunikim. Në tekste, përfshihen arritjet e aftësive bazë të gjuhës (leximi, të folurit, shkrimi, dëgjimi) në çdo nivel. Tri nivele kryesore të kompetencës, A (bazë), B (e mesme) dhe C (e sipërme) janë përcaktuar për të siguruar një pikë referimi të përbashkët në të gjithë Evropën.

Në fjalorin e Tahir Dizdarit “Fjalor i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe” për fjalën medrese jep këtë shpjegim: “medrese- ja: ... institut i naltë institucioni në kohën e vet për nxënës klerikë nga ku delshin hoxhallarët myderisa, seminar, kolegji, arabisht madrasa nga darasa “me studiju” turqisht medrese. Drejtoreshin nga myderizët që kishin si ndihmësa hoxhallarë që kryeshin punën e rektorëve. Ndër këta institucione jepeshin mësim në lëndë të gramatikës, sintaksës, logjikë, etikë, shkencë e alegorivet, teologji, filozofi, jurisprudence islamike, Kurani, dhe komenti i Tij (ilm-i tefsir) dhe ligjet gojore ose tradicionet e profetit (ilm-i hadith). Me këta mësim kur ishin arrit shkallën e prefeksionit afirmoheshin për myderiza e predikatarë.”⁸

Me themelimin e medreseve, u hapën horizonte të reja të mësimi të fesë dhe të arsimit në përgjithësi. Këtu qëndron arsyeja që këto institucione të kenë vlerën, peshën dhe rëndësinë e vet historike, si fenomene të shekullit, të cilat kanë zgjuar kërshërinë e shumë studiuesve për të hulumtuar dhe gjurmuar mënyrën e veprimtarisë së tyre dhe sistemin e arsimit në to. Për këtë arsye, medresetë, pa marrë parasysh kohën kur kanë punuar dhe vepruar, kanë rëndësi të shumëfishtë, prandaj me themelimin e tyre, janë krijuar mundësitë e përfshirjes së tyre në strukturat arsimore dhe kulturore të mjedisit shoqëror ku kanë vepruar⁹ dhe veprojnë tani. Aktiviteti i medreseve në përgjithësi kishte karakter fetar edukativ-arsimor, ku përgatiten kuadro për nëpunës fetar si imam, vaiz, mualim, myezin etj..¹⁰



Medreseja “Alauddin” në Prishtinë – Medreseja “Alauddin” e Prishtinës është institucion edukativ-arsimor i ciklit të mesëm shkollor, që ka për qëllim arsimimin dhe edukimin e të rinjve/të rejave për Islamit dhe fusha të tjera të dijes. Medreseja filloi punën në vitin shkollor 1951-1952. Në pasqyrën e gjendjes së planprogramit, gjuha turke mësohej në tri lëndë: gramatikë turke, imla turqisht, dhe kiraet turqisht.¹¹

Medreseja e Prizrenit – Medreseja aktuale në Prizren është paralele e ndarë fizike e “Medresesë Alauddin” në Prishtinë. Ajo përbëhet nga dy paralele, ajo për meshkuj dhe për femra. Me vendim të BIK-ut nga mbledhja e mbajtur në qershor të vitit 1993, u mor vendim për hapjen e paraleles së ndarë fizike të medresesë së mesme “Alauddin” në Prizren për meshkuj në vitin shkollor (94/1993). Krahës diplomimit të gjeneratës së parë të meshkujve në Prizren, Kuvendi i BIK-ut mori edhe një vendim të rëndësishëm, ajo ishte hapja e paraleles së Medresesë për femra në Prishtinë dhe në Prizren. Kjo doli në qershor të vitit 1997. Tani e tutje u kompletuan paralelet e meshkujve dhe të vajzave.

Medreseja e Gjilanit – Medreseja e Gjilanit si paralele e ndarë fizike filloi vitin e ri shkollor 1994-95 për djem dhe në vitin shkollor 2018-19 edhe me paralelen e vajzave. Sa u përket perceptimit të nxënësve të Medresesë “Alauddin” me paralelet e ndara për gjuhën turke shihet një interesim i madh viteve të fundit, kjo po reflektohet edhe te nxënësit në suksesin e tyre. Programi mësimor i medreseve përfshinte lëndët fetare dhe grupin e lëndëve humane e shkencore.¹² Tekstet mësimore të cilat shfrytëzoheshin në medresetë kryesisht ishin përgatitur në atë mënyrë që t’u ofrojnë nxënësve myslimanë njohuritë e nevojshme për çështjet fetare në jetën e përditshme. Librat për mësimdhënien e gjuhës turke në Medresenë “Alauddin” janë: “Gjuha Turke” (Fonetik-Morfologji) 1993, Shemsi Rahimi, “Temel Türkçe Ders Kitabı” Selim Selimi (Material i pa botuar), Yedi İklim Türkçe – Ders Kiatabı, seviye A1, Yunus Emre Enstitüsü, 2017.

PËRFUNDIMI

Në fund, mund të themi se medresetë janë hapur dhe funksionojnë për të mirën e popullit, prandaj ato duhet ta kenë një vend të merituar në historinë e shkollave shqipe të arsimimit fetar dhe kombëtar. Medreseja “Alauddin” gjithmonë ka qenë në funksion të ruajtjes së integritetit kombëtar dhe kultivimit të vlerave tradicionale islame.¹³

Cilësinë e jetës së një individi, vendin dhe respektin e tij në shoqëri e përcakton niveli dhe cilësia e arsimit të tij. Çdo prind kërkon që fëmija i tij të bëhet një individ, i cili të bëjë vend në shoqëri, të respektohet, të ketë një standard të lartë jetese dhe të jetojë i lumtur. Dhe këtë, në një përqindje të madhe, e përcakton niveli arsimor i individit, universiteti në të cilin është diplomuar dhe cilësia e arsimit të marrë. Për këtë arsye shumica e të rinjve shqiptarë preferojnë që t’i kryejnë

studimet e tyre të larta jashtë vendit, si për mjekësi, komunikim, menaxhim biznes dhe inxhinieri. Në këto preferenca bën pjesë edhe Turqia. Në degët që zgjidhen në Turqi bëjnë pjesë mjekësia, marrëdhëniet ndërkombëtare, stomatologjia, inxhinieritë, gjuha dhe letërsia turke, teologjia etj.. Një rol të madh për përzgjedhjen e Turqisë nga studentët shqiptarë për studime, luajnë edhe bursat e dhëna për studim. Qindra nxënësve shqiptarë dhe të komuniteteve të tjera në shtetet e Ballkanit u janë dhënë dhe vazhdojnë t’u jepen bursa për studime bachelor, master dhe doktoratë nga shteti turk. Studentët që dinë turqisht i fillojnë studimet e tyre pa bërë një vit përgatitor gjuhë. Për këtë, në Kosovë dhe Shqipëri, është një shkak i mirë mësimi i gjuhës turke. Njohja e gjuhës turke nga studentët ka bërë të mundur të ndjekin studimet e tyre në turqisht pa qenë nevoja për vitin përgatitor të gjuhës. Dhe ky është një shkak i rëndësishëm për mësimin e gjuhës turke nga nxënësit shqiptarë. Nëse niveli i gjuhës turke është i pamjaftueshëm, mësojnë turqisht te TOMER-i (Qendra për Mësim të Gjuhës Turke) derisa arrijnë nivelin e duhur të saj.¹⁴ Nga viti 1992 deri në vitin 2000 me Türkiye Bursları (Bursat Turke) në nivelin bachelor, master dhe doktoratë kanë diplomuar 2000 studentë, tani vazhdojnë studimet 239, pa llogaritur ata studentë që studiojnë me shpenzime vetanake.

- 1 Ky punim është prezantuar në versionin turqisht, V. Uluslararası Sosyal Bilimler Araştırmaları Kongresi- V. International Research Congress on Social Sciences, 26-27 Ekim 2021, Ankara Hacı Bayram Veli Üniversitesi, Ankara /Türkiye.
- 2 Komunitetet jo shumicë në Kosovë kanë qasje në arsim në gjuhën e tyre, megjithatë, mësimi në gjuhën boshnjake dhe atë turke zhvillohet sipas kurrikulave të Kosovës, mësimi në gjuhën serbe zhvillohet sipas sistemit arsimor të Serbisë. Komunitetet turke, boshnjake, rome, ashkali dhe egjiptiane janë të përfshira në sistemin arsimor të Kosovës. Arsimiti në Kosovë zhvillohet në katër gjuhë, shqip, serbisht, boshnjakisht dhe turqisht në të gjitha nivelet, nga sistemi parashkollor deri në atë universitar.
- 3 Artun, E. (2003). Osmanlı'nın İlk Dönemlerinde Türk Ve Balkan Kültürlerinde Etkileşim. Folklor/Edebiyat, 33(1), 99-105.
- 4 Açık, F. (2013). Osmanlı imparatorluğu Döneminde Dil Politikaları ve Arnavutluk'ta Türkçe., (p. 141).
- 5 Balaban, A. (2014). Arnavutluk'ta Türkçe Öğretimi ve Arnavutların Türkçe Öğrenme Sebepleri. The Journal of International Social Research, 625-635.
- 6 Dizdari, T. N. (2005). Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe, Tiranë, AIITC.
- 7 Abazi, G. E. (2002). Arnavutluk'ta Türkoloji Çalışmaları. 21 (Bahar), pp. 1-20.
- 8 Tahir Dizdari, Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe, Tiranë, 2000, f. 632.
- 9 Aliriza Selmani dhe Avni Aliu, Myderriz Haki Efendi (1914-1948), Prishtinë, 2005, f. 89.
- 10 <http://medreseja.com>
- 11 Sadik Mehmet, “Medreseja e Ultë Shqiptare e Prishtinës” dhe aktivitetet e saj 1951-1962, Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor, Prishtinë 17-19 maj 2017, KBI.
- 12 Ramiz Zeka, Institucionet arsimore islame në trojet shqiptare... Medreseja e Prishtinës “Alauddin” e Prishtinës, f. 55, Prishtinë, 2018.
- 13 Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, MEDRESEJA “ALAUDDIN” E PRISHTINËS, Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor, (Prishtinë, 17- 19 maj 2017).
- 14 Balaban, A. (2014). Arnavutluk'ta Türkçe Öğretimi ve Arnavutların Türkçe Öğrenme Sebepleri. The Journal of International Social Research, 625-635.


Lidhja dhe bashkëpunimi i ulemave shqiptarë të Kosovës me Trupin Diplomatik Shqiptar (1936-1939) – (2)

Dr. Qerim Lita

Meqë popullsia shqiptare-myslimane në përgjithësi ishte në nivel tepër të ulët kulturor-arsimor, për shkak të mohimit të së drejtës për t'u arsimuar në gjuhën amtare, Këshilli i Kuvendit Mearif të Vakëfit, i kushtoi rëndësi të madhe ndarjes së bursave si për nxënësit e shkollave të mesme, ashtu edhe për studentët që studionin në Universitetin e Beogradit dhe atë të Zagrebit. Kjo pasqyrohet në buxhetet e viteve 1937/38, 1938/39 dhe 1939/40, ku për këtë qëllim ishte caktuar një shumë e madhe. Buxheti i vitit 1937/38 arrinte në 11.385.500 dinarë, prej kësaj shume, 650.000 ishin paraparë për bursa të studentëve.¹ Kjo shumë ishte e njëjtë në buxhetin e vitit 1938/39, ndërsa në vitin 1939/40 u rrit në 800.000 dinarë.² Nga kjo shumë përfituan bursa mbi 150 studentë shqiptarë, turq e boshnjakë. Në mesin e bursistëve pati edhe disa personalitete, të cilët kanë lënë gjurmë në historinë shqiptare: Esad Doko, dr. Zyrap Sejfullau, akademik Esad Mekuli, Mexhid Esadi, Nexhmedin Besimi, Xhevdet Pallaska, Jahja Osmani, akademik Idriz Ajeti, Sokol Dobroshi, Tahir Ismaili, Ibrahim Lutfiu, Abdulla Saqipi, Shaip Kamberi, Shaip Mustafa, Kurtesh Agushi, etj..³

Ndërkohë, në Konferencën Ballkanike, punimet e së cilës u mbajtën gjatë muajit shkurt 1938 në Ankara, Qeveria Jugosllave arriti ta bind Qeverinë Turke për fillimin e negociatave rreth arritjes së një konvente për shpërnguljen e popullsisë myslimane (shqiptare e turke) nga Jugosllavia për në Turqi.⁴ Negociatat filluan më 9 qershor dhe zgjatën deri

më 11 korrik. Delegacionin turk e përfaqësonte Hasan Saka, deputet dhe ish-ministër, ndërsa delegacioni jugosllav përbëhej nga Milan Ristiç, shef i zyrës politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Vojsllav Magovçević, inspektor në Ministrinë e Bujqësisë. Më 11 korrik palët negociuese miratuan tekstin përfundimtar të Konventës dhe u vendos që të përgatitej një komunikatë, e cila do t'i përcillej shtypit të të dyja vendeve. Konventa parashikonte që brenda gjashtë viteve, duke filluar nga viti 1939 e deri në vitin 1944, nga Kosova, nga trevat shqiptare në Maqedoninë e sotme Veriore



dhe nga Mali i Zi, do të shpërnguleshin gjithsej 40.000 familje shqiptare myslimane.⁵

Menjëherë pas përhapjes së këtij lajmi, me urdhër të Mbretit Zog, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, u formua një komision special, të cilin e udhëhiqte vetë ministri i jashtëm, Ekrem bej Libohova, ndërsa në të merrnin pjesë diplomatët më të shquar shqiptarë të kohës si: Rauf Fico, ministër fuqiplotë, i akredituar në Athinë, Tahir Shtylla, këshilltar legatë, ministër – përfaqësues i Mbretërisë Shqiptare në Beograd, Seremet Xhaxhuli, sekretar i parë, kryekonsull i Kryekonsullatës Mbretërore në Shkup dhe Hamdi Karazi, drejtor për Punët e Lidhjes së Kombeve me seli në Gjenevë. Komisioni, pasi e shqyrtoi gjerë e gjatë problemin shqiptar në Jugosllavi, më 16 maj të vitit 1937, hartoi dokumentin të titulluar: “Studim mbi problemin e ekzistencës morale e materiale të minoritetit shqiptar në Jugosllavi”. Në të, ndër të tjera thuhej se “Komisioni në fjalë, tue ripohuem parimin që ekzistenca morale dhe materiale” e popullsisë shqiptare në Jugosllavi, përbën problemin kryesor dhe “tue konsideruar faktin” se midis Turqisë dhe Jugosllavisë “është përfunduar një marrëveshje – ndoshta edhe e pashkruese”, sipas së cilës i tërë minoriteti “turk” do të shpërngulet për në Turqi, shfaq bindjen e plotë se një numër i konsiderueshëm shqiptarë të Kosovës e të Maqedonisë “do të përmbledhen në këtë shpërngulje, tue kalue për turq”, dhe këtë bindje, Komisioni e mbështet për sa më poshtë vijon:

a) Është interesi i Jugosllavisë që shqiptarët të rrallohen, sidomos në viset ku ata janë në shumicë dhe në mënyrë kompakte, pra përgjatë brezit kufitar me Shqipërinë, dhe në vend të tyre të instalojë njerëz të gjakut dhe gjuhës sllave.

b) Është interesi i Turqisë që t’i merr edhe shqiptarët nga pikëpamja demografike dhe nga një pikëpamje tjetër politike që hynë në kuadrin e politikës së Antantës Ballkanike kundër rrezikut gjerman..., sepse në këtë mënyrë i bën një favor Jugosllavisë, me të cilën ajo ka dobi të përforcojë edhe më tepër marrëdhëniet miqësore.

c) Këtë interes të dyfishtë turko-jugosllav e ndihmojnë nga njëra anë injoranca e shumicës së shqiptarëve në Jugosllavi..., dhe nga ana tjetër fakti që elementi shqiptar, sidomos qytetarët, përgjithësisht e flasin gjuhën turke edhe në familje, që kjo e lehtëson shumë pikëpamjen pseudo-raciste turke, sipas së cilës për t’u pranuar si emigrant turk në Turqi,

mjafton me e quaj veten turk dhe të flasësh nga pak turqisht...”.⁶

Për t’u dalë në mbrojtje shqiptarëve të Kosovës dhe për ta penguar shpërnguljen e tyre për në Turqi, Komisioni vendosi të formojë një Komitetet të fshehtë, i cili do të udhëhiqej nga Ferhat bej Draga, ndërsa për anëtarë të Komitetit u caktuan këta personalitete: Seit Hoxha, Iljaz Haxhi Xhemal Prishtina, dr. Xhafer Sulejmani, Xhevat Begolli, Sherif Voca, Zejnel Strazimiri, Sefedin Begolli, Mustafa Dërguti, Kadri Salju, Sulejman Kryeziu dhe Asim Hoxha – Luzha.⁷ Komitetit në fjalë, Qeveria Shqiptare, do i caktonte një shumë të caktuar të hollash, me të cilat anëtarët e Komitetit “do ta intensifikojnë propagandën e tyre nër popullatat shqiptare” për ta ndaluar shpërnguljen, për ta mbajtur gjallë shqiptarizmin dhe “të përhapin me mjetet që disponojnë mësimin në gjuhën shqipe...”.⁸ Përveç kësaj, Komisioni vendosi që nga ana e Qeverisë Shqiptare, të ndihmohen të gjithë ata imamë shqiptarë të Kosovës të cilët “për qëndrimin e tyre patriotik kanë qenë të larguar prej detyrës që kanë punuar. Gjithashtu, thuhet më tej në dokument, do të ndihmohen përgjithësisht ata shqiptarë që provojnë se për qëndrimin e tyre patriotik ose si

konsekuenca të persekutimeve të vuajtura qoftë për shkak politike, qoftë për aplikimin e Reformës Agrare ndodhen në pamundësi ekonomike që të jetojnë...”.⁹

Një çështje tjetër me rëndësi, ishte problemi i mjeteve të informimit, ku shqiptarëve, siç është e njohur botërisht, autoritetet e atëhershme hegjemoniste jugosllave (serbe) ua ndalonin të kishin një gazetë të tyre në gjuhën amtare, për çka Komisioni, e pa si të domosdoshme daljen e një “Fletore”, e cila fillimisht do të botohej në gjuhën serbe dhe turke, ndërsa më pas, sipas mundësive, edhe në gjuhën shqipe. “Drejtori, thuhet në dokument, të shënohet prej Legatës Mbretërore në Belgrad, duke marrë pëlqimin e Konsullatave të Shkupit e Monastirit. Misioni i kësaj Fletore do të jetë: brenda posibilitetit dhe duke u mbajtur gjithnjë në lëmën shkencore e fetare t’u tregojë Shqiptarëve origjinën historinë e tyre. Të mbroj të drejtat e atyre popullatave në konformitet me ligjat e vendit e t’i denoncojë Qeverisë dhe opinionit ilegalitetet t’autoriteve lokale ndaj tyre, të jetë organ në dispozitën e Grupit shqiptar në Këshillën e lartë fetare për çdo veprim që ka lidhje me aktivitetin e këtij komuniteti, të prapagojë vlerën e kulturës duke inkurajuar elementin shqiptarë që të vejë në shkollat laike e eklesiastike”¹⁰

Komiteti i fshehtë, në bashkëpunim të ngushtë me ulematë shqiptarë, me organizatën studentore “Besa” dhe natyrisht, edhe me Trupin Diplomatik Shqiptar, ia filloi aksionit politik në mbarë hapësirën shqiptare nën Jugosllavi.



Rrjedhimisht, Komiteti i fshehtë, në bashkëpunim të ngushtë me ulematë shqiptarë, me organizatën studentore “Besa” dhe natyrisht, edhe me trupin diplomatik shqiptar, ia filloi aksionit politik në mbarë hapësirën shqiptare nën Jugosllavi. Komandanti i Armatës III, Milan S. Jekmenić nga Shkupi, informonte Shtabin e Përgjithshëm të Armatës së Ferhat Draga, në bashkëveprim të ngushtë me parinë dhe ulematë shqiptarë, kishte filluar një aksion në mbarë hapësirën shqiptare dhe se, për shkak edhe të zhvillimeve politike ndërkombëtare, propaganda shqiptare në Kosovë asnjëherë nuk kishte qenë më e gjallë.¹¹ Ndërkohë, edhe kryeshefi i Banovinës së Vardarit, Nik Dimitrijeviq, nga Shkupi i raportonte Beogradit se Ferhat Draga, së bashku me miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, po zhvillonin takime të ngushta dhe po zgjidhnin njerëzit e tyre që do t’i përfaqësonin në Kuvendin Kombëtar, dhe në krye të administratave komunale. Ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij cilësoheshin mësuesit e lëndës së fesë, hoxhallarët dhe zyrtarët e vakëfeve. Me qëllim që kompaktësia të ishte sa më e madhe, theksonte ai, po bëhej pajtimi i gjaqeve dhe i mosmarrëveshjeve të tjera nga ana e parisë shqiptare.¹² Sipas Dimitrijeviqit, ky aktivitet i parisë shqiptare, mësuesve fetarë si dhe i përfaqësive diplomatike shqiptare në Shkup, Manastir e Beograd, pati ndikim vendimtar që “lëvizja për shpërnguljen, në të cilën ishte përfshirë popullsia shqiptare e Kosovës deri në vitin 1936, sot të zbehet. Deri në atë kohë, vazhdon Dimitrijeviq, fshatra të tëra ishin të gatshme t’i lëshonin vatrat e tyre dhe t’i linin pasuritë e tyre pa asnjë dëmshpërblim vetëm që shteti t’i lironte nga tatimi i tokës, t’u jepte pasaporta pa pagesë dhe t’ua paguante rrugën deri në kufirin tonë. Nuk patën sukses as masat e rrepta agrare, as konfiskimi i armëve, prandaj rruga e vetme që kjo çështje të rifillonte ishte shpërngulja në bazë të Konventës së

nënshkruar me Turqinë, edhe pse shqiptarët flisnin publikisht se në asnjë mënyrë nuk do t’i lëshojnë vatrat e tyre...”¹³ Ndërkohë, kryekonsulli shqiptar në Shkup, më 8 nëntor 1938, i shkruante ministrit të jashtëm, Ekrem bej Libohova, për fushatën kombëtare të ulemave shqiptarë të Shkupit në krye me Seit Hoxhën, me rastin e muajit të shenjtë Ramazan, e cila për qëllim pati pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve nga vatrat e tyre për në Turqi.

“Kam nderin, shkruante Xhaxhuli, të sjell në dijeni të Shkelqësis s’Uaj se, me rastin e muajit të Ramazanit, në Xhamit Jahja Pasha dhe Isa Bej të Shkupit, si dhe në disa xhami të tjera të retheve, disa imamë patriotë, të shtyrë prej Z. Seid Hoxha, janë duke i predikuar popullit në gjuhën shqipe. Thema e këtyre predikimeve janë mbi fen, moralin dhe atdheadashurinë, dhe në mënyrë indirekte porositet popullin që të mos largohet nga vend-lindja e tij. Duke përfutur nga ky rast, iu luta Z. Seid Hoxha që të dalë e të shëtisnjë viset e ndryshme të Kosovës dhe të shvillojë një propagandë kombëtare, nën hijen e çështjes fetare nëpërmjet të imamëve dhe hoxhallarëve t’atyre vendeve. Z. e tij që është një nga patriotët e mirë pranoj këtë propozim e të nënshkruarit, duke më premtuar se do të bëjë ç’ka është e mundur për të kryer këtë mision, që e filloj qysh dje me vajtjen e tij në Tetovë”¹⁴.

Burimet e proveniencës policore komuniste jugosllave-maqedonase, vënë në dukje për një fushatë të gjerë kundër shpërnguljes që asaj kohe që zhvilluar edhe nga ulematë e Fushëgropës së Kumanovës e të Luginës së Preshevës si: Shaban Efendiu, Azem Hoxha, Abdulla ef. Ebibi, Mulla Hajdari, Lutfi ef. Ahmeti e të ulemave të tjerë shqiptarë nga kjo pjesë shqiptare.¹⁵ Komanda e xhandarmërisë jugosllave në Manastir, njoftonte se, kryetari i Mexhllisit të Ulemasë së

Shkupit, hafëz Sherif Langu, kishte qëndruar në Manastir, me ç'rast "në mesin e popullsisë shqiptare ka agjitur që mos shpërngulen për Turqi".¹⁶ Ngjashëm sikurse Sh. Langu, vepronin edhe anëtarët e tjerë të Mexhlsit të Ulemasë. Në elaboratin e hartuar në vitin 1954 nga Komisioni për organizimin dhe udhëheqjen e procesit të shpërnguljes së popullsisë myslimane (shqiptare e turke) pranë KQ të PKM-së, ndër të tjera, veprimtaria e Atullaf ef. Kurtishit kundër shpërnguljes së popullsisë shqiptare për në Turqi midis dy luftërave botërore përshkruhet si më poshtë:

"...Reformat e Qemal Atatürkut në Turqi, posaçërisht rreth çështjes së fesë dhe mbulesës,...shkaktoi një huti dhe frikë bukur të madhe te masat myslimane në Maqedoni. Në këtë, rol të madh patën një pjesë e hoxhallarëve, të cilët, për shkak të atyre reformave, ishin të detyruar ta lëshojnë Turqinë dhe të vendosen te ne. Më i njohuri në mesin e tyre ishte Ataullah Hoxha, i cili në Turqi ishte i dënuar me vdekje, por arriti të ikte dhe të vinte në Shkup, ku e hapi medresenë e tij të lartë. Ataullah Hoxha,...bëhet një udhëheqës fetar shumë i njohur dhe me ndikim në pakicën turke (shqiptare – Q.L.). Aktiviteti politik i tij në atë kohë ishte përqendruar kundër shpërnguljes, duke e quajtur Turqinë si vend të pa fe, shtet ku nuk ekziston morali dhe ku nuk respektohen liritë fetare..."¹⁷

Një veprimtari të dëndur kundër shpërnguljes, asaj kohe, pati edhe anëtari tjetër i Mexhlsit të Ulemasë së Shkupit, Bedri ef. Hamidi, i cili në vitin 1939 zhvilloi një vizitë disamujore në të gjitha qendrat më të rëndësishme të Mexhlsit të Ulemasë së Shkupit, si: Prishtinë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Preshevë, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Strugë, Manastir, Ulqin, Novi Pazar etj., me ç'rast mbajti ligjërata me karakter fetar e politik në xhamitë kryesore të këtyre qendrave. Për tërë atë aktivitet të tij, përmes një raporti me mbi 200 faqesh, e njoftoi Mexhlsin e Ulemasë së Shkupit për gjendjen e mjerueshme të popullsisë myslimane, ku, ndër të tjera, ai shkruante: "...Si pasojë e Luftës së Parë Botërore, e cila pati një ndikim të madh në zhvillimin e jetës së përgjithshme të këtyre myslimanëve, është shpërngulja e familjeve të tëra për në

Lidhja,
koordinimi
dhe bashkë-
punimi i
ngushtë i
parisë dhe i
ulemave
shqiptarë të
Kosovës me
Trupin
Diplomatik
Shqiptar në
Beograd,
Shkup dhe
Manastir,
mundësoi
dukshëm në
ndërgjegjësi-
min e vetëdijes
kombëtare te
popullsia
shqiptare e
Kosovës.

Republikën e Turqisë. Hovi i kësaj shpërngulje u shtua sidomos pas përfundimit të luftës. Shkak i kësaj shpërngulje ishte vendimi i prerë për zbatimin e Reformës Agrare, reformë kjo që familjet myslimane i la në rrugë të shkretë...Kjo shpërngulje nuk po ndikonte vetëm në zvogëlimin e numrit të myslimanëve, por shkaktonte dhe një psikozë edhe tek ata pak myslimanë që nuk kishin braktisur vendlindjet e tyre, të cilëve po ua mbyste impulsin për jetë e për punë. Në shumë vise..., me shpërnguljen e familjeve të tëra u humb shumica e myslimanëve dhe me këtë edhe pesha e tyre në drejtimin e këtyre vendbanimeve..."¹⁸

Nga sa u tha më sipër, mund të arrihet deri te konkluzioni se lidhja, koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë i parisë dhe i ulemave shqiptarë të Kosovës me Trupin Diplomatik Shqiptar në Beograd, Shkup dhe Manastir, mundësoi dukshëm në ndërgjegjësimin e vetëdijes kombëtare te popullsia shqiptare e Kosovës dhe të viseve të tjera nën pushtimin jugosllavë gjatë viteve tridhjeta të shekullit të kaluar. Ishte pikërisht kjo veprimtari ndërshqiptare që solli deri tek ajo që, Konventa e përafruar në Stamboll më 11 korrik 1938 midis Qeverisë turke dhe asaj jugosllave, të mos nënshkruhet nga pala turke, me çka dështuan të gjitha planet antishqiptare të hartuara nga qarqet serbomadhe brenda harkut kohor 1939 – 1935.

1 ДАРМ. 1. 613.2.1/1-205.

2 Po aty.

3 Po aty.

4 AJ.370.9/773.

5 AJ.370.9/893-924.

6 AHMPJ.D.107/2.V.1938.FI.768-772.

7 Po aty, FI. 780-784..

8 Po aty.

9 Po aty.

10 Po aty.

11 ДАРМ, по aty, Пов. Бр. 3530/38, Elaborat – I, i hartuar nga komandanti i Armatës III në Shkup, dërguar ministrit të Ushtrisë dhe të Marinës, rreth politikës ideore të regjimit jugosllav në lidhje me kolonizimin e tokave shqiptare nën pushtimin jugosllav, Shkup, shkurt 1938.

12 ДАРМ. 1. 885. Пов стр. пов. бр. 75/39.

13 Po aty.

14 AHMPJ.D.107/1.V.1938.FI.383.

15 ДАРМ. 1. 885. Д. 432000948, Изјава...3. XII. 1948 год., Куманово.

16 ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346.Бр.13228/39, Београд.

17 ДАРМ.1.427.60.7/116-129.

18 ДАРМ.1.613.2.1/1-205.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KOMANDANTIN E RI TË KFOR-IT, GJENERALMAJORIN ENRICO BARDUANI



Më 8 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajorin Enrico Barduani.

Myftiu Tërnavë fillimisht i shprehu mirëseardhje komandantit, e më pas e uroi atë për marrjen e detyrës si komandant i KFOR-it, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme në

këtë mision. Më pas Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin me punët, angazhimet dhe sfidat që ka institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, duke veçuar kështu kontributin e këtij institucioni dhënë për kultivimin e tolerancës dhe bashkëjetesës ndërfaqetare në Kosovë.

Ai shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për ndihmën dhe përkrahjen

e vazhdueshme që ka dhënë KFOR-i për popullin e Kosovës.

Nga ana e tij, gjeneralmajori Enrico Barduani, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe shprehu gatishmërinë e plotë të tij që të vazhdojë bashkëpunimin i mirë ndërmjet KFOR-it dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E ITALISË NË KOSOVË, Z. ANTONELLO DE RIU



Më 19 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, z. Antonello De Riu.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, e më pas e njohu atë me punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për

kontributin e këtij institucioni në kultivimin e tolerancës dhe harmonisë ndërfaqetare në Kosovë.

Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës ndër vite ka luajtur një rol kyç në proceset e ndryshme në të cilat ka kaluar Kosova. Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që përmes ambasadorit italian, të falënderojë shtetin e Italisë për përkrahjen e vazhdueshme që ka

dhënë për Kosovën në sfera të ndryshme.

Nga ana e tij, ambasadori De Riu, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, duke shprehu kështu konsideratën e tij për angazhimin e tij dhe të institucionit që ai drejton në përhapjen e kulturës dhe frymës së tolerancës dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve fetare që jetojnë në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E SHOQATËS BAMIRËSE “SHEIKH ABDULLAH AL NOURI CHARITY SOCIETY” TË KUVAJTIT, Z. VELID SEJF

Më 15 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim drejtorin gjeneral të Shoqatës Bamirëse “Sheikh Abdullah al Nouri Charity Society” të Kuvajtit, z. Velid Sejf, në ambientet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Myftiu Tërnavë, pas urimit të mirëseardhjes për mysafirin, e njohu atë me historinë, punët dhe angazhimet e shumta të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke veçuar në veçanti rolin e saj në zhvillimin e aktiviteteve humanitare përmes shoqatës së saj “Bereqeti”. Ai përmendi arritjet konkrete në ndihmën për të varfërit dhe grupet më të marginalizuara, si një dëshmi e përkushtimit të vazhdueshëm të institucionit në shërbim të besimtarëve.

Gjatë këtij takimi u bisedua me shumë interes për mundësitë e fillimit të një bashkëpunimi të ngushtë



ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe shoqatës “Sheikh Abdullah al Nouri”, duke synuar projekte konkrete që do të përmirësojnë mirëqenien e besimtarëve dhe të shoqërisë kosovare në përgjithësi. Ky bashkëpunim u pa si një mundësi e shkëlqyer për të bashkuar përvojat dhe burimet, në mënyrë që të

realizohen iniciativa të dobishme me ndikim të gjerë shoqëror.

Në fund të takimit, të dy palët shprehën gatishmërinë e tyre për të ndërtuar një partneritet afatgjatë që promovon vlera të përbashkëta dhe fuqizon mbështetjen për ata që kanë më së shumti nevojë.

NË RIMANISHTË TË PRISHTINËS U BË PËRURIMI I XHAMISË SË RINOVUAR



Më 3 nëntor 2024, në fshatin Rimanishtë të Prishtinës, me pjesëmarrjen e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, hoxhallarëve dhe besimtarëve të shumtë, u mbajt

ceremonia solemne e rihapjes së xhamisë. Besimtarë të shumtë u shprehën të gëzuar me rihapjen e xhamisë, duke kujtuar kështu rëndësinë që ka xhamia në jetën e tyre.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij përshëndetëse tha se në Kosovë dita-ditës po ndërtohen xhami që të adhurohet Zoti dhe të edukohen brezat e rinj. Ai tha se këto xhami janë duke u rinovuar dhe ndërtuar falë bamirësve të shumtë, të cilët po kontribuojnë me mjete financiare dhe jo vetëm, që të ndërtohen këto xhami.

Një fjalë përshëndetëse drejtuar të pranishmëve, mbajti edhe kryeimami i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Burhanudin ef. Hashani, i cili evokoi kujtime nga vendosja e gurthemelit të kësaj xhamie 20 vjet më parë.

Imami i xhamisë, Kemajl ef. Llumnica, falënderoi të gjithë ata bamirës, të cilët në formë të ndryshme kanë kontribuar në rinovimin e kësaj xhamie.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM VEPRIMTARIN SELATIN NOVOSELLA

Më 4 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim veprimtarin dhe aktivistin e shquar të çështjes kombëtare, z. Selatin Novosella.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë dhe veprimtari Novosella, evokuan kujtime nga bashkëpunimi që kanë pasur ndërmjet vete gjatë periudhës së luftës në Kosovë, si dhe për ndihmat e vazhdueshme që ka dhënë Bashkësia Islame e Kosovës për luftën çlirimtare të Kosovës.

Veprimtari Novosella, shfrytëzoi rastin që t'i dhuroi Myftiut Tërnavë veprën më të re të tij kushtuar Adem Demaçit, të titulluar “Adem Demaçi – Lëvizja revolucionare për bashkimin e shqiptarëve – programi dhe statuti – Pejë, 1964”, duke e njoftuar gjithashtu se



është në përgatitje të kompletit të jetës dhe veprës së Adem Demaçit, e cila do të botohet në 40 vëllime.

Myftiu Tërnavë e falënderoi mysafirin për vizitën, duke e përgëzuar atë për

librin e tij, e më pas ia dhuroi librin autobiografik “Në kërkim të identitetit”, i cili i kushtohet presidentit Anvar al Sadat.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGAFONDACIONI “SHEJH ZAJED”

Më 8 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga Fondacioni “Shejh Zajed” i Emirateve të Bashkuara Arabe, i përbërë nga Muhamed al Mansoori – përgjegjës i projekteve jashtë vendit,

znj. Khuloud al Kindi, znj. Shikha al Blooshi dhe znj. Maytha Abdullah.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me punët dhe angazhimet e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për aktivitetet humanitare që

zhvillon BIK-u përmes shoqatës së saj humanitare “Bereqeti”. Ai përmes tyre falënderoi Fondacionin “Shejh Zajed” për ndihmat e vazhdueshme dhënë për Kosovën në përgjithësi, por edhe për Bashkësinë Islame të Kosovës në veçanti.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN EKZEKUTIV TË ORGANIZATËS “QATAR CHARITY”, YOUSUF AL KUWARI

Më 14 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të organizatës “Qatar Charity”, Yousuf al Kuwarin, i cili shoqërohej nga ambasadori i Katarit në Shqipëri, njëherësh ambasador jo rezident në Kosovë, Jabor Ali al Dasori, si dhe nga përfaqësuesi i “Qatar Charity” në Kosovës, z. Esam Dabab.

Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme të shtetit të Katarit dhe përfaqësuesve të tij, duke theksuar rëndësinë e këtyre bashkëpunimeve.

“Kur përmendim Katarin, menjëherë mendja na shkon te një popull dhe shtet bamirës, i cili, i prirë nga Emiri i tij, e ka përhapur ndihmën në të katër anët e botës. Nuk do të isha i drejtë me këtë rast sikur para jush të mos falënderoja drejtorin e shoqatës bamirëse të Katarit në Kosovë për punën e tyre të madhe që po bëjnë në Kosovë.”

Në anën tjetër, edhe drejtori i “Qatar Charity” shprehu mirënjohjen e tij ndaj



Bashkësisë Islame të Kosovës, duke potencuar dëshirën e madhe për të ndihmuar popullin e Kosovës.

“Për ne është një dëshirë e madhe për të qenë pranë popullit të Kosovës në të gjitha sferat e jetës, por në veçanti kjo gjë lehtësohet falë bashkëpunimit të shkëlqyer me Bashkësinë Islame të Kosovës. Ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku për të mirën e përgjithshme.”

Ky takimi u përqendrua në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe “Qatar Charity”.

Si rezultat i kësaj, të dyja palët nënshkruan një memorandum bashkëpunimi, duke vendosur themelet për angazhime të reja në projekte të përbashkëta në të ardhmen.

Një nga temat kryesore të diskutimit ishte edhe projekti i ndërtimit të xhamisë në Lipjan, një projekt që po zhvillohet si pjesë e bashkëpunimit ndërmjet BIK-ut dhe “Qatar Charity”. Palët shqyrtuan gjithashtu mundësitë për projekte të tjera që synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe forcimin e ndërlidhjes ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NG DREJTORIA E PËRGJITHSHME E VAKËFEVE TË TURQISË

Më 14 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë, të kryesuar nga shefi i Departamentit për Marrëdhënie me Jashtë, z. Kadir Kantekin.

Kjo vizitë erdhi si rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve, ku me këtë rast u nënshkrua edhe një memorandum bashkëpunimi për mobilimin e Medresës së Vogël dhe ndërtesës së konviktit në qytetin e Gjakovës.

Myftiu Tërnavë falënderoi z. Kantekin dhe nëpërmes tij tërë Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve për bashkëpunimin e mirë që kanë pasur



deri më tani me Bashkësinë Islame të Kosovës, duke veçuar kështu restaurimin e shumë xhamive me rëndësi për trashëgiminë kulturore dhe fetare në tërë territorin e Kosovës. Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që bashkëpunimi i deritanishëm të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, z. Kantekin, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për bashkëpunimin e treguar ndër vite me Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve. Ai tha se mbështetja e përkushtuar që edhe më tej të vazhdojmë të punojmë së bashku në të gjitha fushat që mund të kontribuojnë si institucione.

E ÇËSHTJEVE FETARE NË MINISTRINË E VAKËFEVE DHE ÇËSHTJEVE ISLAME TË KATARIT, Z. MUHAMED AL MENAI



Më 19 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin e Çështjeve Fetare në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Islame të Katarit, z. Muhamed al Menai, i cili shoqërohej nga zëvendësi i tij, dr. Sead al Kawari.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i falënderoi ata dhe nëpërmjet tyre

shtetin e Katarit për ndihmat dhe përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë për Kosovën dhe Bashkësinë Islame. Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që ta falënderojë Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Katarit për ndërtimin e selisë së shoqatës “Bereqeti”. Myftiu Tërnavë me këtë rast shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që të vazhdojë bashkëpunimin e mirë me

Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame, gjithnjë në të mirë të besimtarëve dhe qytetarëve të Kosovës.

Nga ana e tij, drejtori Al Menai, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Katarit në realizimin e projekteve të përbashkëta.

MYFTIU TËRNAVA SË BASHKU ME DELEGACIONIN NGA KATARI VIZITUAN OBJEKTIN E VAKËFIT NË GJILAN

Më 19 nëntor 2024, delegacioni nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Katarit, i përbërë nga drejtori i Çështjeve Fetare, Muhamed al Menai dhe zëvendësi i tij, dr. Sead al Kawari, së bashku me kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnavë, vizituan objektin e vakëfit në Gjilan, ndërtimi i së cilit është financuar nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Katarit.

Mysafirët nga Katari u shprehën të kënaqur me ecurinë e punimeve në ndërtimin e këtij objekti, duke shprehur kështu gatishmërinë e tyre që të kontribuojnë edhe më tej në ndërtimin e infrastrukturës për nevojat e besimtarëve myslimanë në Kosovë.



U INAUGURUA SELIA QENDRORE E SHOQATËS HUMANITARE BAMIRËSE “BEREQETI”



Më 20 nëntor 2024, Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” inauguroi selinë e re qendrore, me frigodhomat, depo të kapaciteteve të larta dhe zyrat për administrimin e aktiviteteve humanitare. Ky investim pritet të rrisë kapacitetet dhe efikasitetin e shoqatës në ndihmën për më të nevojshmit.

Në inaugurim morën pjesë Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, kryeministri Albin Kurti dhe një delegacion nga Katari, përfshirë drejtorin e Çështjeve Fetare në Ministrinë e Vakëfeve Islame të Katarit, Muhamed al Menai, dhe

zëvendësin e tij, dr. Sead al Kawari, si mbështetës të projektit.

Myftiu Tërnavë theksoi rezultatet konkrete të “Bereqetit”, duke përmendur ndihmën për 50 mijë familje në vit me ushqime dhe higjienë, si dhe dhurimin e 400 tonëve mish kurbani në dy vitet e fundit.

Kryeministri Kurti e cilësoi “Bereqetin” si shoqatë bamirëse të besueshme dhe të dobishme për qytetarët, duke përmendur mbështetjen shtetërore prej gjysmë milioni eurosh si dëshmi.

Përfaqësuesit nga Katari u shprehën të lumtur për rezultatet e “Bereqetit” dhe rolin e saj në bamirësi globale. “Ky është një donacion që ndihmon bashkësitë fetare dhe qytetarët anembanë botës,” tha Muhamed al Menai.

Drejtori i “Bereqetit”, Behxhet Ajvazi, falënderoi të gjithë mbështetësit dhe theksoi se ndihma dhe solidariteti janë vlera të mësuara nga feja islame. Në fund të ceremonisë, u bë një dua për inaugurimin.

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I OBILIQIT, Z. XHAFER GASHI



Më 22 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga

bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga kryetari i Obiliqit, z. Xhafer Gashi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet dy institucioneve, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Komunës së Obiliqit, duke shprehur kështu gatishmërinë e dy palëve që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen, gjithnjë për të mirën e besimtarëve dhe qytetarëve tanë.

Myftiu Tërnavë me këtë rast shprehu falënderimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për ndarjen e parcelës në fshatin Shkabaj, e cila do të shërbejë për ndërtimin e xhamisë së re.

U VU GURTHEMELI I XHAMISË SË RE NË FSHATIN SHKABAJ TË OBILIQIT



Më 22 nëntor 2024, me këndim të tekbirove, pas namazit të xhumasë, u vu gurthemeli i xhamisë së re në fshatin Shkabaj të Obiliqit.

Në këtë ceremoni qenë të pranishëm kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, kryetari i Obiliqit, z. Xhafer Gashi, administrata e Këshillit të BI-së së Obiliqit, si dhe qytetarë të Shkabajt.

Myftiu Tërnavë në fjalën e tij, tha se në këtë vend, përveç xhamisë do të ndërtohen edhe objekte të tjera, të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve të këtij vendi.

Gjatë kësaj dite, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mbajti hytben e xhumasë në Xhaminë Qendrore të Obiliqit, ku ligjëroi rreth vlerës dhe begative të ndërtimit të xhamive.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT



Më 23 nëntor 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt të saj, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Gjatë kësaj mbledhje u diskutua projektbuxheti i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për vitin 2025, si dhe projektbuxheti i Këshillave të BI-së për vitin 2025. Pas leximit dhe shqyrtimit të këtyre projektbuxheteve, anëtarët e Kryesisë aprovuan këto projektbuxhete.

Më pas Kryesia shqyrtoi lëndë të tjera dhe mori vendime në bazë të kompetencave që i takojnë.

Kjo mbledhje u mbajt në objektin e Këshillit të Bashkësisë Islame të Drenasit.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI NXËNËSIT QË VIJOJNË MËSIM-BESIMIN NË DRENAS

Më 23 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka vizituar nxënës të vijojnë mësim-besimin në Këshillin e Bashkësisë Islame të Drenasit.

Myftiu Tërnavë përgëzoi nxënës, si dhe u uroi atyre shëndet dhe suksese në mësim, gjithnjë duke ua kujtuar atyre vlerën dhe rëndësinë që ka leximi dhe mësimi në fenë islame.

Mualimet Ramize Zeqiri - Mehani dhe Enisa Xhemajlaj - Mehani, e njohën Myftiun Tërnavë me procesin mësimor

të mësim-besimit, duke e falënderuar kështu për përkrahjen e vazhdueshme

që u jep mualimeve dhe nxënësve të mësim-besimit.



U MBAJT PROGRAM KUSHTUAR FESTËS SË 28 NËNTORIT

Më 26 nëntor 2024, për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, Këshilli i Bashkësisë Islame i Suharekës organizoi manifestim kushtuar kësaj dite. Në këtë manifestim morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, kryetari i Suharekës, z. Bali Muharremaj, përfaqësues politikë dhe fetarë, si dhe qindra qytetarë nga Suhareka dhe rrethina.

Programi filloi me leximin e pjesëve nga Kurani fisnik, si dhe me intonimin e himneve kombëtar dhe shtetëror.

Kryetari i Këshillit të BI-së së Suharekës, Haki ef. Hoxha, në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje, ndërkaq, kryetari i Suharekës, z. Bali Muharremaj, falënderoi Bashkësinë Islame për këtë organizim, duke çmuar kështu rolin dhe kontributin që ky institucion ka dhënë gjatë viteve për shtetin e Kosovës. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës nuk ka dhënë kontribut vetëm në luftën e fundit, por atë e gjejmë në të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë.

Ligjëratën kryesore kushtuar kësaj dite, pra 28 Nëntorit, e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili tha se kjo ditë na shtynë të mendojmë edhe më shumë për fatet historike të kombit shqiptar, pasi që kjo ditë simbolizon lirinë e identitetin kombëtar, si dhe sakrificat për fitimin e pavarësisë.

Gjatë ligjëratës së tij Myftiu Tërnavë përmendi me krenari sakrificën e heronjve dhe familjeve shqiptare, të cilët sakrifkuan gjënë më të shtrenjtë për lirinë e Kosovës. “Komandanti Adem Jashari, bashkë me Hamzën dhe Shabanin, mbesin në kujtesën dhe memorien e çdo shqiptari deri në amshim për heroizmin e tyre të treguar dhe dashurinë për atdheun ku lindën dhe jetuan.”

Duke folur për dashurinë ndaj atdheut, Myftiu Tërnavë potencoi se dashuria për atdheun është një natyrë e lindur brenda njeriut, dhe se Islami e ka bërë pjesë të përgjegjësisë së besimit dashurinë për atdheun. “Është detyrë jona që atdheut t’i falim siguri, ta rindërtojmë e ta mbrojmë atë. Islami e ka lartësuar rëndësinë e atdheut si një

vlerë të rëndësishme në vetvete. Dashuria, përkatësia dhe besnikëria ndaj atdheut janë detyra dhe kushdo që manipulon me këto koncepte konsiderohet tradhtarë” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Në fund të ligjëratës së tij, Myftiu Tërnavë, përmendi edhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhënë për çlirimin e vendit tonë, duke thënë se ne si Bashkësi Islame, ndonëse po sulmohemi e po fyhemi me fjalët më poshtëruese, ne qëndrojmë dhe vazhdojmë të ecim hapave të Abdyl Frashërit e Ymer Prizrenit, Ismail Qemajlit e Haxhi Zekës, Adem Demaçit e Zahir Pajazitit, Bacë Shabanit e Adem e Hamëz Jasharit, Fehmi e Xhevë Lladrovci, si dhe hapave të 37 imamëve dëshmorë – shehidë që ranë në luftën e fundit për të mos vdekur kurrë.

Ligjëratën e përfundoi me një lutje drejtuar Zotit për ruajtjen e vendit, familjes dhe fëmijëve tanë.

Programi vazhdoi me disa recitale nga Basri Lushtaku dhe me këndimin e ilahive nga Adem Ramadani.



U MBAJT PROGRAM FESTIV PËR NDER TË 28 NËNTORIT NË “MEDRESENË ALAUDDIN”

Më 27 nëntor 2024, në ambientet e “Medresesë Alauddin” u organizua një program festiv për nder të 28 Nëntorit, Festës Kombëtare. Në këtë program nxënësit prezantuan pika të ndryshme artistike, duke përfshirë recitime dhe këngë patriotike, që krijuan një frymë festive e frymëzuese.

Nxënësit e Medresesë shprehën krenarinë për këtë datë historike, duke e cilësuar si simbol të rezistencës, unitetit dhe krenarisë kombëtare. I pranishëm në këtë ceremoni qe edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili theksoi rolin e rëndësishëm të Medresesë në historinë kombëtare dhe veçanërisht në procesin e çlirimit të Kosovës.

“Medreseja ka pasur një rol vendimtar në çlirimin e Kosovës dhe në ruajtjen e vlerave tona kombëtare. Në kohët më të vështira, siç e dini edhe ju të dashur nxënës, së bashku me shumë profesorë që ende janë këtu i hapëm



dyert në shërbim të kauzës sonë kombëtare për çlirimin e vendit,” tha Myftiu Tërnavë.

Nga ana tjetër, drejtori i “Medresesë Alauddin”, Fadil ef. Hasani, u shpreh se aktivitete të tilla duhet të na nxisin të rrisim dashurinë dhe përkushtimin ndaj vendit tonë.

“Festa të tilla duhet të na bëjnë ta duam vendin edhe më shumë dhe të punojmë për të ardhmen e tij”, tha drejtori Hasani.

Në fund të programit u ndanë edhe mirënjohje për nxënësit më të mirë në shkrimin e poezive dhe të eseve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË FONDACIONIT “INTERNATIONAL MAARIF SCHOOLS OF KOSOVA”

Më 27 nëntor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin e përgjithshëm të Fondacionit “International Maarif Schools of Kosova”, z. Mehmet Nedim Aslan.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, e më pas e njohu atë me punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë në fushën e arsimit. Ai falënderoi drejtorin për punën dhe angazhimin e tij që bën në fushën e arsimit, si dhe për bashkëpunimin e deritanishëm të Fondacionit me Bashkësinë Islame të Kosovës, duke shprehur kështu

gatishmërinë e tij që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, drejtori Nedim Aslan, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen

dhe për mundësinë e bashkëpunimit, duke vlerësuar një gjë të tillë si tejet të nevojshme.



U PËRURUA XHAMIA E RE NË NIKADIN TË FERIZAJT

Më 15 nëntor 2024, në fshatin Nikadin të Ferizajt, u përurua xhamia e re, një projekt i përbashkët i Bashkësisë Islame të Kosovës dhe “Qatar Charity”.

Në ceremoninë e përurimit morën pjesë përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe qytetarë të shumtë nga zona.

Sekretari i përgjithshëm i Kryesisë, Ahmet ef. Sadriu, falënderoi kontribuesit dhe theksoi se xhamia është një dhuratë e çmuar për këtë komunitet,

duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të “Qatar Charity” për projekte të ngjashme.

Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Ferizajt, Nexhmedin ef. Bajrami, theksoi rëndësinë e projektit, duke e cilësuar xhaminë si një vend adhurimi, bashkimi dhe edukimi për banorët.

Në ceremoni mori pjesë edhe Abdulaziz Xhasim Haxhi, drejtor i Departamentit të Operacioneve

Zhvillimore në “Qatar Charity”. Ai shprehu gatishmërinë për të mbështetur projekte të ngjashme, duke e quajtur ndërtimin e xhamisë një kontribut për përf forcimin e vlerave shpirtërore dhe unitetit të komunitetit.

Xhamia e re pritet të luajë një rol të rëndësishëm në jetën shpirtërore dhe sociale të banorëve të Nikadinit dhe zonave përreth.



U MBAJT PROVIMI VLERËSUES I HIFZIT

Më 19 nëntor 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka organizuar provimin vlerësues të hifzit të Kuranit fisnik, të cilit iu nënshtruan katër hafëz. Ata, para komisionit vlerësues, i përbërë nga kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, kryetar, hafëz Safet ef. Hoxha dhe hafëz Bali ef. Sadiku, anëtarë, u vlerësuan për hifzin e tyre.

Kryeimami Vedat ef. Sahiti në fjalën e tij theksoi angazhimin dhe përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës me të gjitha institucionet e saj, duke filluar nga xhamia, mektebi, medresetë e deri te Fakulteti i Studimeve Islame në shërbim të Kuranit fisnik, si një vazhdimësi e rrugës dhe traditës së çmuara e të vyer të mësimin të Kuranit.

“Tradita e mësimin dhe leximit të drejtë të Kuranit dhe nxënies përmendsh ka ekzistuar dhe është organizuar në mënyrë institucionale dhe ajo po vazhdon si e tillë, ndërsa

hafëzët e rinj janë dëshmia më e madhe e garancisë hyjnore për vazhdimësinë e leximit të fjalës së Allahut, si një nga mrekullitë e pasosura të Kuranit” - theksoi mes të tjerash kryeimami Sahiti.



U MBAJT TRYEZË DISKUTIMI ME TEMËN “ROLI I FESË NË SHOQËRINË BASHKËKOHORE”

Më 21 nëntor 2024, Këshilli i Bashkësisë Islame i Deçanit, organizoi Tryezë diskutimi me temë “Roli i fesë në shoqërinë bashkëkohore”. Kjo tryezë mbledhi rreth vetes referues nga fusha të ndryshme, të cilët shpjeguan aspekte të rëndësishme të ndikimit të fesë në jetën sociale dhe kulturore të ditëve të sotme.

Organizatorët thanë se me këtë tryezë po synohet të shpaloset ndikimi i Islamit në jetën bashkëkohore në vendin tonë.

Kryetari i Deçanit, z. Bashkim Ramosaj dhe ai i Junikut, z. Ruzhdi Shehu, theksuan se Islami ka pasur një rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe fetar.

Kryemami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, si pjesë e referuesve të kësaj Tryeze, ndër të tjera potencoi faktin se Islami ka qenë faktor kyç në unitetin dhe respektimin e njëri-tjetrit në Kosovë.



Drejtori për Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, gjatë fjalës së tij përmendi atakimin e padrejtë ndaj vlerave të Islamit që po bëhet kohëve të fundit.

Në anën tjetër edhe prof. Hysen Matoshi dhe drejtori i Institutit të Historisë, z. Shkodran Imeraj, veçuan disa prej rreziqeve, prej të cilave kanosej kombi shqiptar dhe rolin vendimtar të prijesve fetarë në kohet më të vështira.

Referues të tjerë po ashtu theksuan rolin e Islamit, si në aspektin e edukimit, ashtu edhe në ruajtjen e familjes.

Po ashtu, gjatë kësaj tryeze, kryetari i Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj, shpërndau dy mirënjohje për imamët, Ajni Ramadanin dhe Binak Tolajn për kontributin e dhënë në aspektin fetar dhe kombëtar.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË KONFERENCËN “NË NËNQIELLIN E KUPOLËS SONË”

Nga data 1 deri më 3 nëntor 2024, nën organizimin e Fondacionit “Islam Alimleri Vakfi”, në Edirne të Turqisë, u mbajt Konferenca islame me temë “Në nënqiellin e kupolës sonë”, në të cilën morën pjesë përfaqësuesit nga bashkësitë islame të dhjetë shteteve të Ballkanit, si dhe intelektualë dhe profesorë eminent të shkencave islame nga Turqia.

Në hapje të kësaj Konference mori pjesë kryetari i Dijanetit, dr. Ali Erbash, guvernatori i Edirnes, rektori i Universitetit të Trakias në Edirne, si dhe shumë personalitete nga jeta publike e Turqisë.

Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, në seancën e parë, e cila drejtohej nga kryetari i Dijanetit, dr. Ali Erbash, u paraqit me

kumtesën “Roli i ylemasë në ruajtjen e unitetit të myslimanëve”, ku ndër të tjera theksoi rolin dhe kontributin e ylemasë në ruajtjen e unitetit, bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërmjet besimtarëve, si një nga urdhrat më të lartë hyjnor.

Përgjatë punimeve të kësaj Konference, të ndara në gjithsej katër seanca, u trajtuan tema me interes të veçantë mbi sfidat e bashkësive islame në rajon, si dhe për rëndësinë e bashkëpunimit e bashkëveprimit me bashkësitë simotra islame të vendeve të Ballkanit.



KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË PUNËTORINË E ORGANIZUAR NGA OSBE-JA

Më 20 nëntor 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në një punëtori të rëndësishme të organizuar nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Kjo punëtori kishte për qëllim diskutimin për bashkëpunimin e mundshëm të bashkësive fetare me botën akademike në promovimin e vlerave të mirëkuptimit dhe të respektit ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

Në këtë ngjarje të organizuar në një frymë konstruktive dhe bashkëpunuese, qenë të pranishëm përfaqësues të bashkësive fetare në Kosovë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme fetare dhe profesorë të universiteteve publike dhe kolegjeve private, të cilët kontribuan me idetë dhe sugjerimet e tyre.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeimami Sahiti shprehu gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për të bashkëpunuar ngushtë me botën akademike në realizimin e projekteve

dhe aktiviteteve që synojnë kultivimin dhe promovimin e vlerave të mirëkuptimit e respektit reciprok. Ai vuri theks të veçantë te roli i të rinjve dhe studentëve në përhapjen e këtyre vlerave dhe rëndësinë e mbështetjes së tyre për një shoqëri më të bashkuar dhe të ndërgjegjshme.

Punëtorja kishte për synim nxitjen e një dialogu të frytshëm ndërmjet

bashkësive fetare dhe botës akademike, duke u fokusuar në kultivimin e vlerave të mirëkuptimit dhe të bashkëjetesës, si dhe avokimin për liritë dhe të drejtat e njeriut. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e këtij dialogu për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për vendin dhe për forcimin e kohezionit shoqëror në një Kosovë shumëkulturore dhe multietnike.



DREJTORI SIMINCA PRITI NË TAKIM IMAMIN MUHAMED EF. HAVOLLIN

Më 18 nëntor 2024, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në takim kryetarin e Unionit të Qendrave të Baden Wurttembergut, njëherësh imam në Karlsruhe, Muhamed ef. Havollin.

Gjatë këtij takimi u diskutuan mundësitë dhe format e thellimit dhe të intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Unionit të Qendrave të Baden Wurttembergut.

Drejtori Simnica falënderoi imamin Havolli për vizitën dhe njëherësh nëpërmes tij falënderoi edhe tërë mërgatën tonë atje për kontributin që kanë dhënë në vazhdimësi për Kosovën. Ai edhe njëherë konfirmoi përkushtimin e institucionit të BIK-ut për raportjen e raporteve të mira që kanë me

qendrat në diasporë, si dhe për forcimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

Nga ana e tij, imami Havolli, shprehu falënderime për mikpritjen që i bëhet çdoherë në Bashkësinë Islame të

Kosovës, duke shprehur kështu gatishmërinë e tij si imam, që edhe më tej në të ardhmen të vazhdojë një bashkëpunim i mirë ndërmjet tyre dhe BIK-ut.



**BOTIM
I RI**



Doli nga shtypi Takvimi 2025, i cili sjell artikuj me thellësi nga fusha të ndryshme islame, duke përfshirë besimin, moralin, jurisprudencën dhe historinë. Në këtë botim, do të gjeni reflektime të vjera nga autorë të njohur, si dhe tema që ndriçojnë jetën shpirtërore dhe përditshmërinë tuaj. Ju ftojmë ta shfrytëzoni këtë burim të pasur për një vit të begatë me dije dhe përkushtim!

DITURIA ISLAME • Nr. 409 DHJETOR 2024